



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-4379/24
Kaçanik, 29.02.2024

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 shkurt 2024, pos tjerash,

NJOFTOHET

1. Me Raportin Vjetor të Ekzekutivit të Komunës, për periudhën, Janar-Dhjetor 2023.

2. Në Raportin e përcaktuar si në pikën 1 të kësaj Shkrese është paraqitur, aktiviteti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale që e kanë zhvilluar në saje të objektivave dhe përgjegjësi të përcaktuara, për një funksionim të mirë të qeverisjes lokale, për periudhën: 01 Janar -31 Dhjetor 2023, duke paraqitur edhe sfidat -vështirësitë që i kanë përcjellë për gjatë realizimit të objektivave.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është: Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2023 /Lënda 01Nr.104/02-4379/24.

Më këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoritë komunale; Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	15.02.2024	endi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02-4379-1.		

Raporti Vjetor 2023

Ekzekutivi i Komunës

Tel 038 200 46600

Rr. "Qamil Ilazi" Nr.28, 71000 Kaçanik

www.kk.rks-gov.net/kaçanik

RAPORTI VJETOR 2023

FJALA E KRYETARIT

Bazuar në obligimet tona ligjore, përmes raportit të ekzekutivit komunal, do të raportoj për punën dhe aktivitetet komunale të realizuara gjatë vitit 2023.

Vitin që lamë pas ishte vit sfidues jo vetëm për ne. Ndër sfidat nga të cilat ndikoi më së shumti në punën dhe funksionimin e komunës, pa dyshim që ishte inflacioni dhe mungesa e përkrahjes bugjetore nga niveli qendror.

Megjithatë, përkundër vështirësive që kemi hasur, jemi munduar që në mënyrë të drejtë dhe kredibile të punojmë në realizimin e planifikimeve tona për të realizuar projektet dhe aktivitetet komunale.

Të gjitha punët tona janë realizuar mbi parimin e transparencës dhe llogaridhënies, elemente këto tashmë të shëndrruara në mekanizëm jetik për qeverisjen tonë. Profesionalizmi, lighshmëria, integriteti dhe etika gjatë proceseve vendimmarrëse në komuna, garantojnë llogaridhënie dhe përgjegjshmëri institucionale karshi qytetarëve.

Këto mekanizma janë instaluar dhe përkrahen fuqishëm nëçdo sferë duke përfshirë shërbimet administrative dhe menagjimin e projekteve kapitale.

Në vijëmisinë e këtij raporti, do të njoftoheni me të gjitha punët dhe projektet komunale të realizuara gjatë vitit 2023. Këto aktivitete janë përmbushur në përputhje të plotë me autorizimet ligjore që kam si kryetar I komunës siç janë realizimi i shumë projekteve infrastrukturore, si rrugë me trotuare e ndriqim, ujësjellës e kanalizime, zhvillim ekonomik, investime në sektorin bujqësor, infrastrukturë arsimore e shëndetësi dhe kulturë, rini e sport.

RAPORTI VJETOR 2023



Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Një nga synimet kryesore të administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj, objektivat shumë dimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhënëse për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikëpamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht në përparimin në teknologji që pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në planin dhe programin qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe efiqienca merr një vëmendje të rëndësishme kur përpiqemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensioni i transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme. Mbi këto parime, DAP ka ushtruar funksionin e saj statutor dhe në këtë raport shfaqet puna një vjeqare e kësaj drejtorie bashkë me sektorët e saj sipas organogramit.

Qendra Komunale për Shërbime me Qytetar

Një ndër sektorët më vital për funksionimin e duhur të institucionit lokal është Qendra për Shërbime me Qytetar. Andaj për ofrimin e shërbimeve më të shpejta dhe efikase ky sektor është paisur me pajisje teknologjike të reja dhe inventar. Gjatë vitit 2023 në sektorin e Shërbimit me Qytetar janë pranuar, procesuar dhe përfunduar 33.508 lëndë. Më poshtë mund të shihni tabelën e detajuar.

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezullar	Ceduar	Anulluar	Përfunduar	Totali
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	5	19	1,963	11	0	0	0	4	18,182	20,184
DA	Drejtoria e Arsimit	16	55	983	238	31	16	3	14	0	1,356
DBZHRP	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	4	17	1,109	218	0	0	0	3	0	1,351
DBF	Drejtoria e Buxhetit dhe Financave	4	208	1,178	5	0	0	0	0	0	1,395
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	3	18	234	5	0	0	0	2	0	262
DESHIP	Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	13	16	544	38	0	0	0	4	0	615
DUKIMM	Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	47	3,911	1,559	8	0	0	0	19	0	5,544
SHK	Shërbimi i Kryetarit	54	834	1,192	526	5	2	1	8	0	2,622
DKRS	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2	60	36	0	0	0	0	0	0	98
DZHET	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	1	0	77	3	0	0	0	0	0	81
		149	5,138	8,875	1,052	36	18	4	54	18,182	33,508

Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Zyra Komunale e Gjendjes Civile për vitin 2023 ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saja në bazë të autorizimeve ligjore si në vijim:

Përshkrimi

Copë

Ekstrakte të Lindjes	15535
Certifikata të Lindjes	6587
Certifikata e Martesës	3869
Certifikata e Vdekjes	1237
Certifikata e Gjendjes Martesore	461
Deklarata Familjare	4094
Certifikata e Vendbanimit	1856
Certifikata e Shtetësisë	141
Vërtetime të Arkivit	688
Dëshmi Vdekje	158

Totali: 34626

Tab. 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2023-31/12/2023.

Përshkrimi

Copë

Regjistrime të Lindjes të Rregullta	00
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	555
Shpallje të martesave	497
Kurorëzime	497
Kurorëzime speciale	89
Regjistrime të vdekjes të rregullta	158
Regjistrime të vdekjes speciale	39
Lëndë të kompletuara për fitim të shtetësisë RKS	24

RAPORTI VJETOR 2023

Lëndë të kompletuara për tërheqje të shtetësisë RKS	34
Vendime të ndryshme	78
Kërkesa për verifikime	45

Tab. 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01/01/2023 - 31/12/2023.

Gjatë këtij viti janë mbajtur takime me MPB-në , saktësisht me Agjencionin e Regjistrimit Civil si dhe Udhëheqësin e Departamentit të Shtetësis rreth procedurave të sistemit të gjendjes civile .Përkatësisht regjistrimet e mëvonshme në lindje dhe regjistrimet e shtetësis për personat mbi 18 vjet që nuk posedojn dokument identifikimi të UNMIK-ut ose të RKS-së.

Është bërë lidhja e akteve të regjistrimeve të lindjes, martesës dhe vdekjes nga viti 2016 deri në vitin 2022, gjithashtu është bërë edhe rregullimi i librave amë të dëmtuara gjatë përdorimit.

Në kuadër të punës të ZKGC janë përgatitur statistikat mujore dhe janë dërguar me kohë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësim janë dërguar me kohë në ARC.

Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre.

Jemi kujdesur për funksionimin e rregulltë të e-kisokut dhe furnizimin me kohë me çertifikata, kemi miratuar me kohë lëndët për vitin 2023 në internet për sektorin e Gjendjes Civile.

Gjithashtu janë vizituar herë pas here edhe zyret e gjendjes civile të cilat operojn në terrenin e komunës së Kaçanikut.

Arkivi

1.PUNË NË ZYRE

Gjatë vitit 2023 , Sektori i Arkivit ka punuar dhe është angazhuar me punimin, rregullimin, klasifikimin, sistemimin e lëndëve arkivore sipas njësisë organizative. Ka bërë punimin, rregullimin dhe regjistrimin e dokumentacionit duke krijuar data bazën e të dhënave të ish Organizatave Shoqërore-Politike që kanë vepruar në territorin e Kaçanikut, Drejtoratit për Punë të Mbrendshme (DPM) në Kaçanik 1990/1998.

Materialet e viteve 2009-2016 nga Zyra e Kryetarit janë rregulluar ,sistemuar dhe vendosur në arkiv .

Gjithashtu është bërë përzgjedhja e lëndëve sipas afateve të ruajtjes dhe materialit të pavlefshëm të cilave ju ka kaluar afati dhe si të tilla nuk kanë cilësin e lëndes akrivore.

Hartimin e procesverbalit për asgjësimin e materialit të pavlefshëm si: kërkesa për shpenzime e zyrtareve, shfrytëzimi mjeteve transportuese, raporte javore dhe mujore të Drejtorive Komunale.

Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme, vërtetime për përvojen dhe llogaritjen e stazhit të punës dhe të tjera .

2.PUNË NË DEPO - Hulumtimi për gjetjen e lëndëve arkivore sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve, bartja e lëndëve nga depo për t'i shërbyer palëve si dhe për t'i punuar në zyrë dhe anasjelltas duke i vendosur në vendin përkatës.

Rregullimi i dokumnetave në rafte sipas njësisë organizative të punës.

3. KËRKESA INTERNE - Zyrtarët e Drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit ligjor kanë parashtruar shtatëdhjet (70) kërkesa gojore për gjetjen e lëndëve arkivore dhe projekteve, të njëjtat janë kthyer në vendin përkatës.

Gjithashtu janë parashtruar tri (3) kërkesa nga Divisioni i Pensioneve të Jashtme për verifikimin e vërtetimeve të lëshuara nga Sektori i Arkivit Komunal.

4. KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA PALËT - Njëqind e njëzetë e tetë (128) kërkesa janë parashtruar nga ana e palëve .

Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale konform ligjit për Arkivat dhe ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

RAPORTI VJETOR 2023

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

SHËRBIMET SHËNDETËSORE GJATË VITIT 2023

1.Mjekësia familjare	89.024	kontrolla mjekësore
2.Urgjenca	31.587	kontrolla mjekësore
3.Stomatologjia	1,276	kontrolla mjekësore
4.Pediatria	4,643	kontrolla mjekësore
5.Vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç	1,523	
6.Vaksinimi	6390	
7.Laboratori	14,552	
8.Rëntgeni	3,900	
9.Terreni	990	
10.Shërbimet infermierike –QKMF ,QMF dhe AMF	192,091	
11.Gjinekologjia	166	
12.Pulmologjia	118	
13.Radiologjia	41	
14.Klasa për nëna dhe fëmijë	329	

TOTALI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR VITIN 2023 - 346, 630

Puna gjatë vitit 2023 ka shkuar mire,punëtorët kanë respektuar orarin dhe diciplinën në punë,të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer në të gjitha njësitë organizative të QKMF-së.

Gjatë vitit 2023, janë mbajtur takimet e rregullta mujore të Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues,me ç' rast janë diskutuar çështje të ndryshme profesionale, si dhe çështje të tjera organizative që ka të bëjë me funksionimin më të mirë të punës në QKMF.

Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm ,si dhe vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë vitit 2023 nga ana e ekipeve tona mjekësore.

MUAJI JANAR 2023

Në muajin janar është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues,me ç' rast janë diskutuar tema te ndryshme profesionale,qe kane te bejne me mbarevajtjen e procesit te punes ne QKMF dhe terren.

Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në muajin janar.Poashtu vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë muajit janar.

.Në muajin janar kemi pasë 3 raste te infektuar me Covid-19 dhe qe te 3 jane shëruar .Numri total i te infektuarve,që nga fillimi i pandemisë deri me 31 janar 2023 - **2209** ,të shëruar **2154** , te vdekur mbi **50**,raste aktive **0** !

Proçesi i vaksinimit kundër Covid-19 ka vazhduar sipas planit kombëtar të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë deri me datën 31 janar 2023 janë administruar në total **34,155** doza, me

RAPORTI VJETOR 2023

dozen e pare janë vaksinuar **17,992**, me dozen e dytë janë vaksinuar **14,626**,si me dozen e tretë **1,512**, me dozen e katert- **15**.

Në muajin janar **2023** në QKMF dhe terren janë kryer **16937** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **7678** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **668**

raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **3003** pacientë,injeksione **3468**,infuzione **1760**,lidhje dhe pastrim të plagëve **784**, janë bërë **288** Ekg-ja,inhalime **169**,janë realizuar **179** vizita shtëpijake ,triazhime **169**,përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **470** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **578**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **91**,në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1150** pacientë,në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **244** pacientë,pediatria **453** kontrolla mjekësore.

MUAJI SHKURT 2023

Në muajin **SHKURT** është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues,Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në muajin shkurt.Poashtu vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë muajit shkurt.

.Në muajin **SHKURT**, kemi pasë 1 rast te infektuar me Covid-19. .Numri total i te infektuarve deri me **28.02.2023**,që nga fillimi i pandemisë **2210** ,të shëruar **2154**,të vdekur mbi **50** , raste aktive **1**. Proçesi i vaksinimit kundër Covid-19 ka vazhduar sipas planit kombëtar të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë deri me datën 28 shkurt 2023 janë administruar në total **34,155** doza, me dozen e pare janë vaksinuar **17,992**, me dozen e dytë janë vaksinuar **14,626**, me dozen e tretë **1,512**,kurse me dozen e katërt – **15**.

Me vaksinën kunder gripit gjate muajit **shkurt 2023**,jane vaksinuar **1139** qytetarë.

Në muajin **SHKURT 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **15554** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6788** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **644** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2169** pacientë,injeksione **3943**,infuzione **1427** lidhje dhe pastrim të plagëve **680**, janë bërë **308** Ekg-ja,inhalime **172**,janë realizuar **141** vizita shtëpijake ,triazhime **100** përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1379** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **580**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **98**,në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1159** pacientë,pediatria **500** paciente.

MUAJI MARS 2023

Në muajin **MARS** është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues,Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në muajin shtator.Poashtu vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë muajit mars.

.Në muajin **MARS**, kemi pasë 1 rast te infektuar me Covid-19. .Numri total i te infektuarve deri me **31.03.2023**,që nga fillimi i pandemisë **2211** ,të shëruar **2155**,të vdekur mbi **50** , raste aktive **1**

Në muajin **mars 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **16628** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **7549** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **735** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2481** pacientë,injeksione **2887**,infuzione **2776** lidhje dhe pastrim të plagëve **1052**, janë bërë **190** Ekg-ja,inhalime **274**,janë realizuar **158** vizita shtëpijake ,triazhime **176** përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **272** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **758**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **124**,në laborator

RAPORTI VJETOR 2023

kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1316**, pacientë,në njësinë e rëntgenit **195**, pediatria **597** paciente.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekesor nga Ministria e Shendetesise gjate muajit **mars** nuk ka qene ne nivelin e deshiruar, mungon

Diklofenaku,Synopeni,Aspirini,,Adrenalina,Clopidogreli ,Amlodipina,shpatullat per ekzaminim te fytit,shurupi Paracetamol per femije,hidrogjeni,pra verehet nje mungese e terapise ampullare.

Me insulin jemi mire te furnizuar ! Me daten 15 mars 2023 deri me 22 mars 2023 nje ekip mjekesor i perbere nga 1 mjek dhe 2 infermiere kane qendruar ne Brezovice ne kuader te aktiviteteve qe jane zhvilluar me nxenesit e shkollave fillore ne sportin e skijimit me moton „Drejt Malit “. Ky aktivitet mbahet cdo vjet ne kete kohe dhe eshte kerkuar nga Ministria e Shendetesise ,qe secila komune te dergoje nje ekip mjekesor ,qe te kujdesen per shendetin e pjesemarresve ne kete aktivitet per 8 dite .Poashtu gjate gjithë kohes ka qene prezent edhe autoambulanca ne Brezovice.

Me adten 18 mars 2023 eshte funksionalizuar edhe puna ne AMF-Shtraze ,ku cdo te shtune nga ora 10.00 deri ne ora 13.00 do te ofrohen sherbime shendetesore vullnetarisht nga mjeket Dr.Fadil Gashi- pediater,Dr.Imri Guri –pediater dhe Dr.Muharrem Haliti – mjek familjar..Ata kane nenshkruar kontrate 1 vjeqare me DSHMS-ne per te ofruar sherbime shendetesore vullnetare ne AMF- Shtraze. .Nga QKMF-ja do te jete i angazhuar 1 infermier cdo te shtune nga ora 10.00 deri ne ora 13.00.

MUAJI PRILL 2023

.Në muajin **prill**, kemi pasë 1 rast te infektuar me Covid-19. .Numri total i te infektuarve deri me **30.04.2023**,që nga fillimi i pandemisë **2211** ,të shëruar **2156**,të vdekur **mbi 50** , raste aktive **0**.

Në muajin **prill 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **15807** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **7689** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **736** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2481** pacientë,injeksione **2892**,infuzione **2697** lidhje dhe pastrim të plagëve **1123**, janë bërë **183**Ekg-ja,inhalime **274**,janë realizuar **158** vizita shtëpijake ,triazhime **176** përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **272** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **237**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **124**,në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1389**, pacientë,në njësinë e rëntgenit **195** , pediatria **602** paciente.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekesor nga Ministria e Shendetesise gjate muajit **prill** nuk ka qene ne nivelin e deshiruar, mungon

Diklofenaku,Synopeni,Aspirini,,Adrenalina,Clopidogreli ,Amlodipina,shpatullat per ekzaminim te fytit,shurupi Paracetamol per femije,hidrogjeni,pra verehet nje mungese e terapise ampullare.

Me insulin jemi mire te furnizuar . Me datën 08 prill 2023 është mbajtur turniri mbarëkombëtar i mundjes në Kaçanik,ku një ekip mjekësor ka qëndruar në Palestrën e Sportit për t,u kujdesur për shëndetin e pjesëmarrëve në garë . QKMF-ja është nderuar me mirënjohje nga Federata e Mundjes së Kosovës për kontributin e dhënë të saj në zhvillimin e sportit të mundjes.

Gjatë muajit prill 2023 janë mbajtur trajnimet për mjekë dhe infermierë në lëminë e vaksinimit ,si dhe në lëminë e psikiatrisë .Trajnimet kanë rëndësi për t,u njohur me të rejtat e fundit,si dhe i duhen stafit shëndetësor pike akredituese(çdo vjet nga 20 pikë) për rilicencim çdo 5 vjet.

RAPORTI VJETOR 2023

Prej muajit prill kemi bërë riorganizim të ri të punës në QKMF-Kaçanik ,ku njësia e rëntgenit do të punojë edhe pasdite ,laboratori do të ofrojë shërbime shëndetësore edhe të shtuneve dhe festave zyrtare.Poashtu edhe stomatologjia do të punojë edhe festave zyrtare.
Me datën 21.04.2023 kemi marrë pjesë në shënimin e Javës së Imunizimit të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë,Unicefi,AMC-ja,Be,USAIDI .Aty u potencua roli i vaksinimit në parandalimit e sëmundjeve. Vlen të theksohet se kalendari i vaksinimit në Kosovë është plotësuar me 3 vaksina të reja: vaksina kundër human papilloma virusit,vaksina kundër rotavirusit,si dhe vaksina kundër pneumoonisë (pneumovacc).

MUAJI MAJ 2023

.Në muajin **maj**,nuk kemi pasë asnjë rast te infektuar me Covid-19.

Në muajin **maj 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **13912** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6910** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **715** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2611** pacientë,injeksione **2664**,infuzione **1393** lidhje dhe pastrim të plagëve **1118**, janë bërë **205** Ekg-ja,inhalime **119**,janë realizuar **166** vizita shtëpijake ,triazhime **33** përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **934** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **483**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **107**,në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1239**, pacientë,në njësinë e rëntgenit **411** , pediatria **412** paciente.

Me datën 12 maj 2023 është shënuar dita ndërkombëtare e infermierisë, me ç`rast një ekip mjekësor ka qëndruar për disa orë në bulevardin,„Ismajl Raka “ ku kanë bërë matjen e glikemisë,hipertensionit,si dhe janë dhënë këshilla mjekësore falas për qytetarët e Kaçanikut.

Me datën 17 maj 2023 është shënuar 17 maji- dita ndërkombëtare e hipertensionit.Për këtë qëllim një ekip mjekësor në oborrin e QKMF-së ka ofruar shërbime shëndetësore falas për qytetarët tanë me ç`rast është bërë matja e tensionit arterial,si dhe janë dhënë këshilla për hipertensionin,si dhe parandalimin e tij.

Me datën 19 maj 2023 është shënuar Dita ndërkombëtare e mjekut familjar ,me ç`rast janë informuar pacientët për rolin dhe detyrat e mjekut familjar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve.

Me datën 26 maj 2023 kemi pranuar donacion nga Ministria e Shëndetësisë,Unicefi dhe AMC-ja - 1 llaptop dhe 6 tablet ,të cilët do të shfrytëzohen nga infermieret për programin e vizitave shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç.

Me datën 31 maj 2023 është shënuar Dita Botërore e luftës kundër duhanit ,me ç`rast një ekip mjekësor nga QKMF-ja ka qëndruar për disa orë në SHFMU,„Emin Duraku” për të dhënë këshilla për nxënësit e kësaj shkolle për pasojat e konsumimit të duhanit,si dhe janë shpërndarë fletushka.

MUAJI QERSHOR 2023

.Në muajin **qershor**,nuk kemi pasë asnjë rast te infektuar me Covid-19.Në muajin **qershor 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **15901** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6910** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **317** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2611** pacientë,injeksione **2575**,infuzione **1238** lidhje dhe pastrim të plagëve **989**, janë

RAPORTI VJETOR 2023

bërë 309 Ekg-ja, inhalime 153, janë realizuar 165 vizita shtëpijake , përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet 1128 që janë realizuar në QKMF, njesia e vaksinimit 1800, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike 90, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike 1147, pacientë, në njësinë e rëntgenit 384 , pediatria 503 paciente. Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit qershor nuk ka qene ne nivelin e deshiruar, mungon

Aminophylini, Diklofenaku, Urbasoni, Dexasoni, Synopeni, Clopidogreli , Amlodipina, shpatullat per ekzaminim te fytit, shurupi Paracetamol per femije, hidrogjeni, pra verehet nje mungese e terapise ampullare. Me insulin jemi mire te furnizuar , poashtu jemi furnizuar gjatë muajit qershor me Metformin, Aspirin, Enap. Nuk kemi pasur furnizim me material shpenzues mjekësor nga Ministria. Kurse fatmirsisht pas kontraktimit të një kompanie për furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenjies Sociale gjatë muajit qershor, gjendjen me furnizim me barna është stabilizuar.

Me datën 15.06.2023 një ekip mjekësor nga QKMF-Kaçanik është kujdesur për shëndetin e nxënësve dhe stafit arsimor në aktivitetin e organizuar nga Ministria e Kulturës, Shoqata e Pedagogëve të kulturës fizike

Me datën 29 qershor kemi marrë vendim , që të bëjmë një riorganizim të punës në QKMF-Kaçanik nga data 01.07.2023 dhe kemi bërë tërheqjen e stafit shëndetësor nga disa punkte shëndetësore për shkak të rritjes së numrit të pacientëve që kërkojnë shërbime shëndetësore në QKMF. Ndërrimi i natës gjatë muajve korrik dhe gusht 2023 do të ketë nga 2 mjekë .

MUAJI KORRIK 2023

.Në muajin korrik, nuk kemi pasë asnjë rast te infektuar me Covid-19. Në muajin korrik 2023 në QKMF dhe terren janë kryer 17737 shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer 8461 kontrolla mjekësore, janë referuar për në spital 739 raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore 3323 pacientë, injeksione 2531, infuzione 2212 lidhje dhe pastrim të plagëve 1708, janë bërë 281 Ekg-ja, inhalime 179, janë realizuar 187 vizita shtëpijake , përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet 773 që janë realizuar në QKMF, njesia e vaksinimit 369, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike 119, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike 1038, pacientë, në njësinë e rëntgenit 401 , pediatria 137 paciente. Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit korrik nuk ka qene ne nivelin e deshiruar. Mungon Aminophylini, Diklofenaku, Urbasoni, Dexasoni, Synopeni, Clopidogreli , Amlodipina, shpatullat per ekzaminim te fytit, shurupi Paracetamol per femije, pra verehet nje mungese e terapise ampullare. Me insulin jemi mire te furnizuar , poashtu jemi furnizuar gjatë muajit korrik me terapi tabletare për hipertension, diabet dhe antibiotikë të llojit Amoxicilin, Bactrim , Doxycyclin. Nuk kemi pasur furnizim me material shpenzues mjekësor nga Ministria, por që në stok kemi.

MUAJI GUSHT 2023

Në muajin GUSHT 2023 në QKMF dhe terren janë kryer 16568 shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer 8158 kontrolla mjekësore, janë referuar për në spital 7396 raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore 3411 pacientë, injeksione 2744, infuzione 2099 lidhje dhe pastrim të plagëve 1172, janë bërë 389 Ekg-ja, inhalime 131, janë realizuar 116 vizita shtëpijake ,

RAPORTI VJETOR 2023

përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1026** që janë realizuar në QKMF, njesia e vaksinimit **302**, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **79**, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1212**, pacientë, në njësinë e rëntgenit **421**, pediatria **382** paciente.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit **gusht** nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar. Mungon Aminophylini, Diklofenaku, Urbasoni, Dexasoni, Synopeni, Clopidogreli, Amlodipina, shpatullat për ekzaminim të fytyrës, shurupi Paracetamol për fëmijë, pra verëhet një mungesë e terapise ampullare. Me insulin jemi mirë të furnizuar, poashtu jemi furnizuar gjatë muajit gusht me terapi tabletare për hipertension, diabet dhe antibiotikë të llojit Amoxycilin, Bactrim, Doxycyclin. Nuk kemi pasur furnizim me material shpenzues mjekësor nga Ministria, por që në stok kemi. Kurse fatmirsisht pas kontraktimit të një kompanie për furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenjies Sociale gjatë muajit gusht, gjendjen me furnizim me barna është stabilizuar.

Edhe gjatë muajit gusht kemi pasur raste me meningjit, por ata kanë qenë raste sporadike dhe se me fundin e muajit gusht situatë është stabilizuar.

Me datën 14.08.2023, QKMF-ja ka pranuar nga AQH-ja 1 aparat për matjen e HbA1c, disa pajisje mjekësore, 2 çanta mjekësore për vizita shtëpijake.

MUAJI SHTATOR 2023

Në muajin **shtator** në QKMF dhe terren janë kryer **16 454** shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer **8056** kontrolla mjekësore, janë referuar për në spital **778** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2632** pacientë, injeksione **2398**, infuzione **1567** lidhje dhe pastrim të plagëve **1122**, janë bërë **318** Ekg-ja, inhalime **56**, janë realizuar **123** vizita shtëpijake, përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1551** që janë realizuar në QKMF, njesia e vaksinimit **316**, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **100**, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1275**, pacientë, në njësinë e rëntgenit **441**, pediatria **487** paciente.

Me datën 03.09.2023 një ekip mjekësor ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar për nder të 7 shtatorit – Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga Shoqata Bjeshkatare Alpiniste, „Kaçaniku 2015“. Ekipi mjekësor gjatë gjithë kohës sa është mbajtur aktiviteti është kujdesur për shëndetin e pjesëmarrësve. Në shenjë respekti QKMF-ja është nderuar me mirënjohje nga organizatori i këtij aktiviteti.

Me datën 17.09.2023 një ekip mjekësor nga QKMF-ja ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Motocross, „Kaçaniku“. Në shenjë respekti është ndarë mirënjohje për QKMF-në nga organizatori.

Edhe gjatë muajit shtator janë mbajtur trajnime për stafin shëndetësor për procesin e vaksinimit, për programin për vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç. Këto trajnime janë organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, UNICEF-I, AMC-ja.

Me datën 28 shtator 2023 është mbajtur ligjërata nga Prof. Dr. Lul Raka me temë „Parandalimi i infeksioneve në Kujdesin Primar Shëndetësor“ e organizuar nga AQH-ja. Në këtë ligjëratë kanë marrë pjesë mjekë dhe infermierë nga QKMF-Kaçanik dhe Hani i Elezit.

RAPORTI VJETOR 2023

MUAJI TETOR 2023

Ne muajin tetor në QKMF dhe terren janë kryer 14 668 shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer 7391 kontrollat mjekësore, janë referuar për në spital 802 raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore 2503 pacientë, injeksione 2187, infuzione 1665 lidhje dhe pastrim të plagëve 1504, janë bërë 428 Ekg-ja, inhalime 124, janë realizuar 193 vizita shtëpijake, vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç – 162, përkrahje dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet 801 që janë realizuar në QKMF, njësia e vaksinimit 350, si dhe kontrollat mjekësore stomatologjike 128, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike 1219, pacientë, në njësinë e rëntgenit 4290, pediatria 570 paciente.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit tetor ka qenë në mënyrë të mirë se në muajin shtator. Jemi të furnizuar me insulinë, si dhe me terapi tabletare për sëmundjen e sheqerit, për hipertension, për yndyrë. Poashtu edhe me material shpenzues mjekësor jemi të furnizuar.

Poashtu jemi furnizuar edhe nga komuna me barna dhe gjendjen e furnizimit e kemi shumë të mirë.

Gjatë muajit tetor kanë filluar edhe punimet në QKMF-Kaçanik, ku është bërë lysterja e hapësirave të brendshme të QKMF-së dhe vendosja e ndriçimit të ri. Poashtu janë vendosur edhe aparatet për tharjen e duarve, si dhe vendosja e aparateve për ujë të pijes nëpër hapësira ku presin pacientët, si dhe për staf shëndetësor.

Me datën 3 tetor është mbajtur ligjërata nga infermieret tona me temën „Promovimi i gjidhënjes” ku kanë marrë pjesë nënat e reja. Prezent ishin edhe përfaqësueset nga Aksioni për nëna dhe fëmijë zonja Albiona Beha-Beselica, si dhe zonja Labërie Çarreti.

Në kuadër të muajit tetor – muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit edhe në komunën tona janë realizuar disa aktivitete. Me datën 11 tetor 2023 nga ora 13.00 është organizuar ecje në përkrahje të grave, që po luftojnë me kancerin e gjirit si dhe sensibilizimi i opinionit për kancerin e gjirit, si dhe rreziqet e tij.

Me datën 12 tetor 2023 në QKMF-Kaçanik është mbajtur ligjërata për „Kancerin e Gjirit” nga Dr. Mimoza Salihu Bajraktari dhe kryeinfermierja Filkizare Çuni Dema. Në këtë ligjëratë kanë marrë pjesë gra dhe femra nga komuna jonë. Dy prej tyre rrëfyer përvojën e tyre me kancerin e gjirit, përballjen dhe sfidat me të, si dhe fitimin e betejës me kancerin e gjirit.

Me datën 13 tetor 2023 është mbajtur ligjërata me temën „Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve me pacientë dhe kolegë” nga Kryetari i Shoqatës për të drejtat e pacientëve në Kosovë- PRAK, z. Besim Kodra. Në këtë ligjëratë morën pjesë mjekë dhe infermierë nga QKMF-ja në Kaçanik.

Me datën 31 tetor ka arritur mamografi mobil në QKMF-Kaçanik dhe nga data 01.11.2023 deri me datën 06.11.2023, mamografinë e kanë realizuar mbi 60 femra dhe gra. Poashtu gjatë muajit tetor disa gra nga komuna jonë janë dërguar në QKMF-Ferizaj për të realizuar mamografinë. Kjo ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit QKMF-Kaçanik- QKMF-Ferizaj.

Me datën 23 tetor 2023 kemi pranuar veturën e re Kombi –VW me km 00, investim nga Komuna e Kaçanikut përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenjie Sociale. Kjo veturë do të përdoret për transportin e pacientëve për në Spitalin e Ferizajit për të kryer hemodializën. Vlera e investimit nga DSHMS-ja kap vlerën prej 49,500 €.

RAPORTI VJETOR 2023

MUAJI NËNTOR 2023

Në muajin **NËNTOR** është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues, Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit, si dhe te të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në muajin nëntor. Poashtu vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë muajit nëntor. Gjatë muajit **nëntor 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **13 247** shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer **6584** kontrolla mjekësore, janë referuar për në spital **739** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2055** pacientë, injeksione **2046**, infuzione **1269** lidhje dhe pastrim të plagëve **997**, janë bërë **296** Ekg-ja, inhalime **120**, janë realizuar **153** vizita shtëpijake, vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha **0-3 vjeç – 151**, përkrahime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1318** që janë realizuar në QKMF, njësia e vaksinimit **190**, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **111**, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1131**, pacientë, në njësinë e rëntgenit **389**, pediatria **396** paciente. Deri me datën 30 nëntor 2023 kundër gripit sezonal janë vaksinuar **796** qytetarë

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit **nëntor** ka qenë në mënyrë të mirë se në muajin tetor. Jemi të furnizuar me insulin, si dhe me terapi tabletare për sëmundjen e sheqerit, për hipertension, për yndyrë. Poashtu edhe me material shpenzues mjekësor jemi të furnizuar.

Poashtu jemi furnizuar edhe nga komuna me barna dhe gjendjen e furnizimit e kemi shumë të mire.

Gjatë muajit nëntor kanë përfunduar punimet në QKMF-Kaçanik, ku është bërë lysterja e hapësirave të brendshme të QKMF-së dhe vendosja e ndriçimit të ri.

Me datën 8 nëntor 2023 kemi përfituar një veturë nga Ministria e Shëndetësisë, Peugeot Partner. Kjo veturë do të përdoret për vizitat shtëpijake, si dhe do të jetë në shërbim të njësisë së vaksinimit.

Me datën 14.11.2023 është shënuar Dita Botërore e diabetit, me ç'rast një ekip mjekësor ka qëndruar për disa orë në Bulevardin, „Ismajl Raka” ku janë ofruar shërbime shëndetësore falas për qytetarët tanë siç janë matja e sheqerit (glikemisë), si dhe janë dhënë këshilla mjekësore për diabetin, si dhe parandalimin e tij.

Me datën 14 nëntor 2023 ka filluar punën pulmologu Dr. Ramadan Dedinja. Ai do të jetë në shërbim të qytetarëve tanë çdo të hënë nga ora 10.00. Ky shërbim specialistik ka munguar që nga viti 2019 dhe financohet nga CDF-ja zvicerane dhe përkrahur nga OJQ „Kea” me Drejtor Dr. Xhevat Kurhasani – specialist i pulmologjisë.

MUAJI DHJETOR 2023

Gjatë muajit **dhjetor 2023** në QKMF dhe terren janë kryer **13 712** shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer **6850** kontrolla mjekësore, shërbime infermierike **6862**, janë referuar për në spital **709** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2307** pacientë, injeksione **2393**, infuzione **1340** lidhje dhe pastrim të plagëve **786**, janë bërë **464** Ekg-ja, inhalime **161**, janë realizuar **171** vizita shtëpijake, vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha **0-3 vjeç – 163**, përkrahime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1174** që janë realizuar në QKMF, njësia e vaksinimit **427**, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **105**, në laborator kanë

RAPORTI VJETOR 2023

kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1097**, pacientë,në njësinë e rëntgenit **390** , pediatria **214** paciente,,gjinekologjia **166** ,pulmologjia **118**,radiologjia **41**.

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë gjatë muajit **dhjetor** ka qenë më e mirë se në muajin nëntor.Jemi të furnizuar me insulin,si dhe me terapi tabletare për sëmundjen e sheqerit,për hipertension,për yndyrë.Poashtu edhe me material shpenzues mjekësor jemi të furnizuar.

Poashtu jemi furnizuar edhe nga komuna me barna dhe gjendjen e furnizimit e kemi shumë të mire.

Me datën 01 dhjetor 2023 kanë filluar punën në QKMF-Kaçanik specialistja e gjinekologjisë Dr.Paulina Lumezi dhe specialisti i radiologjisë Dr.Mentor Trena.

Gjinekolog-ja do të punojë 4 herë në javë(të marten,të mërkuren, të enjten dhe të premten),kurse radiologu 1 herë në javë (ditën e premte nga ora 16).

Në muajin dhjetor është rregulluar ndriçimi në oborrin e urgjencës ,si dhe te mjekësia familjare.Gjatë muajit dhjetor kanë vazhduar trajnimet për mjekë dhe infermierë në kuadër të Edukimit të vazhdueshëm profesional.

Gjatë muajit dhjetor jemi furnizuar nga Komuna me pajisje mjekësore,si dhe veshmbathje.

Gjatë muajit dhjetor ka vazhduar mirëmbajtja e pajisjeve elektrike dhe pajisjeve mjekësore.

Aparati i rëntgenit ka qenë në defekt,por problemi është zgjedhur.

Gjatë muajit dhjetor ka vazhduar mirëmbajtje,servisimi dhe regjistrimi i veturave të QKMF-së.

Gjatë vitit 2023 në Qendrën Për Punë Sociale në Kaçanik janë adresuar **530** kërkesa, lëndë të protokoluara në të dy shërbimet

1. Shërbimi Social dhe

2. Asistenca Sociale

Në Qendër për Punë Sociale ofrohen mbi 85 shërbime të ndryshme, Qendrës për Punë Sociale në Kaçanik, Shërbimi Social është angazhuar në realizimin e planit të punës duke punuar në të gjitha format që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Gjatë kësaj kohe kemi zbatuar tërë legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Shërbimet Sociale dhe Familjare.

Fëmijët pa kujdes prindëror:

- a) Fëmijët pa të dy prindërit
- b) Fëmijët e braktisur
- c) Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejnë detyrat prindërore

Fëmijët pakujdesin prindor	Nr. i fëmijëve/mujori 2023	Përzgjedhja e familjes	kujdestari	Strehimi i përkoshëm	Strehimi familjar	Adoptimi	Referenca në institucionet tjera	Pregaditja e strehimit	Përcjellja e fëmijëve nën përkujdesje	Rastet në proces	Të mbyllura	Total
Fëmijët pa të dy prindërit	5	po	5	po	po	jo	po	-	Të gjithë fëmijët janë përcjellur	jo		5
Fëmijët e braktisur	jo	jo	jo	-	jo	jo	jo	-		jo		jo
Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejn obligimet	0	po				-		-	jo	0	0	0

Nga tabela e lartëshënuar konstatohet këtë:

Fëmijë të braktisur gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur .

Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindërore

Fëmijët e familjeve në konflikt me ligjin:

- Keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënja pas dore
- Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të ç'rregulluara
- Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar

Tab. nr. 2

Fëmijët e familjeve në konflikt	Ndërmjetësimi	Strehimi i Përkohëshëm i fëmijëve	Inicimi i procedurave për marrjen e të drejtës prindërore	Caktimi i kujdestarit	Bashkëpunimi Me institucionet tjera	Raste Në proces	Të Mbyllura
a) Keqtrajtimi dhe lënja pas dore	8	-	3	3	po	2	6
b) Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të ç'rregulluara	06	-	-	-	po	4	2

Gjatë këtij viti 2023 jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre.

Zyrtarët e Shërbimit Social janë marrë me përkujdesjen dhe përcjelljen e rastit, fëmijët janë vizituar dhe është biseduar me prindërit e tyre.

Më lartë (tab.2) kemi paraqitur tabelën e kësaj forme të Mbrojtjes Sociale.

Në këtë periudhë kohore jemi ballafaquar edhe me problemin e fëmijëve të familjeve me ç'rregullime bashkëshortore ku ky numer i fëmijëve arrinë në 06, ndërsa, në trajtim të QPS nga Zyrtarët e Shërbimit Social këtyre fëmijëve iu është dhënë mendimi për besueshmërinë e njërit prind i cili ka aftësi për tu kujdesur për rritjen, edukim dhe zhvillimin normal të cilat janë kërkuar nga gjykata.

Fëmijët dhe rinia me sjellje të ç'rregulluara

Tab. nr. 3.

Fëmijet dhe rinia me sjellje të ç'rregulluar	Puna me familje dhe fëmijë	Bashkpunimi me shkollë	Me policij	Me gjyq	Me OJQ	Propozimi i masës educative dhe alternative	Përcjellja e masës educative dhe alternative	Rastet në proces të rij / të vetër	Të mbyllur	Total
a) Fëmijët me sjellje asoiale të mosh. 14	10	4	po	po	po	4	po	2	08	10
b) Rinia me sjellje asoiale 14-16	08	06	-	po	po	-	-	-	06	08
Delekkuentët e rritur 16-18	72	po	po	20		po	po		po	72

Prej këtij numri të 72 delekuentëve, 32 kanë kryer vepra penale, ndërsa 40 kanë kryer vepra kundërvajtëse.

Nga ky numër i delekuentëve kemi 20 përsëritës të veprave (Recidivist).

Masa të shqiptuara ndaj këtyre delekuntëve kemi : 40 delekuent kanë masën edukative- Kujdesi i shtuar prindëror, 20 delekuent kanë masën - Kujdesin e shtuar të Organit të Kujdestarisë .

Të tjerat janë në procese të gjykateve, në rastet e delekuentëve Zyrtarët e Shërbimit Social kanë marr pjesë gjatë intervistimit në SHPK-së Kaçanik, në 52 raste në kohë të ndryshme.

Strehimi në strehimore

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 5 raste të strehuara në strehimore të ndryshme në nivel vendi, gjinia e tyre ka qenë kryesisht femra të cilat kanë pasur ç'rregullime bashkëshortore, dhunë familjare por edhe nga personat jashtë familjes. Për shkak të rezikshmerisë është paraparë që të dërgohen në strehimore të ndryshme, ku qëndrimi i tyre ka qenë deri në 3 javë.

Fëmijët me Aftësi të Kufizuara të Përherëshme (FAKP)

Gjatë këtij viti 2023 kemi pasur 19 aplikime, Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përherëshme (FAKP), kanë kaluar në Komision Mjekësor 11 raste pozitiv, ndërsa 8 janë refuzuar nga komisioni mjekësor. Në vit janë mbajtur 3 Komisione Mjekësore, ndërsa numri i përgjithshëm i Fëmijëve që marrin pension, skema femijë me aftësi të kufizuara të përherëshme janë gjithsej 64 fëmijë, këta fëmijë mbështeten në shumë prej 100 euro në muaj.

Në këtë kategori të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përherëshme kemi evidentuar dhe i kemi udhëzuar që të gjejnë shërbim adekuat në institucionet përkatëse ,njëkohësisht i kemi udhëzuar lidhur me mundësinë e edukimit dhe arsimimit në shkolla speciale.

Të rriturit me nevoja të veçanta

Tab. nr. 5

Të rriturit me nevoja të veçanta	Identifikim i rasteve	Puna sociale me raste	Propozimi i marrjes të zotësi së veprimit	Caktimi i kujdestars	Ndima për të strehuarut	Bashkpunim i institucionet shëndetësore	Bashkpunim me institucionet tjera	Ndima për aftësim dhe punsim	Në proces	Të mbyllura	Totali
a)Psikike	Për vitin 2023	3	-	-	-	po	po	-		3	
b)Fizike	6	2	-	2		po	po	-	2	-	
c)Psikike dhe fizike	3	2	-	1	-	1	po	-	1	-	

Në QPS është evidentuar edhe kjo kategori e njerzëve ku një pjesë e tyre janë përfshirë në skemën e NS,një pjesë i'u është ofruar shërbime sociale, ndërsa një pjesë ka mbetur pa u përfshirë në ndihmë sociale për shkak të kriterëve të SNS .

QPS në Kaçanik këtë kategori vazhdimisht e ka këshilluar, orientuar që të vizitojnë Qendrën e Shëndetit Mendor në Ferizaj ku një numër i tyre janë klientë të rregullt të kësaj qendre, ku edhe trajtohen rregullisht.

RAPORTI VJETOR 2023

Të rriturit me gjendje konfliktuozë

	identifikimi	Ndërmjetsimi	Trajtimi psiko social	Bashkpunimi me policin	Me gjykatën	Me OJQ	Rastet në proces	Të mbyllura	Tatali
Të rriturit me raporte të ç'rregulluar familjare	Për vitin 2023 35 raste	31	3	po	po	po	3	29	35
Dhuna në familje	31	po	-	po	po	po	10	21	31
Personat e rritur në kontest të shkurorëzimit	10	10	-	po	po	po	2	0	10

Në këtë periudhë vjetore i kemi pasur 10 raste (çifte bashkëshortore) në kontest shkurorëzimi.

QPS insiston që prindërit pas shkurorëzimit të gëzojnë të drejtën e kontaktit me fëmijët e tyre, sipas marrëveshjes paraprakisht të caktuar në mes QPS-së dhe bashkëshortëve ose në bazë të Aktvendimit të gjykatave.

Kemi pasur 7 kontaktime të rregullta javore, kontaktime të fëmijëve me prindërit e tyre që janë në procedur ligjore të shkurorëzimit apo të shkurorëzuar.

Trafikimi i qenjeve njerzore

Gjatë këtij viti 2023 Shërbimi social nuk kemi pasur asnjë rast të lajmëruar të trafikimit me qenije njerzore të indentifikar nga Qendra për Punë Sociale.

Adoptimi (Birësimi)

Në vitin 2023 kemi vetëm një kërkesë për Adoptim, kërkesa është trajtuar nga QPS dhe ju është dhënë vlersimi, Qendra për Punë Sociale në listën e pritjes për Adoptim kemi 8 familje potenciale për Adoptim të fëmijëve të mitur .

Strehimi familjar tek të afërmit (Fëmijët pa dy prindër)

Kemi 6 raste të fëmijëve pa kujdes prindëror, të cilët janë të strehuar tek të afërmit e tyre me Ligjin e Familjes me nr. 2004/32 marrin nga 150 € në muaj deri në moshën 18 vjeç. Këta fëmijë të gjithë kanë Kujdestar Ligjor. te caktuar nga QPS, kryesisht tek të afërmit e familjes se tyre.

RAPORTI VJETOR 2023

Shërbime tjera administrative

Në këtë vitë 2023 QPS-ja gjegjësishtë Organi i Kujdestarisë ka lëshuar vërtetime të ndryshme si:
Vertetim për zotësi të veprimit **95**
Vërtetime për lirim nga shtetësia e Kosovës **25**
Aktvendime për kujdestari **5**
Vërtetime që nuk kanë obligime financiare ndaj familjes dhe personave të tjerë **12**
Raste të pranimit të atësisë dhe amsisë **7**

Strehimi rezidencial

Gjatë kësaj periudhe raportuese Shërbimi Social ka dy klient në strehimin rezidencial gjegjësishtë në Institutin Special në Shtime, poashtu kemi edhe disa raste të cilet trajtohen në Institutin e Shendetit Mendor në Ferizaj

Gjithnjë për punën dhe angazhimin tonë, për vështirësitë të cilat janë paraqitur kemi bashkëpunuar me Divizionin e Shërbimeve Sociale pranë DPSF –së, me ISP, me Shëndetit Mendor në Ferizaj, Policinë, Gjykatat, QKMF-të, dhe institucionet tjera si p.sh shkollat në nivel komunal ku kemi pasur shumë raste të referuar dhe janë trajtuar nga ana jone, ku kemi pasur sukses si në risocializimin e tyre

QPS për të gjitha rastet e referuar nga të gjitha institucionet i ka trajtuar të gjitha kërkesat dhe ka ofruar këshillime profesionale për rastet që duhet trajtuar .

SHËRBIMI I NDIHMAVE SOCIALE

Realizimi i të drejtave të qytetarëve për shërbimet e ofruara

Qendra për punë sociale lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve ka bërë përpjekje maksimale që konform ligjit të aplikueshëm të SNS-sës, të gjithë qytetarëve pa dallim kombi, feje dhe gjinie t'iu ofroj shërbime të nevojshme në ndihmën e asistencës sociale. Po ashtu jemi përpjekur maksimalisht që të gjithë parashtruesit e kërkesave ti informojmë me kohë siq e përcakton ligji, po ashtu edhe ankesave të tyre u kemi përgjigjur me kohë.

Qendra për Punë Sociale detyrat dhe punët në lëminë e ndihmave sociale gjatë vitit 2023 i ka realizuar në harmoni me ligjin e skemës sociale ,Nr.2003/15 dhe plotësim ligjin Nr.04/L-096,

për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2003/15. Në realizimin e mbrojtjes sociale Qendra për

Punë Sociale ka kryer këto detyra të punës nga fushëveprimtaria e skemës së ndihmës sociale:

a.Ka organizuar dhe realizuar format e mbrojtjes sociale në mënyrë permanente ka shërbyer për qëllime mbrojtëse të personave dhe popullates.

b.Ka evidentuar raste sociale dhe u ka dal në ndihmë të gjitha atyre familjeve të cilië i kan plotësu kriteret për ndihmë sociale.

c.Ka përcjellë të gjitha lëndët në Komision Mjekësor.

RAPORTI VJETOR 2023

d. Ju ka përgjigjur me kohë të gjitha ankesave të palëve të pa kënaqur siq është e paraparë me ligjin e skemës sociale.

Zyrtarët e skemës sociale lëndët i kanë të ndarë në bazë të terrenit, të cilët bëjnë evidentimin e një numri të konsiderueshëm të shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Obligimi kryesor i zyrtarëve për ndihmë sociale për vitin 2023 ka qenë përcjellja e rasteve që e gëzojnë të drejtën për ndihmë sociale, si dhe zbulimin dhe identifikimin e rasteve të reja që gjenden në situatë të nevojave sociale. Zbulimi i rasteve të reja është një punë permanente dhe obligim i përhershëm i punëtorve.

Raport me shkrim i skemës së ndihmës sociale

Lëndët e dërguar në komision mjeksor Në Qendrën për Punë Sociale Skema e ndihmës sociale funksionon me dy kategori:

Kategoria e I dhe kategoria e II. Që të dy këto kategori dallojnë në përcaktimin e kriterit për përcaktimin e shfrytëzimit të ndihmës sociale.

Kategorinë e parë pos të tjerave faktor me rëndësi është përcaktimi i pa aftësisë të kandidatëve nga ana

e komisionit mjeksor. QPS-ja gjatë vitit 2023 ka dërguar në komision mjeksor 657 lëndë ku prej tyre

Janë aprovuar 442 ndërsa 210 janë refuzuar ngase nuk ju është njohur pa aftësi, ndërsa plotësim 5 lëndë.

Lëndët me ankesa Palët e pa kënaqura me vendimin e zyrtarit social kanë të drejtë ligjore të parashtrijë kërkesë me shkrim për rishqyrtim të udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale në afat prej 5 ditëve.

ndërsa ankesat në DPSF të MFPT bëhet përmes QPS-së në afat prej 15 ditëve.

Gjatë vitit 2023 në MFPT janë dërguar 33 lëndë me ankesa, 32 lëndë janë refuzuar ndërsa 1 lëndë është aprovuar.

Gjatë vitit 2023 në QPS mesatarisht për çdo muaj janë intervistuar 3 palë të interesuara për ndihmë sociale,

prej tyre 24 kanë aplikuar, 19 janë aprovuar ndërsa 05 raste janë refuzuar, ndërsa 06 raste nuk kanë aplikuar fare ngase nuk i kanë plotësuar kriteret sipas ligjit 2003/15 dhe plotësim ligjit Nr.04/1-096.

Gjatë vitit 2023 janë lëshuar 20 vërtetime për marrjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Në këtë vit janë lëshuar vendime pozitive i cili numër shkon në harmoni me shfrytëzuesit e ndihmave sociale. Njëkohësisht janë lëshuar kartona për shfrytëzuesit e ndihmave Sociale dhe vërtetime që nuk janë shfrytëzues i ndihmave sociale.

Paraqitja tabelare e ndihmave sociale për vitin 2023

Totali i ndihmave për vitin 2023					
Muajt	Kat. I		Kat. II		Gjithsej
I		+		=	698
II		+		=	688
III		+		=	666
IV		+		=	630
V		+		=	618
VI		+		=	599
VII		+		=	602
VIII		+		=	597
IX		+		=	589
X		+		=	587
XI		+		=	577
XII		+		=	576
Mesat.					618.91

Tabelari pasqyron gjendjen reale të shfrytëzuesve të ndihmës sociale për gjatë muajve, të vitit 2023. Tabelari tregon qartë se gjatë këtij viti vërehet një rënie e dukshme. Krahasuar me vitin e kaluar në këtë vit kemi më pak se 151 shfrytëzues. Faktorët që kanë ndikuar në rënien e shfrytëzuesve janë të shumtë.

Drejtoria e Arsimit

Aktivitetet kryesore për realizimin e prioriteteve - Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2023

Aktivitetet kryesore për realizimin e prioritetit	Arritjet/progresi/performance kyçe gjatë vitit 2023
1. Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor	
1.1 Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor; Arsimi parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3)	<p>Funksionimi i sistemit arsimor, për nivelet e Arsimit parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3) në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-32 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-068 për arsimin më Komunitat e Republikës së Kosovës.</p> <p>Zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë e bazuar në kompetenca, përkatësisht promovimi i arsimit gjithëpërfshirës, cilësor dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet shkollore dhe përgatitja e tyre për sfidat e jetës.</p>
1.2 Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta; respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale etj.	<p>Gjithëpërfshirja ishte prioritet dhe synim për përfshirjen e të gjithë nxënësve/fëmijëve në procesin edukativ arsimor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.</p> <p>Në këtë mënyrë, në institucionet tona arsimore është arrit shkallë e kënaqshme e gjithëpërfshirjes së fëmijëve duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, ndërkohë që pjesëmarrja/përfshirja e tyre duke mësuar së bashku me të tjerët e duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënësve ka</p>

qenë vlerë e njëkohësisht edhe proces që ka ndihmuar fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Gjithëpërfshirja është e drejtë e çdo fëmije të ndjehet i respektuar, i sigurtë, i mbrojtur dhe të zhvillojë plotësisht potencialin e vet.

Ndryshe, gjatë këtij viti janë angazhuar 4 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, krahas edhe 7 të tjerave të cilat ishin të angazhuara më herët.

2. Ngritja/Avansimi i cilësisë në arsim – Zbatimi i Kurrikulës në arsimin parauniversitar

2.1 Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim -
Zbatimi i Kurrikulës së re të Kosovës

Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim mbetet prioritet, sikurse edhe ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve por edhe përgjegjësisë në punë. Zbatimi i reformave në mësimitdhënie dhe nxënie, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversitar) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë, përkatësisht përmirësimi dhe avancimi i cilësisë, mësimitdhënies e nxënies.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve dhe avancimi i të nxënit përmes mësimitdhënies cilësore duke zbatuar Kurrikulën e re të Kosovës të bazuar në pajisje teknologjike informative dhe pajisje tjera digjitale mjete tjera mësimore

<p>2.2 Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas UA Nr.06/2022, respektivisht i bazuar në rezultatet e të nxënësve dhe reflektimi i performancës së nxënësve.</p>	<p>Janë zbatuar standardet në përputhje me dispozitat e UA për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar respektivisht ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas Kornizës kurrikulare të bazuar në rezultatet e të nxënësve për kompetenca (RNK), rezultatet e të nxënësve për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore RNL).</p> <p>Sipas Kornizës Kurrikulare qëllimi kryesor i vlerësimit është mbledhja e informacioneve për përkrahjen e nxënësve në zotërimin e rezultateve të të nxënësve, arritjet individuale të nxënësve, përcaktimi i performancës dhe orientimi i tyre për shkollim të mëtejshëm.</p>
<p>2.3 Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë</p>	<p>Në Testin e Maturës, në afatin e parë, të mbajtur më 24 qershor 2023, gjithsej 223 maturant i janë nënshtruar Provimit të maturës shtetërore.</p> <p>Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 162 kandidatë, testin e maturës e kanë kaluar 119 prej tyre, apo 73.4 %, ndërsa në IAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka”, nga gjithsej 61 maturant të testuar, 23 prej tyre e kanë kaluar atë apo 37,7%. Ndërkaq, nga të dhënat e publikuara, në këtë afat, del se në nivel komunal, kalueshmëria është 63.67 % .</p> <p>Ndërkaq, në afatin e gushtit, të mbajtur më 27 gusht 2023, nga gjithsej 77 maturant sa iu kanë nënshtruar testit, 37 prej tyre kanë arrit rezultat pozitiv. Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 41 maturant, testin e kanë kaluar 25 prej tyre (60.97%) e në IAAP nga 36 maturantë, atë e kanë kaluar 12 prej tyre ose 33.3 %, kalueshmëria në nivel komunal është 48,05%.</p> <p>Testi i Arritshmërisë 2023, është mbajtur me nxënës të klasave të nënta dhe atë në dy pjesë. Pjesa e parë është mbajtur më 4 korrik 2023, në lëndët mësimore: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori dhe Gjeografi, dhe pjesa e dytë e mbajtur më 11 korrik 2023, në lëndët mësimore: Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji.</p>

	<p>Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “ Jusuf Gërvalla” nga Biqeci ka arritur rezultatin më të mirë duke u radhitur e para</p> <p>me shkallë të kalueshmërisë prej 53,85 %. Shkolla e dytë është radhitur “Naim Frashëri” nga Kotlina me 53,84 % , e treta “Kadri Zeka” nga Dubrava me 52.14 %, etj. Ndërsa në nivel komunal, është arritur kalueshmëria në shkallë prej 47,24 %.</p> <p>Testit të arritshmërisë sivjet i janë nënshtruar gjithsej 437 semimaturantë nga 12 shkolla fillore amë.</p>
<p>2.4 Trajnimi i mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare dhe furnizimi i shkollave me material pedagogjik dhe tekste shkollore</p>	<p>Trajnimet e vazhdueshme kanë qenë një komponentë e rëndësishme që kanë ndikuar pozitivisht në performancën e mësimdhënësve, ndërkaq kualifikueshmëria po thuajse 100 % e stafit arsimor, (100 % në shkollat e mesme të larta dhe 99.13 % në nivelin e shkollave fillore e të mesme të ulëta) po ashtu është një tregues dhe faktor që ndikon në rritjen e rezultateve dhe efikasitetin në mësimdhënie e nxënie.</p> <p>Drejtoria e Arsimit, me kohë ka bërë furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike e materiale tjera të nevojshme, ndërkaq nxënësit e nivelit, 1-5 sivjet, për dallim nga vitet tjera janë subvencionuar prindërit për blerjen e librave me nga 80 euro, përkatësisht ata të nivelit 6-9 me nga 30 euro, nga MASHTI, por jo edhe ata parafillor.</p>

3. Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit i bazuar në transparencë dhe llogaridhënie – Funksionimi i organeve të shkollës

3.1 Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit arsimor

Krijimi i disiplinës dhe rendit shkollor është bazë për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar duke zhvilluar një sistem funksional në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së drejtorëve të institucioneve shkollore për një shkollë moderne me nivel të lartë dhe edukim cilësor e po ashtu edhe ngritje e performancës së koordinatorëve të cilësisë dhe në përgjithësi të mësimdhënësve për një sistem efikas arsimorë.

3.2 Funksionimi i organeve të shkollës:

Drejtori/zëvendësdrejtori i shkollës, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli pedagogjik/Këshilli i arsimtarëveAktivevet Profesionale, Task Forca në nivel shkolle e DKA, Koordinatorët e cilësisë, Këshilli i prindërve e Këshilli i nxënësve dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit dhe Këshilltari i karrierës, në nivel të ShFMU-ve.

Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, koordinimi dhe ndarja e punëve e përgjegjësive në përputhje me rolin dhe kompetencat e organeve të shkollës.

Promovimi i mësimdhënies dhe avansimi i të gjitha fushave të cilësisë, **respektivisht përmirësimi i mjedisit mësimor dhe kushteve të punës** e njëkohësisht zvogëlimin në minimum të braktisjes së nxënësve në shkollë

Ndërkaq Koordinatorët e cilësisë janë angazhuar për sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave, funksionimin efikas dhe zbatimin e planit për zhvillimin e cilësisë.

Këtë vit është caktuar edhe një Këshilltar i karrierës, pozitë e re sipas politikave të MASHT-it, ku i njejtë është caktuar të punojë në ShFMU "Qamil Ilazi" Kaçanik i vjetër, por mbulon edhe disa shkolla të tjera të mesme të ulëta.

Ekipe për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues ndaj braktisjes është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

4. Investimet në infrastrukturën shkollore

4.1 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore

DKA edhe gjatë vitit që e lam pas, është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë, kabinate shkollore e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore e po ashtu edhe ndërtimin e palestrave sportive.

Para fillimit të vitit të ri shkollor 2023/24, në tri objekte shkollore janë bërë investimet kapitale të planifikuara për renovimet dhe riparimet e nevojshme. Në Gjinnazin “Skenderbeu” Kaçanik, janë kryer punimet në hyrjen e shkollës në vlerë 105 mijë euro dhe në vendosjen e ashensorit për nxënësit me nevoja të veqanta në vlerë 30 mijë euro. Në ShFMU “Qamil Ilazi” në Fushë të Pajtimit është bërë renovimi i kulmit të objektit, izolimi dhe fasadimi i jashtëm, ndërrimi i të gjitha dritareve dhe suvatimi dhe ngjyrosja e disa mureve të brendshme në vlerë 25 mijë euro, ndërsa në ShFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, në objektin e ri, në Dushkajë janë rregulluar/ndërtuar nyjat sanitare, ndërrimi i disa dyerve të klasave e nyjave sanitare, riparimi i dyshemeve në disa klasa e asfaltimi i terrenit sportiv në vlerë 85 mijë euro, e ndërkaq në objektin e shkollës në Kovaçec është bërë rregullimi i kulmit, ndërsa vlera e investimit ka qenë 14 mijë euro dhe në ShFMU “Gafur Luma” në Gllloboçicë është rregulluar busti në vlerë 4 mijë euro.

Ndërtimi i 1 (një) palestre sportive, ngec vazhdimi i ndërtimit të objektit të ri shkollor në Doganaj

Gjatë këtij viti është përruar 1 (një) palestër sportive shkollore: në ShFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj, ndërsa është në ndërtim e sipër ajo në ShFMU “Jusuf Gërvalla” Biqec.

Për ndërtimin e palestrës në Elezaj janë investuar gjithsej 315,916.41 euro nga buxheti i Komunës, poashtu MASHTI, ka bërë furnizimin e palestrës me pajisje e mjete tjera sportive.

Palestra sportive i plotëson të gjitha standardet shkollore, dhe do të jet në shërbim të gjithë nxënësve, ndërkaq kanë për qëllim promovimin e vlerave sportive si dhe masivizimin dhe zhvillimin e mëtejme të sporteve e jetës së shëndetshme dhe aktive.

Ndërkohë, gjatë këtij viti ka filluar ndërtimi edhe i një palestere sportive në ShFMU “Jusuf Gërvalla” në Biqec për të cilin objekt sivjet janë shpenzuar 200 mijë euro, nga buxheti i Komunës, ndërsa punët do të vazhdojnë për përfundimin e objektit sportiv edhe gjatë vitit 2024.

Në QEAP “Agimi” Kaçanik është instaluar pompa termike, vlera e projektit është 26,851 euro.

Ndërkohë, gjatë këtij viti kanë ngecur punimet për vazhdimin e ndërtimit të objektit të ri shkollor në Doganaj, i filluar në korrik të vitit 2019. Objekti i ri është duke u financuar nga MASHTI.

<p>4.2 Furnizimi me pajisje tjera shkollore – Printer/fotokopjues/skaner, shkolla e Strazhës pajisjet me laptop</p>	<p>Gjatë vitit 2023, disa nga shkollat janë pajisur me mjete e pajisje tjera shkollore të nevojshme. Shpërndarja e fotokopjuësve dhe kompjuterëve wshtw bwrw nw kwto shkolla: 5 Kompjuter tw ri (PC) dhe 1 fotokopjues janw dwrguar nw Gjinnazin “Skenderbeu”, 1 fotokopjues nw ShFMU “Jusuf Gwrvalla” Biqec, 1 fotokopjues nw ShFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër, 1 fotokopjues nw ShFMU “Kadri Zeka” Dubravw, 1fotokopjues në IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” në Kaçanik, 2 fotokopjues në ShFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, 1fotokopjues në ShFMU “Idriz Seferi” në Bob, 1 fotokopjues nw ShFMU “7 Shtatori” Begracw, dhe 1fotokopjues nw ShFMU “Nazmi Osmani” Elezaj, nwrsa vlera e projektit wshtw 10,245 euro.</p> <p>Në shkollën e fashatit Strazhë, paralele e ShFMU “Dituria” është bërë furnizimi me 11 laptop, donacion i KFOR-it Italian, ndërsa vlera e investuar është gjithsej 6000 euro.</p>
<p>4.3 Pako higjienike dhe paisje për ShFMU “Emin Duraku” Kaçanik, donacion nga MASHTI</p>	<p>MASHTI ka dhuruar mjete higjienikë e pajisje tjera pune për nevojat e ShFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, në vlerë afër 39 mijë euro.</p> <p>Pakoja ka përmbajtur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1 shpuese elektrike AKU 18V me dy bateri • 1 fleks elektrik pwr prerje tw materialeve tw ndryshme • 1 makinw pwr largimin e borws me benzinw • 1 makinw profesionale autolarwse me presion • 1 kositwse tw barit me benzin • 1 klimw 18Kw me inverter • 2 fshesa të mëdha industrial për pastrimin e dyshemesë, makinë për larje, kositëse bari, borëpastruese dore, • 3 palë shkallë alumini/metalike, • 8 aparate për zjarrëfikje, • 8 aparate për ndriçim,

	<ul style="list-style-type: none"> • 3 komplete/pako për ndihmë të parë, një arkë çelësash dore, një aparat për dezinfektim, disa mjete konkretizimi për gjeometri dhe mjete tjera pune shtëpiake, shporta bërlloku metalike, ulëse druri për oborr e pajisje e mjete tjera etj.
<p>4.4 Sigurimi i transportit për nxënësit e IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” dhe të tjerë</p>	<p>Edhe këtë vit shkollor 2023-2024 sikurse edhe vitin e kaluar, Drejtoria e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit/bartjen për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimor dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Afër 12 mijë euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin e shpenzimeve e të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, dhe nxënësve të lokaliteteve të fshatit Gilloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijojnë mësimet në Gjimnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të shkollave fillore të cilët udhëtojnë nga fshati Llanishtë në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, Semajë në shkollën e Elezajve dhe Sllatinë e Fushë Pajtimi në shkollën e Doganajve. Ndërkaq, është 700 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas.</p>

DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA

Mbështetur në organizimin dhe strukturimin e Komunave sipas Rregullores 2007/30 – Mbi ndryshimet e rregullores 2000/45, Mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe nenit 84. të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Drejtoria per Buxhet dhe Financa në punën dhe aktivitetin e saj gjatë vitit 2023 në bazë të kompetencave dhe përgjegjesive te sajë **ka zhvilluar aktivitetet si vijon:**

Menaxhimi, mbikëqyrja e të gjitha operimeve financiare së bashku me procedurat e ekzekutimit të buxhetit të komunës në pajtim me LMFPF, LFQL dhe dispozitat e tjera ligjore; asistenca per Kryetarin e Komunës dhe Komitetin për Politikë dhe Financa në përgatitjen e Buxhetit vjetor të komunës, këshillimi dhe komentet mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhet, si dhe kordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë për të gjitha aktivitet, mbajtjen e të gjitha llogarive në komunë, në bashkëpunim me Thesarin dhe përgatitjen e raporteve financiare, për një proces transparent buxhetor, të gjitha këto, me një shkallë të lartë të mbikëqyrjes së të gjitha drejtorive; menaxhimin me pagesat në Thesar, mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit, inkasimin e drejtpërdrejt të hyrave vetjake komunale nga taksa obliguesit, përfshirë edhe tatim në pronë: dhe punë të tjera të caktuara nga kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

1. SEKTORI I FINANCAVE:

1.1. BUXHETI:

CASH PLAN-i

Bazuar në Rregulloren MF - Nr. 02/2017 për alokimin e fondeve, e cila përcakton procesin për alokimin e fondeve sipas LMFPF-së dhe Ligjit vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në fillim të vitit 2023 është përgatitur Kesh Plani komulativ për të gjitha programet, nën-programet e Organizatës Buxhetore – Komuna Kaçanik, është finalizuar sipas ndarjeve buxhetore të Ligjit të Buxhetit dhe planifikimit për zotimin përkatësisht shpenzimin e tyre.

BARTJA E MJETEVE TE PASHPENZUARA NGA VITIT 2022 NE VITIN 2023:

Pergatitja e materialeve per bartje te mjeteve te pashpenzuara nga te hyrat vetanake te vitit 2022 ne vitin 2023 te cilat perafersisht arrijne shumën e teresishme per bartje prej 1,100,000.00 euro. Keto mjete pritet te destinohen kryesisht per Investime Kapitale pra shtohen investimet e vitit 2024 per shumë totale te bartur e cila behet e ditur me rastin e konsolidimit te Pasqyrave Vjetore Financiare te vitit 2023 nga niveli qendrorë.

RAPORTI VJETOR 2023

RAPORTET E SHPENZIMEVE

Sipas afatit të paraparë ligjorë është hartuar Raporti Vjetor Financiar per perfundimin e vitit fiskal 2023 per MFPT. Ky raport eshte derguar nga Drejtoria e Financave para dates 30.01.2024 në Ministrinë e Financave, Punes dhe Transfereve dhe i njëjti ne seancën e muajit shkurt 2024 do te dërgohet per shqyrtim dhe diskutim ne Asamblene Komunale.

Poashtu, përgjatë vitit 2023 janë përgatitur raportet tre mujore financiare per periudhen janar-mars; prill-qershor, korrik shtator dhe tetor-dhjetor 2023, ku këto raporte janë dërguar në Asamblenë Komunale për diskutim dhe shqyrtim të mëtejme.

Për të arritur një transparencë buxhetore, gjitha raportet e hartuara kanë përmbajtur shënime të hollësishme apo analitika për shpenzimet e ndodhura.

SHPENZIMET - ÇERTIFIKIMI DHE APROVIMI I PAGESAVE

Shpenzimi i parasë publike kërkon një kontrollë të mirë të ndjekjes së procedurave dhe ekziston rregullore e veçantë **“RREGULL FINANCIARE NR.01/2013/MF – SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE”** përmes së cilës përveq tjerash sigurohet kontrolli i brendshëm si proces integral që ndikohet nga udhëheqësit dhe personeli i njësisë dhe ka për qëllim për të dhënë bindje të mjaftueshme që duke synuar kah realizimi i misionit të njësisë, janë duke u arritur këto objektiva të përgjithshme:

- a. Ekzekutimi i rregullt, etik, efikas dhe efektiv i operimeve;
- b. Plotësimi i obligimeve të llogaridhënies;
- c. Veprimi në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme;
- d. Mbrojtja e burimeve nga humbja;

Bazuar në këtë rregullore dhe procedurat tjera ligjore, gjatë vitit 2023 janë përfunduar të gjitha punët rreth shpenzimit të buxhetit komunal si në vijim:

- Regjistrimin e gjitha pagesave të shpenzuara sipas programeve buxhetore,
- Raportimi çdo mujor për faturat e papagura për vitin 2023,
- Pregaditje të shkresave të ndryshme për dezotimin e mjeteve, anulimin e shpenzimeve, anulimin e urdhëblerjeve,
- Përgatitja dhe paraqitja e kekrkesave te vazhdueshme ne MF rreth harmonizimve dhe rialokimeve te mjeteve buxhetore, etj.

Gjithësej pagesat e gjithave kategorive të shpenzime të cilat janë çertifikuar dhe aprovuar janë 2,562 pagesa të cilat kapin shume prej 5,000,799.99 euro pa perfshire kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

PUNË TJERA TË DREJTORISË:

Përgatitja dhe publikimi i Thirrjeve Publike per financimin e OJQ-ve te cilat financohen nga Zyra e Kryetarit.

RAPORTI VJETOR 2023

Pergatitja e Vendimeve te ndryshme per lejim te mjeteve financiare nga Kryetari i Komunes per perkrahjen e aktiviteteve te ndryshme.

Pergatitja e kerkesave per alokim te te hyrave vetanake ne periudha te rregullta mujore sipas nenprogrameve dhe kodeve ekonomike te shpenzimeve.

Pergatitja e Raportit te Zbatimit te Rekomandimeve te Auditorit per Pasqyrat Financiare te vitit 2022.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i vazhdueshëm përgjatë tërë vitit me Organizatat e ndryshme e ne veçanti me zyrtarët e projektit HELVETAS-DEMOS, lidhur me aktivitetet e planifikimeve buxhetore si dhe aktivitetet tjera në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm.

Hartimi i Planit te Veprimit per zbatimin e Rekomandimeve nga te gjeturat e Auditorit per Pasqyrat Financiare te vitit 2022.

Pergatitja e Propozim vendimeve ne emer te kryetarit te komunes per Transferin dhe Rialokimin e mjeteve financiare nga kategoritë e ndryshme, me qellim te arritjes se shpenzimit dhe realizimit te buxhetit ne shkallë sa më te lartë deri ne përfundim te vitit.

Plotesimi i Pyetesorit të Vetëvlerësimit dhe komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Janë plotesuar gjithesej 106 pyetjet që përmban ky pyetesor përmes 5 komponenteve financiar.

REGJISTRIMI I TE HYRAVE VETANAKE

Përveç Granteve Qeveritare, Donacioneve të ndryshme dhe burimeve tjera, të Hyrat Vetanake janë burim tejet i rëndësishëm në kontestin e financimit të aktiviteteve të ndryshme komunale.

Pagesat apo pranimet e mjeteve nga qytetarët me rastin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme nga zyrtarët komunal dhe me rastin e pagesave të taksave dhe tatimeve, janë realizuar në dy mënyra:

- a) Pagesat në trezor shuma, e secilës pagesë që ka vlerë nën 10 (dhjetë) euro dhe
- b) Pagesat në llogarinë bankare, shuma e së ciles pagesë që ka vlerë mbi 10 (dhjetë) euro.

Gjatë vitit 2023 nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave, me azhuritë është bërë pranimi dhe barazimi i mjeteve nga trezori i Shck-së, Participimet në Shëndetësi (QKMF), të hyrat nga zyret e vendit, të hyrat nga antarësia në bibliotekë dhe barazimet me arkëtarët e këtyre trezorëve.

Për çdo ditë janë siguruar raporte ditore nga Sistemi i Free-Balanc-it mbi pagesat e të Hyrave vetanake të paguara përmes llogarive bankare, është bërë klasifikimi i të Hyrave për secilën Drejtori veç e veç a mbi pagesat e pranuar nga palë të ndryshme, etj.

Në periudha tremujore është bërë barazimi i rregullt mes zyrtarit të regjistrimit të të hyrave vetanake dhe departamenteve tjera që kanë inkasuar mjete.

RAPORTI VJETOR 2023

PERGATITJA E BUXHETIT 2024 – 2026

Për çdo vit me fillim të muajit maj të vitit aktual fillojnë punimet rreth hartimit të Buxhetit komunal për vitet vijuese. Fillimisht pas hartimit të Kornizës Qeveritare Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2024 - 2026 të Ministrisë së Financave dhe sipas udhëzimeve të lëshuara nga Ministria është filluar me fazën e parë të përgatitjes së buxhetit komunal per vitin 2024 dhe vlerësimeve për vitet 2025 – 2026.

Hapat rreth procesit buxhetor të cilat janë ndjekur gjatë vitit 2023 për përgatitjen e Buxhetit 2024 dhe vlerësimeve për periudhën afatmesme 2025 -2026 kanë qenë:

Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2024-2026, ku fillimisht janë zhvilluar degjime apo diskutime te brendshme mes Kryetarit dhe ekzekutivit komunal, pastaj janë caktuar dhe zhvilluar Degjime Publike me qytetarët e komunes per Kornizën Afatmesme Buxhetore. Pas finalizimit të KAB-it komunal eshte shqyrtuar ne mbledhjen e KPF-es pas Aprovimit nga Asambleja komunale ne seancën e zhvilluar, pastaj ky dokument tejet strategjik komunal eshte dërguar ne Ministrine e Financave Punes dhe Transfereve.

Pas kësaj faze janë zhvilluar edhe disa takime me qytetarë dhe grupe tjera te interesit, me pas para datës 30 shtator 2023 eshte shqyrtuar dhe miratuar me shumicë votash Buxheti per vitin 2024 dhe vlerësimet per vitet 2025 – 2026.

2. SEKTORI I TATIMIT TË PRONËS:

ZYRA E TATIMIT NË PRONË

Pos punëve të përditshme Zyra e Tatimit ne prone ne baze të ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë, përkatësisht neni 12 pika 2.7 thot se Komuna mbledh dhe përdor masat e mbledhjes së detyrueshme të detyrimeve të tatimit në pronë,që nga fillimi i vitit 2023 jemi marrur me procedurat permbarimore per tatimpagues borgjli të përzgjedhur dhe kemi fillu me përmbarrim për obligimet tatimore të pashlyera për procedurë të mëtejme.

Nga gjysma e muajit shkurt kemi fillu me pranuar ankesa për tatim në pronë ku deri më dt.31.05.2023 kemi pranuar gjitha ankesat, të cilat janë shqyrtuar. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar brenda afatit të paraparë ligjor.

Gjate vitit Zyra e Tatimit ne Pronë ka funksionuar me perkushtim te lartë nga stafi, ku ne vazhdimesi jane ofruar informata te ndryshme per tatimpaguesit dhe jane inkasuar mjetet ne lartesi prej 443,998.13 euro.

RAPORTI VJETOR 2023

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

Hyrje

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim të raportimin për kryetarin e komunës si dhe informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Është raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punët e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit.

• PROJEKTE KAPITALE

Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike në kuadër të përgjegjësisë dhe aktiviteteve të saja edhe gjatë vitit 2023 është përkushtuar në realizimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale brenda listës së projektve buxhetit për investime kapitale për vitin 2023, i miratuar nga kuvendi komunal dhe projekteve kapitale të përfituara në bashkëfinancim me ministrinë e ndryshme. Në bashkëpunim me zyrën e kryetarit dhe të drejtorive tjera është angazhuar për implementimin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës rrugore të cilat janë parqitur si vijon:

➤ Ndërtim të objekteve të infrastrukturës publike

Gjatë vitit 2023 është vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi i Objektit për Zjarrëfiksa”-faza e II-të si dhe është realizuar projekti “Vendosja e tabelës dixhitale me mbishkrimin “Mirësevini në Kaçanik”te Kalaja e Qytetit.

Poashtu nga lista e investimeve kapitale bashkëfinancim Ministria e Infrastrukturës realizuar projekti “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës”Idriz Seferi”-faza e I-rë”. Projekti do të realizohet në periudhën 2 vjeçare 2023-2024.

Nr.	Emërtimi	Nr.
1	Ndërtimi i objektit të Zjarrëfiksave-faza e II-të	1 objekt
2	Vendosja e tabelave dixhitale me mbishkrimin “Mirësevini në Kaçanik”	2 monitorë
3	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës”Idriz Seferi”-faza e I-rë L=600m	1 projekt
	Total	3 projekte

• **UJËSJELLËSI**

Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit”- është realizuar në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshenuar.

Nr.	Emërtimi
1	Rrjeti i ujësjellësit në Bajnicë (stacioni i pompimit dhe rrjet ujësjellesi L=670m)
2	Rrjeti i ujësjellësit në Ivajë-faza II-të (rrjeti primar L=6020m)
3	Rrjeti i ujësjellësit në rr - "Reshat Shehu" dhe “Selim Shehu”- Kaçanik L=585m
4	Shpimi i pusit të ri me rotacion në thellësi 120m - K. Vjetër (afër Ballkan Petroll-it)

➤ **Furnizim me gypa të ujësjellësit për bashkëfinancim në realizim të projekteve të rrjeteve të ujësjellësit**

Gjatë vitit 2023 është mundësuar furnizimi me gypa të ujësjellësit komuniteteve që kanë shprehur gatishmëri për bashkëfinancim në realizim të projekteve në rehabilitim të rrjeteve ekzistuese në lokalitetin e tyre. Janë furnizuar komunitetet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m
1.	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63, për ujësjellësin në fshatin Gajre	100m
2.	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 50, për ujësjellësin në rr.”Isen Gashi”-fshatin Begracë	250m
	Totali	350m

• **KANALIZIMET FEKALE DHE ATMOSFERIKE**

Kemi vazhduar me realizimin e projektit “Ndërtim i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Begracë”- projekti është kontraktuar për periudhën kohore 2 vjeçare 2022-2023.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia	Gjatësi e punuar në 2023
1	Ndërtim i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Begracë	17km	8536m
	Totali		8536m

RAPORTI VJETOR 2023

➤ **Rrjete të kanalizimeve fekale dhe atmosferike**

Në kuadër të kodit buxhetor "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" kontratë 2 vjeçare. Në vitin 2023 janë realizuar këto projekte:

Nr.	Emërtimi	Profili i gypit	Gjatësia
Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale			
1	Kanalizimi fekal në rr."Ismajl Raka"prapa Shtëpisë së Kulturës	61m	Ø315
2	Kanalizimi fekal në lagjen Koraqi dhe Muqa- Kovaqec	265m	Ø250
3	Kanalizimi fekal në Dubrave-lagjja Vishaj-Kamishi /rreth Përroit	1400m	Ø315
4	Ndërtimi i dy segmenteve të kanalizimit fekal në lagjen Vishaj	95	Ø 250
5	Rregullim i kanalizimit fekal afër xhamisë në Stagovë	66m	Ø315
6	Kanalizimi fekal ne lagjen Zeneli-Bob	145m	Ø250
7	Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit fekal te lagjja Beljan-magjistrale	84m	Ø315
8	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rr."Çlirimtarët"-Kaçanik i Vjetër	436m	Ø 250
9	Ndërtim i kanalizimit fekal në Doganaj- vazhdimin e rrjetit ekzistues	100m	Ø 250
10	Ndërtim i një segmenti të kanalizimit fekal ne Dushkaje rr."Emsale Frangu"	150m	Ø 250
11	Ndërtim te rrjetit të kanalizimit fekal në Lagje te Re-Kaçanik,	132m	Ø 250
12	Ndërtim i rrjetit të kanalizimit fekal në rr."Cen Loku"-Kaçanik i Vjetër	434m	Ø 250
13	Ndërtim i një rrjeti të kanalizimit fekal në Nikaj	250m	Ø 250
14	Ndërtim i kanalizimit fekal në lagjen Hysa-Stagovë	110m	Ø 250
15	Ndërtim i kanalizimit fekal në lagjen Imishti-Dubravë	312m	Ø 250
16	Ndërtim i kanalizimit fekal në fshatin Duraj	390m	Ø 250
	Totali	4430m	
Ndërtim i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike			

1	Kanalizimi atmosferik në rrugën “Baki Dullovi -Biqec	188m	Ø500
2	Rregullim i kanalizimit atmosferik- Stagove (devijimet per shkak te ndertimit te Hekurudhes)	120m	Ø500
3	Ndërtimi i dy segmenteve të kanalizimit atmosferik në rr.”Hetem Hasaj”- Gabrricë dhe “Avdyl Dura”-Duraj.	48m 48m	Ø500 Ø315
4	Ndërtimi i një segmenti të kanalizimit atmosferik- Xhamia e Sanitex-it,	35m 15m	Ø600 B. Ø400 B.
	Totali	454m	

Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese të kanalizimeve fekale dhe atmosferike	
1	Intervenim në rr.Raif Krivanjeva në sanim të defektit në rrjet të kanalizimit fekal
2	Intervenim te shkolla fillore “Emin Duraku”-Dushkajë në sanim të kanalizimit atmosferik
3	Intervenim në Begracë në sanim te defektit në rrjet të kanalizimit fekal
4	Intervenim në rregullimin e rezervës së ujit në Sepetin nga prurjet e ujit nga kaptazha në Rekë të Dubravës,
5	Intervenim në Biqec në zbllokim të kanalizimit fekal
6	Sanimin e një segmenti të kanalizimit fekal në fshatin Nikaj
7	Intervenim në sanimin e kanalizimit fekal në Stagovë
8	Intervenim në sanimin e bllokimit të rrjetit të kanalizimit në lagjen Murseli-Doganaj-është bërë ndërrimi e gypave në distance 30m shkak i bllokimit dhe dëmtimit të tyre,
9	Intervenim në sanimin disa defekte nga rrjedhjet në rrjete të kanalizimeve fekale në segmentin Duraj-Gabrricë-Rakaj,
10	Rregullim të pusetës në rr.”Ismaj Raka”-prapa Shtëpisë së Kulturës, Zhbllokim të pusetës në rr.”Sulejman Kuka”-Dushkajë dhe në Zhbllokimin e rrjetit të kanalizimit fekal në segmentin Koxhaj-Rakaj,
11	Rehabilitimi rrjetit të kanalizimit fekal dhe vendosja e kapakëve metalik në pusetat ekzistues në rrugën “Idriz Seferi”-ka Teqja

• HAPËSIRAT PUBLIKE

Këtë vit kemi realizuar 3 (tri) projekte në fushën e rregullimit të hapësirave publike. Kemi vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-të”, projekt që po realizohet për periudhën 2 vjeçare 2022-2023.

Poashtu është implementuar faza e II-të e projektit “Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime”. Është punuar në rehabilitimin e shetitores nr.4 dhe ridizajnimit të hapësirës së fontanës afer Urës së Konakut.

Në kuadër të projektit “**Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike**” është bërë ridizajnimi dhe rregullimi i hapësirës publike të bustit të heroit të kombit Ismajl Raka si dhe mbjellja e luleve shumëvjeçare dhe drunjëve dekorativ.

Nr.	Emërtimi	Projekte
1	Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime-faza II-të	1
2	Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-rë	1
3	Rregullimi i hapësirës publike të bustit të Heroit të kombit Ismajl Raka	1
	Totali	3 projekte

• **PARKINGJE**

Gjatë vitit 2023 kujdes i veçant i është kushtuar krijimit të hapësirave të reja për parkingje publike. Janë ekzekutuar projekte të kësaj fushe në keto lokacione:

Nr.	Emërtimi	Nr. i parkingjeve
1	Shenjëzimi i vendparkingjeve te hapësira publik përballë Palestrës së Sportit	58
2	Shenjëzimi i vendparkingjeve në rr.”Qamil Ilazi”-Kaçanik	13
3	Shenjëzimi i vendparkingjeve në oborrin e QKMF-së	21
4	Shenjëzimi i vendparkingjeve në oborrin e Gjykatës Themelore-Kaçanik	11
5	Shenjëzimi i vendparkingjeve përballë PTK-së -Kaçanik	5
	Totali	108

• **NDRIÇIMI PUBLIK**

Projekti kapital “**Rregullimi i ndriçimit publik**”-shuma e projektit= **48,977.82€** është në këto lokacione:

Nr.	Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes	Gjatësia (m)	Nr.trupave
1	Rruga."Hetem Hasaj"-Gabrricë	707m	18 cope
2	Rruga "Liria"-Gërlicë e Epërme	804m	18cope
3	Rruga ”Beteja e 25 majit”-segmentin Provoli-Tushaj-Ura e fsh. Dubravë	1360m	34cope
4	Rruga "Abit Dullovi " dhe nje pjese e rruges "Fadil Bunjaku" - Biçec	500m+180m	24cope
5	Rruga "Xhevdet Guri " Nikaj	320m	7 cope

RAPORTI VJETOR 2023

6	Rregullimi i ndriçimit publik përballë Gjykatës-rr."Ismajl Raka"-Kaçanik	50m	3cope
7	Rruga"Pishtarët e Lirisë"-Elezaj	550m	15 cope
8	Rruga "TMK"-Runjevë	1100m	30cope
9	Rruga "Hebib Gerlica"-Prushaj	270m	9cope
	Total	5,134m	158cope

- Si pjesë e projektit "Asfaltim i rrugës Idriz Seferi" është duke u punuar edhe rrjeti i ndriçimit publik.
- Poashtu edhe në kuadër të projekteve "Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime" dhe "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike" janë vendosur trupa të rinj ndriçues.

Edhe gjatë këtij mandati, kemi dhënë pëlqime për rregullimin dhe shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në lagjen dhe fshatrat ku komuniteti është shprehur i gatshëm të vetëfinancojë projektin. **Kemi dhënë pëlqime për rregullim të ndriçimit publik në:**

- Rruga "Ili Lakrori"-lagja Luzha –Begracë

• MENAXHIMI I MBETURINAVE

- Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027-**I aprovuar**
- Hartimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave- **Në proces**
- Me kompaninë private NT"Krasniqi" është lidhur Marrëveshje për periudhën njëvjeçare për operim në lokalitetet Begracë, K. Vjetër dhe Koxhaj.
- KRM "Pastërtia"- njësia operative në Kaçanik ka zgjëruar operimin me mbulueshmëri të grumbullimit të mbeturinave edhe në lokalitetet Doganaj, lagja Dedaj dhe Lushi dhe Shorra-Elezaj dhe janë futur në shërbim ekonomi familjare të reja në zonat e operimit
- Janë shpërndarë rreth 167 komposter në ekonomi familjare dhe objekte shkollore të siguruar nga GIZ-i, pjesë e shpërbllimit të Grandit të Performancës-Mjedisi i Pastër.
- Sipas kërkesës nga MAPL-ja kemi ridërguar specifikat për ritenderimin e blerjes së kamionetës me mjetet e mbetura të Grandit të Performancës-Mjedisi i Pastër në shumën 109,369.00€.
- Mbulueshmëria më shërbim në komunën e Kaçanikut është mbi **96%**.

• **KOMUNIKACIONI RRUGOR**

Gjatë vitit 2023 kujdes i veçant i është kushtuar sigurisë dhe krijimit të mundësive më të mira për pjesëmarrësit në trafik në rrugët lokale të komunës sonë, ku përmes kontratës "Rregullimi dhe mirëmbajtje e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" jemi përkujdesur në:

- Shenjëzim i vijave horizontale në rrugë dhe vendparkingje
- Vendosje dhe mirëmbajtje e shenjëzimit vertikal

RAPORTI VJETOR 2023

- Vendosije e shenjave njoftuese per vendbanime dhe institucione
- Punim të shiritave vibrues, etj

Me kontratën ”Rregullimi dhe mirëmbajtje e sinjalizimit horizontal dhe vertikal” në vitin 2023 janë realizuar punime në këto lokacione:

- Sinjalizimi horizontal në rrugën “Agim Bajrami”, në Kaçanik
- Sinjalizimi horizontal në rrugën “Vëllezërit Çaka”, në Kaçanik
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në rrugën “Qamil Ilazi”, në Kaçanik
- Sinjalizimi horizontal në rrugën “Sali Bajra”, në Kaçanik
- Sinjalizimi horizontal në rrugën “Ismail Raka”, në Kaçanik
- Vendosija e dy retrovizorëve (pasqyreve) në rrugën “Ilirët” në fsh. Dubrave dhe “Agim Bajrami” në Kaçanik
- Sinjalizimi horizontal i parkingjeve te palestra sportive
- Sinjalizimi horizontal i parkingjeve në oborrin e QKMF-së
- Sinjalizimi horizontal i parkingjeve në oborrin e Gjykatës
- Sinjalizimi horizontal i parkingjeve para PTK-së
- Sinjalizimi horizontal i parkingjeve në stacionin e autobusëve
- Vendosija e shiritave vibrues në rrugën “Agim Bajrami”
- Vendosija e shiritave vibrues në rrugën kryesore të fsh. Nikaj
- Vendosija e shiritave vibrues në rrugën kryesore të fsh. Biçec
- Vendosija e vendkalimeve për këmbësor në rrugën “Sali Bajra”, duke përfshirë edhe sinjalizimin vertikal
-
- Vendosija e vendkalimeve për këmbësor në rrugën “Qamil Ilazi”, duke përfshirë edhe sinjalizimin vertikal
- Vendosija e dy retrovizorëve (pasqyreve) në fsh. Dubravë
- Vendosija e dy shenjave lajmëruese në hyrjen e fsh. Stagovë, në lidhje me stadiumin e qytetit
- Vendosija e tri shenjave të emërimit të vendbanimeve në hyrjen e fsh. Gajre
- Vendosija e dy shenjave “Ndalim Parkingu” në rrugën te Sheshi i Qytetit
- Vendosija e dy shenjave “Parking me Pagesë” në rrugën “Qamil Ilazi”
- Vendosija e dy shenja “Parking për automjete zyrtare”, një tek parkingu te palestra e qytetit dhe tjetra në rrugën “Agim Bajrami”- para objekti të Komunës
- Riparimi i katër shenjave të komunikacionit në rrugën “Ismail Raka” dhe “Qamil Ilazi”
- Vendosija e shenjës “Ndalohet hudhja e mbeturinave” në rrugën “Mani” të fsh. Stagovë

➤ Transportit publik i udhëtarëve

Transporti publik i udhëtarëve në komunën tonë ka funksionuar mirë. Jemi fokusuar në zbatimin e Rregullores komunale për Transportin Publik. Janë paisur me leje pune dhe janë vërtetuar rendet e udhëtimit për linjat urbano-periferike të gjithë operatorët që operojnë me autobus, kombi-bus dhe auto taksi. Aktualisht funksionon transporti publik i udhëtarëve në të gjitha vijat të cilat janë shpallur nga DSHPE-ja (pos në relacionin Kaçanik –Kotlinë dhe Kaçanik-Kovaçec, ku nuk kemi operator të interesuar).

RAPORTI VJETOR 2023

• **PROJEKTE TJERA**

Nr.	Emërtimi i projektit	
1	Krasitja e drunjëve dekorativ në bulevard, hyrje e qytetit dhe Varrezat e Dëshmorëve	1 projekt
2	Trajtimi i qenëve endacak-kontratë aktive (2023)	1 projekt
3	Rehabilitimi i rrugës "Avdulla Baftiu"-lagjja Zharku-Biqec	1 projekt
4	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	1 projekt
	Total	4 projekte

• **MIRËMBAJTJE INVESTIVE**

➤ **Mirëmbajtja e ndriçimit publik-2023**

Gjatë këtij viti shkaku i mungesës së kontratës aktive për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, jemi angazhuar në lidhjen e dy kontratave emergjente për mirëmbajtjen e rrjeteve të ndriçimit aktual ku është intervenuar në rrjete të ndryshme ekzistuese të ndriçimit publik në sanim të defekteve dhe ndërrim të trupave ndriçues.

NR	EMËRTIMI	Vlera
1	Rregullimi i ndriçimit në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik	6,592.30€
2	Mirëmbajtja dhe rregullimi i ndriçimit në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik në komunën e Kaçanikut	6,383.00€

➤ **Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara-KRM "Pastërtia"-Kaçanik**

Kemi realizuar aktivitete në vlerë **22,462.82€** për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara

- Pastrimi i shetitoreve në bulevardin "Ismajl Raka"-Kaçanik
- Kositje e barit dhe mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëruara të Varrezat e Dëshmorëve dhe pllakat përkujtimore
- Krasitje dhe mirëmbajtje drunjëve dekorativ,
- Largim të deponive të vogla ilegale

➤ **Ekzaminimi i elementeve ndërtimore**

Është vazhduar me implementim të kontratës "Ekzaminimi i elementeve ndërtimore" për periudhën 3 vjeçare (2022-2024). Në këtë vit kemi realizuar aktivitete të kësaj fushe në shumën **4,550.00€** për shërbimet e ekzaminimit të materialeve ndërtimore si:

- Marrje e mostrave të betonit, kubzave, skajoreve dhe asfaltit
- Matje e ngjeshmërisë së traseve të trotuareve dhe rrugëve

➤ **Trajtimi i qenëve endacak**

Kemi vazhduar me implementim të kontratës “**Trajtimi i qenëve endacak**”. Këtë vit kemi zhvilluar aktivitete të kësaj kontrate në shumë **7,869.00€** për trajtim të qenëve endacak në territorin e komunes sonë ku janë trajtuar nga operatori ekonomik i licencuar qenët pa pronarë (kastim, sterilizim dhe eliminim të qenëve të sëmurë). Janë trajtuar 183 qenë endacak të cilët janë evidentuar në vendbanime të ndryshme të komunës.

➤ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe veteravëve të UÇK-së**

Gjatë vitit 2023 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaqërisht para çdo date të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjët dekorativ (kositje e barit, ujitje dhe pastrim të hapësirave publike). Gjithashtu në çdo datë të përvjetorëve janë pastruar edhe pllakatat përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të ngritura në lokacione të ndryshme të komunës sonë.

➤ **Rregullim dhe pastrim i shtretërve të përrockave dhe lumenjëve**

Krahas rregullimit të shtretërve të lumenjëve dhe përrockave dhe këtë vit është vazhduar me traditën e pastrimit të shtretërve ekzistues të tyre nga prurjet e ndryshme dhe shkurret.

NR	EMËRTIMI	Gjatësia
1	Pastrimi i shtratit të lumit Nerodime-Kaçanik	960m
2	Rregullim i shtratit të përrockës në Bajnicë	60m

➤ **Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2023**

Gjatë vitit 2023, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinore gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujrave atmosferike, ndërtim i mureve mbrojtëse, largimi i borës, hudhja e kripës industriale, etj), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavori dhe shtresë të re asfalti.

Punët e realizuara me projektin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale” 2023

- Rehabilitimi i rrugës “Dardania”, në fshatin Bajnicë pas shembjes së një pjese të saj
- Demolimi i pengesave nga asfalti në rrugën “Hetem Hasaj”
- Vendosja e lëshesës atmosferike nga gypat e betonit Ø1000 mm, afër rrugës “Toska”, të fshatit Begracë
- Hapja dhe mbyllja e kanalit para objektit të zjarrëfikësve, për rregullimin e problemit të nxemjeve
- Punimi i kanalizimit atmosferik në rrugën “Avdyl Dura”, në fshatin Duraj
- Zgjerimi me zhavor i rrugës “Beteja e 25 majit”, në lagjen Provoliu
- Mbushja e bankinës me zhavor në rrugën “Brigada 162 Agim Bajrami”, në fshatin Gajre

RAPORTI VJETOR 2023

- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugën “Beteja e 25 majit”, të fshatit Vataj-Dubravë
- Rehabilitimi me kubëza betoni dhe ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën “Mahi Loku”, në Kaçanik
- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugën “28 nëntori”, të lagjes “Memaj”, në fshatin Vataj-Dubravë
- Shtrimi me zhavor i rrugës tek objekti “Kulla e fshatit Nikaj”
- Pastrimi i rrugës “Brigada 162 Agim Bajrami”, nga prurjet e të reshurave me datë 18.12.2022 dhe 24.01.2023
- Rehabilitimi me zhavor i rrugës kryesore të fshatit Llanishtë, me datë 26.01.2023
- Rehabilitimi me zhavor i rrugëve “Hajdin Bela” dhe “Ramadan Bela” në fsh. Gjurgjedell
- Hedhja e kripës&rërës nëpër rrugët urbane dhe rurale të Komunës së Kaçanikut prej datës 11.01.2023 deri 09.02.2023
- Pastrimi i rrugëve rurale dhe urbane të Komunës së Kaçanikut prej datës 11.01.2023 deri 09.02.2023
- Rehabilitimi i rrugës “Elham Hasani”, në fshatin Semajë, pas shembjes së një pjese të saj me datë 04.04.2023
- Shtrimi me zhavor i krahut të rrugës “Ahmet Kaçiku”, në fshatin Duraj, me gjatësi L=90.00 m’
- Shtrimi me zhavor i krahut të rrugës “Mynyr Thaqi”, në fshatin Kovaçec, me gjatësi L=150.00 m’
- Rehabilitimi i kalldremit përreth xhamisë së qytetit prej datës 23.03.2023 deri 21.03.2023
- Pastrimi i rrugës “Shaban Elezi”, nga shembjet e dheut me datë 04.04.2023
- Pastrimi i rrugës “Burim Rexha”, nga shembjet e dheut me datë 04.04.2023
- Ndërtimi i murit mbrojtës nga gurët në oborrin e sh.f. në fshatin Kotlinë
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i vazhdimit të rrugës “Pishtarët e lirisë”, në fshatin Elezaj, me gjatësi L=587.00 m’
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i degëzimit të rrugës “Nazmi Osmani”, në fshatin Elezaj, me gjatësi L=125.00 m’
- Rehabilitimi i rrugës “Elham Hasani”, në fshatin Semajë, pas shembjes së një pjese të saj me datë 16.05.2023 dhe 17.05.2023
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i krahut të rrugës “Ahmet Kaçiku”, rruga për tek varrezat e lagjes “Selmani” në fshatin Doganaj, me gjatësi L=509.00 m’
- Vendosja e lëshesave atmosferike në rrugën “Pishtarët e Lirisë”
- Rehabilitimi me zhavor i rrugës kryesore të fshatit Drenogllavë me datë 12.05.2023
- Betonimi i themeleve të shyllave elektrike në rrugën “Idriz Seferi” në Kaçanik
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Ismail Raka”, në Kaçanik
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Remzi Zharku”, në lagjen e Dushkajës
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, në lagjen e Dushkajës
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Shaban Topalli”, në fsh. Soponicë
- Rehabilitimi me zhavor i rrugës “Avdulla Bafiu”- rruga për te pllaka përkujtimore, në fsh. Vataj-Dubravë, me gjatësi L=179.00 m’
- Rehabilitimi me zhavor i rrugës “Shaqir Kuka”- rruga për te pllaka përkujtimore, në fsh. Bob, me gjatësi L=78.00 m’
- Hapja dhe shtrimi i rrugës me zhavor në lagjen e Dushkajës, në rrugët publike me numër të parcelave 124-13 dhe 124-10 ZK Kaçanik, me gjatësi totale L=267.00 m’

- Pastrimi i rrugës “Burim Rexha”, nga shembjet e dheut me datë 20.06.2023
- Rregullimi i rigollës monolite në rrugën “Brigada 162 Agim Bajrami”, me gjatësi L=82.50 m’
- Rehabilitimi i gropave me asfalt, në rrugën “Brigada 162 Agim Bajrami”, në fsh. Gajre – Ivajë – Strazhë

RAPORTI VJETOR 2023

- Pastrimi nga vegjetacioni i rrugëve: “Vëllezërit Çaka”, “Izahir Troni” dhe “Sadik Guri”, në fsh. Bob – Kovaçec – Biçec – Nikaj, me gjatësi totale prej L=4.80 km
- Pastrimi nga vegjetacioni i rrugës “Hamzë Jashari”, në Kaçanik, me gjatësi L=1.85 km
- Pastrimi nga vegjetacioni i rrugës “Remzi Zharku”, në lagjen e Dushkajës, me gjatësi L=430.00 m
- Pastrimi i trotuarit të rrugës “Remzi Zharku”, në lagjen e Dushkajës, me gjatësi L=430.00 m
- Montimi i dy kapakëve nga materialit i gizës së derdhur në rrugën “Ilir Zharku”, në fsh. Bob
- Larja me autobot e rrugëve: “Agim Bajrami” dhe “Ismail Raka”, në Kaçanik, me datë 23.07.2023
- Shtrimi me zhavorr i rrugës “Jashar Vogliqi” në fsh. Gërlicë e Epërme
- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugën “Komandant Bardhi” në fsh. Begracë
- Ngritja e një pusete në rrugën “Ismail Raka”
- Nivelizimi i rrugës “Shkëlzen Haradinaj” në fsh. Stagovë me datë 04.09.2023
- Pastrimi i rrugës “Brigada 162 Agim Bajrami” në fsh. Gajre, nga shembjet e dheut me datë 30.07.2023
- Pastrimi i rrugës kryesore të fsh. Kotlinë, nga shembjet e dheut me datë 31.08.2023
- Pastrimi i rrugës “Rizvan Bela” në fsh. Gjurgjedell, nga shembjet e dheut me datë 05.10.2023
- Shtrimi me zhavor para dhe prapa murit mbrojtës në rrugën “Daut dhe Adem Rakoci” në Kaçanik tek qerdhja e qytetit
- Zgjerimi me zhavorr i një pjese të rrugës kryesore të fshatit Begracë, me gjatësi L=50 m
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Komandant Bardhi” në fsh. Kaçanik të Vjetër, duke përfshirë paraprakisht pastrimin nga vegjetacioni
- Rehabilitimi i trotuarit në rrugën “Epopeja e UÇK-së” në fsh. Kaçanik të Vjetër
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavorr i rrugës që lidhë fshatin Ivajë me fshatin Kotlinë me gjatësi L=2115 m’
- Asfaltimi i rrugës që lidhë rrugët “Ismail Raka” dhe “Sali Bajra” në Kaçanik, me gjatësi L=51.00 m’
- Asfaltimi i krahut të rrugës “Nazmi Osmani” në fsh. Elezaj, me gjatësi L=44.00 m’
- Hedhja e kripës nëpër rrugët e Komunës së Kaçanikut, me datë 25.11.2023 dhe me datë 26.11.2023
- Rehabilitimi me kubëza betoni i kthesës së rrugës “Brigada 162 Agim Bajrami” në fsh. Gajre
- Hedhja e kripës & rrërës nëpër rrugët e Komunës së Kaçanikut, më datë 17.12.2023, 18.12.2023 dhe me datë 19.12.2023
- Pastrimi nga bora nëpër rrugët e Komunës së Kaçanikut më datë 26.11.2023, 16.12.2023, 17.12.2023 dhe me datë 18.12.2023
- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugën “Besnik Begunca” në Lagjen e Re
- Rehabilitimi i gropave me asfalt në rrugën “Avdurrahim Shehu” në Kaçanik
- Rehabilitimi i gropave me shtresë asfalti në rr.”Hamzë Jashari”-Kaçanik

Sektori i emergjencave

Viti 2023 ka filluar me dëme të shkaktuara nga erërat e forta që ndodhën në orët e hershme të datës 18.01.2023 në fshatin Dubravë, duke dëmtuar kulmin e shkollës fillore “Kadri Zeka” dhe paralelen e ndarë të po kësaj shkollë në Vatë. Po ashtu dëme janë shkaktuar edhe në shkollën fillore “Emin Duraku” paralelja e ndarë të Kisi- Dushkajë.

Sipas Komisionit të vlerësimit, dëmet e përlllogaritura janë **3,265.20€**

Me dt. 15.03.2023 me Vendim të Kryetarit të Komunës është formuar grupi punues për rishikimin e dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.

RAPORTI VJETOR 2023

Mund të themi se grupi punues është në përfundim e sipër të hartimit të dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut i cili është dokument bazë për hartimin e planeve tjera emergjente.

Me dt.22.03.2023 Në Kriva Rekë në pronën e z. Bajram Berisha, nga reshjet e shiut si pasojë e daljes së përroit nga shtrati është dëmtuar rruga dhe është bartur një sasi e zhavorrit të deponuar. Sanimi i dëmeve është bërë nga **vetë pronari i kompanisë gurëthyese “Fontana “ Sh.P.K.**

Me dt.04.04.2023 në fshatin Semajë nga qarja e asfaltit është bllokuar rruga (është intervenuar po atë ditë nga kompania e mirëmbajtjes së rrugëve).

Me dt.04.04.2023 në fshatin Sllatinë dhe në rrugën Burim Rexha në Kaçanik është bërë largimi i dheut nga rruga.

Me datë 11.04.2023 në orën 24:30 nga Policia e Kosovës jam informuar se në rrugën “Mejdi Dalloshi” nga rrëshqitja e dheut është rrezikuar shtëpia e pronarit Fehmi Bela. Në vendngjarje ishte patrulla e Policisë dhe emergjencat Komunale. Për shkak të rrezikut të paraqitur, në koordinim me Policinë, familja prej 8 anëtarësh është evakuuar, akomoduar dhe furnizuar me artikuj ushqimor për një kohë të caktuar.

Me datë 11.04.2023 për shkak të rrëshqitjes së tokës nga reshjet e pandërprera të shiut dhe kërkesës së banorëve të fshatit Kovaçec saktësisht, lagja Kupinë, Tron, dhe Mezraj, është kërkuar intervenim për sanimin e gjendjes së krijuar. Pronarët e tokës theksuan se kjo qarje ka filluar pas punimeve të kompanisë Bechtel - Enka për trajtimin e ujërave atmosferik të autostradës “Arbër Xhaferi” në një kanal të përbashkët dhe derdhja e tyre në pronat e lartcekura.

Me dt. 24.05.2023 rreth orës 08:55 nga Policia e Kosovës dhe NJPZSH jemi njoftuar se në objektin P+5 përkatësisht në katin e V-të në rrugën “Idriz Seferi” ndodhet një qen agresiv (endacak) që ka bllokuar familjen e Leutrim Zariqit dhe ka paraqitur rrezik për banorët tjerë të këtij objekti. Pas pranimit të informatës kam kontaktuar kompaninë e kontraktuar për trajtimin e qenëve endacak të cilët në kohë emergjente janë paraqitur në vendin e ngjarjes dhe në ora 09:55 kanë filluar dhe përfunduar neutralizimin dhe largimin e qenit agresiv(endacak).

Po ashtu në bazë të raportit të policisë me nr.07-104/02-11630/23 të **dt.17.05.2023** mbi kafshimin e Valon Demës nga qeni me pronarë të pa identifikuar me **dt.24.05.2023** në ora 10:40 është kontaktuar e ëma e Valon Demës, Remzije Dema e cila ka konstatuar se qeni që e ka kafshuar Valonin është larguar nga vetë familjarët.

Me dt.01. 06. 2023 Është bërë kërkesë për ndihmë profesionale Agjencionit të Menaxhimit të Emergjencave për organizimin e punëtorisë - Vlerësimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Kaçanikut. (deri më tani, 04.01.2024 nuk kemi përgjigje).

Me dt.10.07.2023 përmes mjeteve elektronike dhe faqes zyrtare të Komunës është bërë **NJOFTIM** për qytetarët e Komunës së Kaçanikut për shkak të temperaturave të larta dhe rrezikut të ndezjes dhe përhapjes së zjarreve.

RAPORTI VJETOR 2023

Me dt. 23.07.2023 Sipas raportit të vlerësimit të komisionit komunal për dëmet e shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, (nga të reshurat e breshërit) janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në fushën e bujqësisë (plantacion me pemë mollë dhe mjedër) në fshatin Biçec.

Edhe këtë vit ka vazhduar trajtimi i qenve endacak nga kompania G.O. N.SH. "Ambulanca Veterinare Goni" Ferizaj. Gjatë këtij vitit (2023) deri në përfundim të kontratës dt.21.09.2023 janë trajtuar 183 qenë endacak.

Me dt. 26.09.2023 është bërë furnizimi me pajisje për mbrojtje nga zjarri në:

- Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës (Njësia Profesionale e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit -NJPZSH)
- Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (Palestra Sportive, Shtëpia e Kulturës)
- Drejtoria e Administratës (Korridori, bodrumi dhe arkiva)

Me datën 27 dhe 28 shtator 2023 në Prishtinë kam marrë pjesë në punëtorinë tre palësh Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Konsorciumi IPA FF – "**Bashkëpunimi ndërkufitar për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet**". Punëtorja u vizitua nga ekspertët e programit IPA FF dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe lokale te tri Komunave Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit , pjesët e rrezikshme për vërshime të lumit Lepenc.

Punëtorja ishte e rëndësishme se veçante nga se ka të bëjë, me vërshimet për Pellgun e lumit Lepenc, dhe bashkëpunimin ndërkufitarë me Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku i njëjti burim rreziku kërcënon me përmbytje dy shtetet, andaj bashkëpunimi nga planifikimi dhe parandalimi trajtohet nga programi IPA FF.

Me datën 9 dhe 10 tetor 2023 kam marrë pjesë në trajnimin për "**Reduktim të rrezikut nga zjarret e egra dhe menaxhimin e zjarreve pyjore në malet e Sharrit dhe zonën e masivit të Korabit**", ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Trajnimi dy ditorë u organizua nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Mavrovë të Maqedonisë së Veriut.

Spektori i emergjencave përmes drejtorit të DSHPE-së është pjesë e përhershme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku vazhdimisht ka qenë pjesë aktive përgjatë të gjitha takimeve dhe ka raportuar rregullisht për gjendjen dhe sigurinë në fushën e emergjencave

Me dt. 17.11.2023 kam marrë pjesë në punëtorinë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, si dhe me Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi në komunat e Ferizajit, Kaçanikut, Hani i Elezit dhe Shtimja në kuadër të projektit "**Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për tu ballafaquar me sfidat që lidhen me riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terrorist të kthyer(RFTF) dhe familjet e tyre nga zonat e konfliktit**".

Me dt.08.12.2017 nga zjarri është djegur objekti e biznesit "SANKOS" SH.P.K. në Kaçanik duke shkaktuar dëme të mëdha materiale. Komisioni i caktuar nga drejtori i DSHPE-së ka dalë në vendngjarje dhe ka përgatitë raportin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga zjarri.

RAPORTI VJETOR 2023

Zyrtari i emergjencave përveç punëve që kanë të bëjnë me raste emergjente ka kryer edhe punë tjera që nuk kanë të bëjnë me emergjencat siç janë pjesëmarrja në komisione të ndryshme dhe aktivitete tjera që janë kërkuar nga drejtori i DSHPE-së dhe ekzekutivi i Komunës.

Ky vit, në vazhdimësi është karakterizuar me zjarre të hershme në mungesë të të reshurave e sidomos në periudhën: janar, shkurt dhe mars, të këtij viti, kemi pasur rritje të intervenimeve në shuarjen e zjarreve. Në kuadër të kësaj kemi bërë një fushat vetëdijësuese për qytetarët përmes njoftimeve të përgjithshme si: Organizimi i mbajtjes së ushtrimit, mbrojtja nga zjarri për nxënësit e parashkollorë dhe klasat e para fillore me temën: fikja e zjarreve me aparate të dorës për fikjen e zjarreve fillestare, fletë lajmërimi mediave

elektronike dhe rrjeteve sociale, me qëllim të njoftimit dhe të vetëdijesimit të qytetarëve në parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore.

Si rezultat i këtyre masave, gjatë sezonit të nxehtë verore në tre mujorin e tretë, përkundër temperaturave të larta, ne kemi pasur rënie të dukshme të zjarreve malore dhe atyre fushore. Tërë kjo falë bashkëpunimit dhe koordinimit të mirë në mes të institucioneve, gjithashtu edhe vetëdijesimit dhe kujdesi i vetë qytetarëve në parandalimin e zjarreve.

Nga raporti vjetor i Intervenimeve në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NjPZSh) për këtë periudhë: janar-dhjetor 2023 kemi intervenime në zjarre të ndryshme, intervenime teknike, shërbime të ndryshme, vërshime, gjithsejtë deri më dt. 30.12.2023 janë 212 dalje ose intervenime të përgjithshme nga NjPZSh-ja.

Nga raporti vjetor i Inspektoratit për Parandalimin nga Zjarreve, janë kryer inspektime të rregullta me ç' rast janë hartuar procesverbale dhe vendime, gjithashtu janë lëshuar, vërtetime mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri të subjekteve të ndryshme, vërtetime mbi zjarrin e ndodhur në objekte të ndryshme kryesisht të sektorit privat, njoftime për njësinë e hetuesisë së policisë së Kosovës në Kaçanik. Gjithashtu janë lëshuar edhe pëlqime të dokumentacioneve teknike në sektorin publik dhe atë privat në Komunën e Kaçanikut.

STATISTIKA -2023		
1	Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-të	1 projekt
2	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit	4 projekte
3	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale dhe atmosferike	13,420m
4	Ndërtimi i Objektit për Zjarrëfiksa-faza II-të	1 projekt
5	Ndërtim i trotuareve për këmbësor	120m
6	Ndërtimi dhe asfaltimi rr."Idriz Seferi"-Kaçanik L=600m	1 projekt
7	Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime-faza II-të	1 projekt
8	Rehabilitimi i rrugës "Avdulla Baftiu"-lagjja Zharku-Biqec	1 projekt
9	Vendosja e tabelave dixhitale "Mirësevini ne Kaçanik"	2 monitor
10	Rregullim i ndriçimit publik	5,134m/158 trupa

RAPORTI VJETOR 2023

11	Rregullimi i hapësirës publike në bulevardin Ismajl Raka	1 projekt
12	Asfaltim dhe riparim i rrugëve lokale të asfaltuara	4295.45m ²
13	Rehabilitimi i rrugëve publike të pakategorizuara me shtresë zhavori	8 projekte
14	Sinjalizim vertikal	
	a. Shenja të rrezikut.....	7 copë
	b. Shenja të urdhëresave të prera.....	23 copë
	c. Shenja të lajmërimit,.....	42 copë
	d. Tabelë plotësuese.....	4 copë
	e. Pasqyre.....	4 copë
	Sinjalizim horizontal-material një dhe dykomponent	
	a. Shenjëzim (vija) horizontal.....	1649 m
	b. Shenjëzim i vendkalimeve për këmbësor (zebra).....	416.47m ²
	c. Shigjetë udhëzuese një dhe dy drejtimëshe.....	11 copë
15	Furnizim komuniteteve me gyp ujësjellësi	
	a. Φ 63.....	100m
	b. Φ 50.....	250m
16	Trajtim i qenëve endacak	183 qenë
17	Ndërtim i vendparkingjeve për vetura	108 parkingje
18	Krasitja e drunjëve dekorativ	1 projekt
19	Pastrim i përrockave dhe lumenjëve	960m
20	Ndërtim i shtretërve të përrockave	60m
21	Pëlqime për rregullim të ndriçimit publik nga komunitetet	1 pëlqim
22	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	1 projekt

**Drejtoria e Bujqësisë Zhvillim Rural dhe Pylltarisë
Raporti Vjetor i vitit 2023 nga DBZHRP-Kaçanik.**

Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve

Aktivite kryesore për realizimin e këtij prioriteti

Arritjet /progresi/ performanca kyçe gjatë periudhës janar–dhjetor, të vitit 2023

Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët dhe vendosja me kohë.

Mbështetja e fermerëve, në kompletimin e dokumentacionit, për aplikim në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR dhe projekteve me mjete nga buxheti komunës

Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët, për vendosjen e kërkesave të tyre qytetarët janë informuar me kohë, jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve gjatë pranimit të aplikacioneve duke i ofruar ndihmë në plotësimin e aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse, gjatë aplikimit për subvencione në projektet e ofruara nga MBPZHR dhe në realizimin e projekteve me mjete nga buxheti komunës si dhe aktivitete tjera.

Nga Projektet e ofruara të MBPZHR, për subvencionim të fermerëve, këtë vit kemi 412 fermerë, që kanë aplikuar në zyrën e DBZHRS-së, në projektet e subvencionimit të MBPZHR (subvencionim të kulturës së grurit, misrit, kulturave pemëtare, perimore si dhe subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, deleve, dhive, bletëve si dhe shpezëve-pulave).

Si drejtori jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve të DBZHRS-së për subvencionim të fermerëve.

Nga projekti mbështetja e fermerëve me koshere bletësh dhe centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit, janë mbështetur 52 bletarë, me koshere janë mbështetur 37 bletarë ndërsa 15 bletarë me centrifuga elektrike. Vlera e projektit **23,904.75€**, 20% participimi i fermerëve (**4,780.95 €**)

Nga projekti për mbështetjen e fermerëve me makina mjelëse për lopë qumështore kanë përfituar 30 fermerë, vlera e projektit **7,500.00€**, 20% participimi i fermerëve (**1,500.00€**).

Nga projekti për mbështetje me mekanizëm bujqësor (motokultivator me freza (102 fermerë) dhe motokultivator me kositëse (60 fermerë), gjithsejt kanë përfituar **162 fermerë**, projekt i realizuar me bashkëfinancim të OJQ-ës Relief Islamik 59.76 % apo **103,946.70€** dhe komuna me participim të fermerëve 40.24% apo **69,984.00 €** (buxheti komunës **37,984.00€**, participimi i fermerëve **32,076.00€**, gjithësejtë vlera e projektit **173,940.24 €**, përfitues **162 fermerë**).

Projekti për mbështetje të fermerëve me mjete financiare për blerjen e farës dhe plehut mineral për kultivuesit e grurit, përfitues gjithsejtë **93 fermerë**, vlera e projektit **15,740.00€**

Këtë vit kemi ndërtuar kanale të hapura të ujitjes në fshatërat Biçec, Kovaçec vlera e projektit, **53,000.00€**.

Gjithashtu këtë vit fermerët kanë aplikuar edhe për projektin e serrave, projekt me bashkëfinancim të OJQ-ës The Church of Jesus christ, projekti është në proces të implementimit, (përzgjedhja e fermerëve që do të përfitojnë është bërë nga komisioni) dhe pritet vetëm montimi i serrave nga kompania fituese e tenderit.

Me kërkesë të MBPZHR kemi hartuar raportin për mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, jemi angazhuar në përcjelljen e fushatës së korrje-shirjeve, të kulturës së grurit, ku kemi hartuar raportin për ecurinë e fushatës dhe për rendimentin mesatar. Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 38 kërkesa, prej të cilave 34 janë të miratuara, 3 në proces dhe 1 e refuzuar. Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është **34153 m²** apo shprehur në hektar **3,41,53 ha**. Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej **27,126.30€**.

Me kërkesë të palëve janë lëshuar **56 vërtetime** për bletarë, lidhur me numrin e koshereve me bletë, që posedojnë bletarët, për aplikim në subvencionet e MBPZHR, 3 vërtetime që nuk posedojnë fletëparaqitje, për kompanit që aplikojnë në tenderë, për shfrytëzimin e ngastrave në pyjet publike. Janë inkasuar **560.00 €**

Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale	Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike me rastin e vizitave në terren e zyre, gjithashtu fermerët janë mbështetur me këshilla individuale sipas kërkesave së tyre, lidhur me vështirësit dhe problemet që i kanë përcjellur, gjatë vitit.
---	---

Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale përmes shtimit të masave të veprimit në teren	<ul style="list-style-type: none"> - Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore. - Për periudhën janar- dhjetor, janë konfiskuar 17.40m³ dru zjarri, sasia e masës drusore (dru zjarri) gjendet në Autoparkun e SH.I.L-së shprehur në metër hapësinor 24.90 (mh) prej kësaj mase drusore 50%, sipas kontratës i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 50% e masës drusore të konfiskuar i takojnë komunës.. - Janar-maj janë ngritur 119 fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje 89 dhe 30 për vepër penale.
Organizimi i takimeve me kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor, Kryetarin e Gjykatës, Prokurorinë si dhe takimeve të rregullta javore me stafin e sektorit të pylltarisë.	Për mbajtjen në kontroll e gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Drejtoria e Bujqësisë dhe Policisë kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve.
Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore të dhëna me tender.	<ul style="list-style-type: none"> - Shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, shitja me tenderë ngastrave, janë realizuar mjete në shumë prej 128,864.00 € nga shitja me pakicë (prerje sanitare) në pyjet publike janë realizuar 11,207.30€. Nga mjetet e realizuara 30% e mjeteve kthehen në buxhet komunës 70% e mjeteve në APK-ës.
Regjistrimi i terreneve nga prerjet ilegale	<ul style="list-style-type: none"> - Me regjistrimin e terreneve kemi filluar por nuk kemi arrit të përfundojmë, ende jemi në regjistrim të terreneve shpresojmë që do të arrijmë të përfundojmë me kohë regjistrimin në terren.

Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private

- Janë pranuar **122** kërkesa për prerje në pyjet private të cilat janë aprovuar. Nga kërkesat e aprovuara janë vulosur **1,028.80m³**, masë drusore, për djegie **918.50m³** ndërsa trupa teknik **110.30m³**, të lejuar për prerje nga APK-ës, për vitin 2023, masa drusore e lejuar për prerje jashtë pyllit (mexhe) **508.50m³** dru zjarri dhe **25.40m³** trupa teknik. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private dhe ritransporti i masës drusore, janë realizuar **4,491.22 €**, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

JANAR

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2023 dhe raportit të punës për vitin 2022
- Takim pune me të gjitha OJQ-të (kulturore, rinore e sportive) të komunës tone
- Angazhim në dhënjën e informacioneve në Planin gjithpërfshirës të komunave për vitin 2022 ku në këtë plan janë edhe obligimet e komunave nga agjenda evropiane
- Takim pune me zyrtarë të Trashëgimisë Kulturore-Regjioni i Ferizajit rreth gjendjes egzistuese të objekteve të Trashëgimisë Kulturore që janë në listën e mbrojtjes.
- Shpërndarje e rekuizitave sportive në Palestrën Sportive për shkollat e mesme dhe fillore të komunës tonë-donacion në kuadër të projektit „Komunat për të Rinjë”
- Është bërë vlersimi i punës së zyrtarëve të kulturës, rinisë dhe sportit për vitin 2022
- Monitorimi i lëndëve të subvencioneve në kulturë, rini e sport për vitin 2022 nga komisioni përkatës.
- Pjesëmarrje në dy takimet e mbajtura bashkë me anëtarët tjerë të Këshillit Organizativ Komunal për kremtimin e “17 Shkurtit”- Festa e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës
- Vizitë me karakter punc në Muzeun Kombëtar të Kosovës
- Plotësimi i Planit Vjetor i mbështetjes financiare për OJQ- të dokument që i dërgohet Zyres së Kryeministrit.
- Angazhim në komisionin për regjistrimin e pasurisë komunale.

SHKURT

- Përgatitja për publikimin e Thirrjes publike për subvencione në kulturë, rini e sport;
- Takim informues me klubet, OJQ-të dhe organizatat kulturo-artistike, rinore e sportive përkitazi me procedurat e aplikimit për subvencione në vitin 2023;
- Pjesëmarrje në punëtorinë me temë “Hapat e mëtutjeshëm të rrjetit për përkrahjen e të rinjëve” dhe modalitetet, organizuar nga USAID- Programi UP TO YOUTH
- Janë mbajtur të gjitha aktivitetet e planifikuara, sipas planprogramit të krijuar nga Këshilli Organizativ për shënimin e 15- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës
 - shpërndarja e ftesave dhe njoftimeve në kuadër të aktiviteteve,
 - vendosja e flamujve në vendet e përcaktuara,
 - organizimi i garës për ese,
 - organizimi i akademisë festive,
 - turneu i shkollave fillore në futboll dhe ndeshja në volejbol
- Përgatitja e propozim- vendimit për ndarjen e subvencioneve (i dërguar si pikë për diskutim dhe pikë për rend dite në Kuvendin Komunal)
- Pjesëmarrje në trajnimin “Të rinjtë pa kujdesje prindërore”- organizuar nga organizata OFAP dhe e mbështetur nga MKRS- ja.
- Nënshkrimi i marrëveshjes për subvencionim, me vlerë prej 6,480.00 €, nga MKRS- ja për Bibliotekën Publike, me qëllim blerjen e librave.
- Pjesëmarrës në aktivitetin me moto “Rruga pa pengesa, e drejta jonë”- organizuar nga HANDIKOS, me qëllim promovimi i një shoqërie gjithpërfshirëse dhe e barabartë.

RAPORTI VJETOR 2023

MARS

- Kontakti me përfaqësues të OJQ-ve, ofrimi i ndihmës teknike në përgatitjen e dokumentacioneve të nevojshme për aplikim në subvencionet për kulturë, rini e sport;
- Takim pune me Rrjetin për përkrahjen e të rinjëve lidhur me qëndrueshmërinë e këtij rrjeti pas përfundimit të programit "Up to Youth"
- Është publikuar thirrja për subvencionim në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
- Është publikuar thirrja për të qenë anëtar për komision të jashtëm për subvencione
- Themilimi i Komisionit për ndarjen e subvencioneve dhe fillimi i punës së këtij komisioni.

PRILL

- Pjesëmarrje dhe bashkëorganizim në Turneun e Mundjes "Heroinat e Kaçanikut", organizuar nga Federata e Mundjes së Kosovës dhe Klubi i Mundjes "Kaçaniku".
- Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, shënimi i 6 prillit-Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe
- Në bashkëpunim me shoqatën e Petagogëve të Edukatës fizike janë organizuar garat shkollore në futsall
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tokës organizuar në bashkëpunim me OMM : Gjethi.
- 22 Prillit-Dita Ndërkombëtare e Librit e organizuar në bashkëpunim me KVRL
- Angazhim në grupin për performancë komunale në lëminë e kulturës, rinisë e sportit.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Petagogëve të Edukatës Fizike dhe Federatën e Sportit Shkollorë janë zhvilluar Garat Regjionale në Futsall në Palestrën e qytetit në Kaçanik.
- Kampi i mundjes i mbajtur në Palestër në Kaçanik organizuar nga Federata e Mundjes së Kosovës dhe Maqedonisë.
- Nenshkrimi i memorandum bashkëpunimit ne mes MKRS dhe bibliotekës komunale per furnizim me libra

MAJ

- Bashkë organizim me Policinë e Kosovës në mbajtjen e Turneut Memorial „Armend Trena-Malsor Dashi”.
- Takim me zyrtarë nga Banka Botrore, MAPL dhe CDF si dhe vizitë dy OJQ-ve përfituese të projektit "Komuna për të Rinjë".
- Pjesëmarrës në Këshillin Organizativ për shënimin e 11 Qershorit-Dita e Qlirimit të Kaçanikut me rrethinë.
- Turnir në Volejball me shkollat e komunës tone, aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Petagogëve të Edukatës Fizike në Kaçanik.
- Takim pune me zyrtarë nga Qendra rajonale e Trashëgimisë Kulturore, ku temë diskutimi ishte intervenimi emergjent në objektet që janë në listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje.
- Pritja e Kampioneve të mundjes, pas arritjeve në Kampionatin Ballkanik në Greqi
- Publikimi i rezultateve të Subvencioneve në Kulturë, Rini e Sport
- Organizimi i garave komunalë për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në volejball. aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik
- Publikimi i draft rregullorës së Shtëpisë së Kulturës në ëeb faqen e komunës.

RAPORTI VJETOR 2023

- Pregatitja dhe plotësimi I aplikacioneve për Entin e Statistikave të Kosovës.
- Pjesëmarrës në tryezën me temë Shërbimet sociale afër Qytetarit , e organizuar nga Koalicioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Asociacionin e Qendrave për Punë Sociale në Ferizaj
- Shërbim dhe sistim në mbajtjen dhe organizimin e Turneut Memorial “ Diki 2023 ”.
- Janë përcjellur shënimet në Komitetin Olimpik të Kosovës për infrastrukturën sportive .

QERSHOR

- Shënimi i 1 Qershorit-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- Takim në zyrën e kryetarit të komunës me zyrtarë të MAPL në lidhje me vazhdimin e projektit „Komunat për të Rinjë”
- Angazhim në mbarëvajtjen e aktiviteteve të 11 Qershorit-përvjetori i Qlirimit të Kaçanikut me rrethinë:
 - Vrapim me moton „Vrapim i Lirisë”
 - Akademia Festive
 - Përfurimi librit të autorit Berat Luzha
- Angazhim dy ditor në mbarëvajtjen e festivalit të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturo-Artistike „Kaçaniku 2023”
- Angazhim në plotësimin e pyetsorit në lëminë e trashëgimisë kulturore në kuadër të obligimeve të komunave në planin gjithpërfshirës në periudhën Janar-Qershor 2023, i dalur nga agjenda evropiane
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit „Plani i qëndrueshmërisë për rjetin për përkrahjen e të rinjëve” e organizuar nga USAID-programi UP TO YOUTH.
- Angazhim në organizimin e festivalit “Anibar on Tour” - shfaqja e një programi të filmave që tregon diversitetin e teknikave dhe animacioneve te vecanta.
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit në regjionin e Ferizajt me temën “Pjesëmarrja e të rinjëve në procesin e konsultimeve publike”,e mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.
- Kemi përfunduar me grumbullimin e të dhënave për objektet e trashëgimisë kulturore të propozuara nga ana e jonë për futjen nën mbrojtje të këtyre objekteve.

KORRIK

- Angazhim në aktivitetet kulturore, rinore e sportive (koncert folklorik dhe në rock-koncert, street ball, kampi I të rinjëve në Livadhet e Shtrazës etj.. për javën e diasporës
- Ofrimi i shërbimeve teknike këshillit organizativ të Kuvendit Kombëtarë Shqipëtarë si dhe pjesëmarrje në cilësinë e musafirit në këtë kuvend.
- Pjesëmarrja në punëtorin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal
- Debat Publik me përfaqësues të OJQ-ve, SHKA-vc, Klubeve Sportive

GUSHT

- Angazhim në aktivitetet kulturore e rinore, Akademi përkujtimore për nderë të 10 Gushtit-Dita e Dëshmorëve në komunën tonë si dhe ndezja e fencerëve nga të rinjë e KVRL në kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve.
- Angazhim në aktivitetet sportive (street-ball) për nderë të 10 Gushtit-Dita e Dëshmorëve në komunën tone

RAPORTI VJETOR 2023

SHTATOR

- Aktivitete socializuese argëtuese e sportive me HANDIKOS dhe KVRL, tryezë diskutimi me temë „Drogat, Bulizmi dhe Huliganizmi” në kuadër të Javës së Rinisë 2023
- Shënimi i Javës Europiane të Sportit-në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Federatën e Sportit Shkollor, Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike në Kaçanik dhe Klubin e Volejbollit "Kaçaniku" (femrat).
- Shënimi i Ditës së rinisë me përrurimin e leximorës ,shfaqje e një filmi në ekran të hapur dhe lojra argëtuese për të rinjë
- Angazhim në komisionin e performancës në lëminë e kulturës, rinisë dhe sportit
- Përgatitja e hapsirës së sallës së Kushtetutës së Kaçanikut për vizitorë me rastin e përvetorit të “7 shtatorit”.
- Pjesëmarrës në debatin publik me temë „Rregullimi socio-mjedisor i hapsirës publike ngjitur lumit Lepenc në Soponicë “ si dhe „Profili i planit lokal të veprimit për mjedis”- e organizuar nga OMM „Gjethi” dhe e përkrahur nga Komuna e Kaçanikut.
- Pjesëmarrës në garat e motoqiklizmit në Shtrazë e organizuar nga klubi i motoqiklizmit dhe federate përkatse në cilësinë e musafirit.
- Pjesëmarrës në mbledhjen e komisionit Kaçanik -Moosseedorf
- Aktivitete sportive e argëtuese në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës dhe HANDIKOS-Kaçanik

TETOR

- Angazhim në organizimin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve me aktivitete të ndryshme kulturore e sportive.
- Ofrimi i shërbimeve për Kryqin e Kuq Komunal në organizimin e aktiviteteve sportive me karakter humanitarë në kuadër të muajit të solidaritetit.
- Asistencë OJQ-ve dhe grupeve joformale për aplikim në projektin „Komunat për të Rinjë”
- Takim pune me zyrtarë regjional të Trashëgimisë Kulturore nga Ferizaji ku temë ishte mundësia e përpilimit të një projekti të detajuar të sallës së Kushtetutës së Kaçanikut.
- Monitorimi i audicionit të këngëve popullore për fëmijë që është duke u mbajtur në kuadër të Festivalit të këngëve popullore për fëmijë 2023(Festivali do të mbahet në muajin nëntorë në kuadër të festave të nëntorit e që organizohet në bashkëpunim me SHKA,,Gryka e Kaçanikut.
- Intervistë me gazetarë të Kallxo.com -platformë online
- Pjesëmarrje në trajnimin “Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal “ në kuadër të projektit “ Komuna për të rinjë “
- Angazhim dhe asistim në koncertin me fëmijët nga diaspora.
- Pjesëmarrje në seancën informative me temë “ Të drejtat e Njeriut në Kosovë “.
- Angazhim në publikimin e thirrjes publike për subvencionim në kuadër të projektit “ Komuna për të rinjë “.
- Komunikim i vazhdueshëm me CDF rreth aplikimeve në projektin Komunat për të rinjët si dhe asistimi në plotësimin e aplikacioneve
- MKRS ka përcjell listen e trashëgimisë kulturore per Mbrojtje te Perkohshme te Aseteve apo permbajtje me forma te shprehjes kulturore te cilat mund te jene pjese perberese potenciale e Trashegimise Kulturore
- Në palestër organizuar nga Federata e Mundjes së Kosovës dhe Klubi i Mundjes Kaçaniku u mbajti kampionati i Kosovës në Mundje për U17.
- Organizimi i shfaqjes për fëmijë.

RAPORTI VJETOR 2023

NËNTOR

- Aktivitete kulturore me rastin e Festave të Nëntorit (vizitë shtëpisë Muze të Dëshmorit Ismajl Raka, program kulturo-artistik për festat e Nëntorit).
- Festival tre ditor i Këngëve Popullore për Fëmijë „Kaçaniku 2023” , organizuar në bashkëpunim me SHKA „Gryka e Kaçanikut”
- Pjesmarrje në diskutimin rreth Strategjisë për Rini 2024-2032-organizuar nga Ministria për Kulturë Rini e Sport.
- Pjesëmarrës në puntorinë dy ditore me temë „Fuqizimi i Rrjetit për Përkrahjen e të Rinjëve”-programi,„Up to Youth”i financuar nga USAID.
- Shpërndarja e njoftimeve pronarëve të objekteve të Trashëgimisë Kulturore që janë nën mbrojtje të përkohshme,njëherit edhe që janë shfrytëzues dhe posedues të këtyre objekteve .
- Pjesmarrje në puntorinë me temë„Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perendimorë për tu ballafaquar me sfidat që lidhen me riintegrimin,risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terrorist të kthyer dhe familjeve të tyre nga zonat e konfliktit, e organizuar nga organizata IOM dhe Divizioni i Parandalimit dhe Riintegritit pran Ministrisë së Punëve të Mbrendshme

DHJETOR

- Angazhim në shënimin e 3 Dhjetorit-Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara në bashkëpunim me shoqatën HANDIKOS si dhe përrurimi i objektit për këtë shoqatë.
- Angazhim në procesin e nënshkrimit të marrëveshjes tripalëshe për nëngrante në projektin „Komunitat për të Rinjët”
- Pjesmarrje në debatin publik Plani për Veprim në Mjedis-të arriturat e projektit „Shijoni lumenjtë e Pellgut të Lepencit”
- Pjesmarrje në cilësinë e fasilatorit në një takim me të rinjët e programit „Up to Youth”me temë „Të Rinjët në Vendimarrje”
- Angazhim në aktivitete sportive me fëmijët e HANDIKOS organizuar në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës.
- Angazhim në festivalin e këngëve, valleve dhe lojrave tradicionale edicioni i tretë organizuar nga SHKA,„Tingujt e Vendlindjes”-financuar nga MKRS

ORGANIZATAT KULTURORE, RINORE E KLUBET SPORTIVE

Edhe këtë vit Organizatat kulturore , rinore dhe klubet sportive janë përkrahur me subvencione sipas thirrjes publike, të ndara nga komisioni i themeluar përkatës. Janë përkrahur dhe ndihmuar me subvencione organizatat kulturore, rinore e sportive :

1. Klubi Futbollit “Lepenci”
2. Fondacioni Bonevet,
3. Klubi Basketbollit “Kaçaniku”,
4. Klubi Futbollistik i Femrave “Bazelli 2015”
5. Klubi Hendbollit “Lepenci”
6. Klubi Mundjes “Kaçaniku”
7. Klubi Taekwondos “Kaçaniku 2000”
8. Klubi Volejbollit “Kaçaniku” (femrat)

RAPORTI VJETOR 2023

9. Klubi Volejbollit “Kaçaniku” (meshkujt),
10. Këshilli Veprimit Rinor Lokal,
11. Motokros “Kaçaniku”,
12. Qendra Kulturore “Kaçaniku”,
13. Shoqata Bjeshkatore Alpiniste “Kaçaniku 2015”,
14. Shoqëria Kulturo Artistike “Tingujt e Vendëlindjes”,
15. Shoqëria Kulturo Artistike “Gryka e Kaçanikut”,
16. Shoqata e Peshkatarëve Rekretativo Sportiv “Trofta e Lepencit
17. Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor.
18. Klubi i Shahut „Lepenci”
19. Organizata e Pensionerëve të Kosovës –Dega Kaçanik.

OBJEKTET SPORTIVE

Angazhimet dhe kërkesat e DKRS-së për infrastrukturën sportive në komunën tonë drejtuar Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit edhe këtë vit nuk kanë munguar, ku edhe pas shumë kërkesave të dërguara, edhe këtë vitë nuk kanë vazhduar punimet në ndërtimin e tribunave në Stadiumin e Qytetit “Besnik Begunca”, ndërsa me buxhetin komunal është bërë edhe montimi i rrjetave, kabinave dhe rrethojës në pjesën e mbrendëshme të Stadiumit. Momentalisht në Stadiumin e Qytetit “Besnik Begunca” stërvitet dhe ndeshjet i zhvillojnë Klubi i Futbollit “Lepenci”, dhe gjitha shkollat e futbollit të cilat veprojnë në komunën tone. Në Palestrën Sportive e cila tani më është funksionale zhvillojnë aktivitetet gjitha klubet sportive të cilat aktivizohen në komunën tone. Fusha me barë sintetik afër palestrës sportive shfrytëzohet nga 2 shkolla të futbollit dhe të gjithë qytetarët e komunës sonë. Punimet në ndërtimin e fushave të jashtme sportive dhe stazës rekretative të vrapimit në hapësirën e Palestrës Sportive, projekt 2 vjeçar i realizuar me buxhet komunal, tani është në fazën finale.

SHTËPIA E KULTURËS “XHELADIN KURTAJ”

- Edhe gjatë vitit 2023 drejtorja dhe stafi mbështetës i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” u angazhua për kryerjen e punëve, shërbimeve dhe detyrave tjera, si:
 - Përkujdesja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e hapësirës së objektit.
 - Ofroi shërbim për lexues dhe për të gjitha asociacionet lokale, për aktivitetet e tyre jokomerciale kulturore-artistike, letrare, përkujtimore, politike, fetare, humane, sportive, garuese e manifestime të tjera.
- Gjithashtu vazhdojnë të qëndrojnë në lokalet e Shtëpisë së Kulturës:SHKA-të, si “Gryka e Kaçanikut”, QK “Kaçaniku” si dhe grupet e ndryshme, NKMDLNJ, “Handikos” (në dhjetor të vendosur në objektin e ri), Kryqi i Kuq, KVRL, OMM „Gjethi”, Shoqatat e dalura nga lufta, SH.B Alpiniste „Kaçaniku 2015” si dhe dy qendrat rinore – „Shtëpia e Shpresës” dhe „ Discovery Lab”.

SHËNIM:

- Janë organizuar e ndihmuar edhe një varg aktiviteteve e programesh të tjera në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” dhe në Palestrën e Sportit në Kaçanik, mbi bazën e kërkesave të grupeve dhe shoqatave të ndryshme joqeveritare, rinore e sportive;
- Pjesëmarrje dhe angazhim në çdo përvjetor ,vizitë pllakave të të rënëve për të gjitha datat e Rënies së Dëshmorëve në Komunën tonë.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor janë organizuar gara në të gjitha lëmitë sportive (meshkuj,femra) ku vendet e para kanë përfaqësuar komunën tonë në garat regjionale.
- Pjesëmarrës dhe të angazhuar direkt edhe në komisione të ndryshme në kuadër të Komunës .
- Pjesëmarrja e SHKA-ve në Festivale të ndryshme mbrenda dhe jashtë Kosovës , të cilat përfaqësuan komunën tonë në mënyrë të dinjitetëshme, duke i sjellur shumë qmime të qmuara .

INVESTIMET KAPITALE

Drejtoria për Kulturë,Rini e Sport në aktivitetet e saja gjatë vitit 2023 , është përkushtuar edhe në realizimin dhe menagjimin e investimeve kapitale , bazuar në listën e projekteve kapitale në projekt buxhetin e vitit 2023 , i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal . Në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit, ekzekutivin dhe zyrtarët komunal janë realizuar këto projekte:

1. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së.
2. Blerja e Kombi Busit për nevoja të Rinisë, Sportit dhe Kulturës
3. Rregullimi i Tereneve Sportive te Palestra në Kaçanik (në fazën finale)
4. Rregullimi dhe Montimi i Rrjetave, Kabinave dhe Rethojës së mbrendëshme në Stadiumin “ Besnik Begunca “ .
5. Ndërtimi dhe Rivitalizimi i Monumenteve Kulturo-Historike
6. Rregullimi i Muzeut të Qytetit në Kaçanik
7. Renovimi i kulmit tek Shtëpia e Kulturës “ Xheladin Kurtaj “ - Pjesa mbi Muze

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Në kuadër të kësaj drejtorie funksionon : Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit këtë vit ka shënuar dy vjetorin e themelimit të saj. Tashme kjo drejtori ka vënë gurëthemelet e para të funksionalizimit të saj dhe ka vijuar punën pa probleme të theksuara. Megjithatë kjo drejtori ka pasur sfida në realizimin e punëve për shkak të mungesës së stafit të cilën mungesë synojmë ta plotësojmë gjatë mandatit katër vjeçar .

Për kundër vështirësive që kemi hasur gjatë rrugës si pasoje e krizës globale dhe gjithashtu mundësive të kufizuara financiare të komunës sonë, megjithatë janë zhvilluar dhe janë në proces shumë punë të mira për Komunën dhe qytetarët tanë.

Nga puna jonë e përbashkët në këtë drejtori me fillimin e veprimtarisë së saj, është bërë identifikimi i nevojave dhe projekteve të mundshme të cilat do të krijojnë dhe mundësojnë një zhvillim më të mirë dhe më të qëndrueshëm lokal dhe të turizmit në përgjithësi. Marrë për bazë se për shkak të pozitës gjeografike , relievit kodrinoro- malor dhe natyrës së saj piktoreske, komuna jonë ka potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit të turizmit malor, andaj edhe puna jonë është e fokusuar në këtë drejtim.

Disa nga projektet që kanë filluar këtë vit e do të vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm nga kjo Drejtori janë si më poshtë:

Projektet kapitale

Emërtimi i projektit	Vlera e Kontratës/Projektit	Vlera Aneks Kontrata	Gjatësia /m	Koha e implementimit	Shpenzimet Totali	Punët e realizuara në përqindje
“Ndërtimi i trotuarit, dhe ndriçimit publik” në rrugën “Murat Lika” Strazhë	76,532.26€	6,324.77€	1700 m	2022-2023	82,857.03€	100%
“Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik” në	122,852.50€	/	1305 m	2023-2024	40,554.53€	33%

RAPORTI VJETOR 2023

rrugën “Murat Lika” Strazhë						
“Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi Gurin e Shpuar”	217,999.35€	/	509 m	2023-2024	69,999.97€	32%
“Ndërtimi i parkut Rekreativ” në Zonën Turistike Strazhë	107,317.78€	/	/	2023-2024	55,000.00€	51%

Komuna jonë në vazhdimësi do të jetë e përkushtuar në përkrahjen e projekteve që kanë për qëllim promovimin e turizmit, ndërsa presim përkrahje edhe nga niveli qendror, në mënyrë që të kemi sa më shumë projekte të tilla. Kjo duke u bazuar që tashmë çështjet e turizmit në rajon po edhe në mbarë botën po shihen me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Këtë vit jemi angazhuar që të dorëzojmë me kohë në ministritë linje projektet të cilat kemi pasur nevojë që të mbështeten financiarisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por që asnjeri projekt nuk është mbështetur gjatë vitit 2023. Projektet e dorëzuara në ministritë linje gjatë vitit 2023 janë : "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës për në Luboten", " Ndërtimi i kolektorit për trajtimin e ujërave te zeza Gërllicë-Guri i Shpumë" si dhe "Ndërtimi i objektit kullë për vizitorë tek bashkimi i dy lumenjve". Përkundër kësaj bashkëpunimi me ministritë ka vazhduar në sfera të ndryshme në hartimin e dokumenteve të ndryshme strategjike Kombëtare. Takimet kanë qenë të shpeshta me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal ,Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si dhe me departamentin e Turizmit që funksionon në kudër të kësaj Ministrie , ku kemi marrë pjesë në takime të ndryshme të organizuara si : "Ditët e Biznesit" , dhe një kontribut të jashtëzakonshëm kemi dhënë në hartimin e dokumenteve strategjike siç janë :Planin Strategjik për Zhvillim të Turizmi , Planin Strategjik të Zhvillimit Industrial etj .

Gjatë këtij viti nuk ka munguar bashkëpunimi me komunat tjera me qëllim të shkëmbimit të përvojave ndërkomunale si dhe me organizata të ndryshme joqeveritare .

Në kuadër të politikave tona zhvillimore ekonomike, ku si prioritet kemi rritjen e numrit të të punësuarve, kemi identifikuar edhe disa hapësira të përshtatshme për krijimin e zonave të reja ekonomike dhe turistike të cilat gjatë këtij viti janë propozuar në "Planin e ri Zhvillimor Komunal", me qëllim të ofrimit të kushteve infrastrukturore për investitor dhe nxitjen e investitorëve

RAPORTI VJETOR 2023

potencial. Përmes këtij procesi presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës si dhe rritje të zhvillimit ekonomik në Komunën tonë.

Është bërë publike lista e pronave komunale të cilat mund të jepen për shfrytëzim dhe jemi duke u munduar të kontaktojmë investitorë potencial me qëllim që t'i njoftojmë për kushtet e krijuara në fushën e të bërit biznes në Komunën tonë.

Kemi pasur disa kërkesa nga investitorë të ndryshëm ,1(një) nga këto kërkesa janë miratuar nga Kuvendi Komunal dhe iu është dhënë prona komunale në shfrytëzim dhe disa prej tyre janë në proces dhe pritet të vlerësohen gjatë vitit 2024.

Edhe në këtë vit ka vazhduar aplikimi i taksës zero për ushtrim të veprimtarisë së bizneseve si dhe normës minimale për biznese të tatimit në pronë. Shfrytëzimi i lokaleve në pronësi të Komunës të cilat jepen për bizneset në Komunën tonë do të mbetet falas deri në një vendim tjetër, me qëllim që të përkrahen bizneset dhe të kemi një rimëkëmbje në fushën e të bërit biznes.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit këtë vit ka punuar në hartimin e dokumenteve të ndryshme strategjike komunale. Me vendim të Kryetarit të komunës është formuar Grupi punues për hartimin e "Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Lokal" për vitin 2024-2028 i cili pritet të finalizohet gjatë vitit 2024, ndërsa kemi dhënë kontribut në dokumentin "Plani lokal për mbrojtje në mjedis" , Planin Kombëtar për "Parkun Kombëtar Sharr" sa i përket territorit që mbulon Komuna jonë në "Parkun Kombëtar Sharr" e po ashtu "Planin Zhvillimor Komunal" i cili tashmë është finalizuar si dokument dhe pritet që të miratohet në Kuvendin Komunal pas shqyrtimit të vlerësimit strategjik në mjedis VSM-së nga ministria gjegjëse .

Promovimi i potencialit turistik

Përkundër potencialit turistik që posedon vendi ynë, deri më tani, kjo fushë nuk është parë me prioritet, dhe si e tillë ka nevojë për më shumë investime, në mënyrë që të promovohen më shumë bukuritë natyrore dhe kulturore që ka vendi ynë.

Komuna e Kaçanikut, përkundër buxhetit të vogël që ka në dispozicion, është munduar që sado pak të krijoj kushte më të mira dhe të promovoj vendet me potencial turistik.

Kësisoj, gjatë vitit 2023 Komuna e Kaçanikut në kuadër të promovimit të vendeve me potencial të zhvillimit të turizmit ka realizuar videon promovuese. E njëjta është publikuar në web faqen e Komunës dhe në rrjetet sociale të cilat posedon komuna jonë .Ky punim buxhetit komunal i ka kushtuar 980€ që janë shpenzuar nga kategoria Mallra dhe Shërbime .

Gjithashtu është realizuar "Profili Ekonomik i Komunës së Kaçanikut" dokument ky i cili vë në pah potencialet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe është në dispozicion të qytetareve dhe investitorëve potencial. Profili Ekonomik i Komunës së Kaçanikut është një dokument informativ , gjithëpërfshirës i cili paraqet gjendjen reale të sektorëve me ndikim për zhvillim ekonomik të vendit. Dokumenti në fjalë përmban informacione të rëndësishme të sektorëve të veçantë me qëllim informimin e investitorëve potencial .Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është prezantimi i potencialeve me ndikim të zhvillimit të sektorëve që paraqiten në profil ekonomik. Ky dokument është realizuar në formë fizike si dhe në atë elektronike .

RAPORTI VJETOR 2023

Qendra Komunale për Regjistrim të Biznesit:

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznesore vetëm përbrenda pak orëve. Poashtu, përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorë të ndryshëm , gjithashtu ipen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese, me qëllim të qasjes më të lehtë në financa apo mjete fikse që mund të përfitohen nga donatorët e ndryshëm.

Sa i përket Qendrës Komunale për Regjistrim të Biznesit, zyra që funksionon në kuadër të kësaj qendre këtë vit ka shënuar një rritje të numrit të bizneseve të reja të regjistruara, gjithsej 156 biznese, krahasuar me vitin e kaluar që kanë qenë 135 biznese, ndërsa vitin 2023 ka pasur një trend të rritjes së bizneseve SH.P.K (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara).

Gjatë periudhës raportuese kjo zyre ka pranuar 476 lëndë të cilat janë shqyrtuar të gjitha në afat ligjor ,nga të cilat shih tabelën më poshtë .

Qendra komunale për regjistrimin e biznesit	
Biznese të reja	156
Shuarje e biznesit	11
Ndryshime në biznes	62
Certifikata të reja	28
Certifikatë dublikatë	09
Informata të biznesit	164
Vërtetim që s'ka biznes të regjistruar	07
Vërtetim për tender	30

RAPORTI VJETOR 2023

Pagese e taksës komunale për ushtrim të veprimtarisë biznesore	10
---	----

Llojet e biznesit të regjistruar	
SH.P.K	100
B.I	56

Bizneset e regjistruara sipas gjinisë	
Meshkuj	128
Femra	28

Bizneset sipas vendbanimit	
Zona urbane	90
Zona rurale	66

Bizneset sipas llojit të veprimtarisë /aktivitetit	
Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore	23
Pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste	Vlera e inkuasuar
Punime suvatimi 10	2590.00€
Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve	19
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	18
Aktivitete e tjera të specializuara ndërtimi	18
Instalime të tjera ndërtimore	17
Të tjera	40

Nga

këto shifra që i prezantuar më lartë, jemi munduar që në pika të shkurtëra të prezantojmë punën e Qendrës komunale për regjistrimin e bizneseve (QKRB), pa i përmendur këshillimet e përditshme rreth regjistrimit të bizneseve.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur trajnime të ndryshme të zyrtarëve në projekte të ndryshme. Janë zhvilluar vizita nëpër biznese dhe po ashtu janë organizuar punëtori në kuadër të memorandumit për bashkëpunim në mes Komunës së Kaçanikut dhe USAID-it në lidhje me hapjen e një biznesi fillestar ,qasjen në pronë ,qasja më e lehtë në financa zhvillimin dhe fuqizimin e bizneseve që menaxhohen nga femrat. Takimet me biznese na kane shërbyer për të njohur më nga afër problemet dhe sfidat e ndryshme që i preokupojnë bizneset tona në mënyre që përmes planeve strategjike komunale të mund t'i zgjidhim problemet dhe përmbushim nevojat e tyre . Gjithashtu kemi pasur bashkëpunime të vazhdueshme me organizata joqeveritare si : Demos, USAID, Gizin gjerman, Swiss Kontakt me qëllim të përfitimit të donacioneve që ofrohen në lidhje me zhvillimin ekonomik.

RAPORTI VJETOR 2023

DZHET mbetet e përkushtuar që fokusin kryesor ta ketë zhvillimin e sektorit privat në mënyre që të kemi stabilitet ekonomik dhe mirëqenie të qytetarit në përgjithësi, marrë parasysh kontributin që bizneset private japin për shoqërinë tonë çdo ditë .

Subvencionet dhe transferet

Këtë vit nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere kemi përkrahur bizneset private të cilat menaxhohen nga femrat. Në kuadër të thirrjes “Gratë në biznes “ kemi pasur tetë(8) përfituese .Qëllimi i Programit “Gratë në biznes”, ka pasur synim fuqizimin ekonomik të gruas përkatësisht promovimin e ndërmarrësisë së grave .

Gjithashtu nga kjo kategori është përkrahur projekti "Komuna për të rinjtë" nga e cila kanë përfituar 8 (tetë) aplikues . Nga këto subvencione kanë përfituar OJQ të ndryshme, grupe të marginalizuara, përfitues individual si dhe grupe formale të të rinjve. Sipas projektit "Komunat për të rinjë", në fazën e dytë kanë përfituar të rinjtë me projektet e tyre që përfshijnë shumën 70 mijë euro, Nga shuma e përgjithshme 15% e mjeteve janë financuar nga Komuna e Kaçanikut, kurse pjesa tjetër nga programi "Komunat për të rinjë". Projekti M4Y është një grant prej 2.7 milion dollarësh i siguruar nga Qeveria Japoneze përmes Fondit Zhvillimor Social të Japonisë (JSDF), dhe i cili administrohet nga Banka Botërore, ndërsa implementohet nga MAPL.

Nr	Emri i përfituesit (programit)	Nr. i përfituesve	Vlera e grantit
1	Gratë në biznes	7	13,884.50€
2	Komuna për të rinjtë	8	10,500.00€

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUKMM) punët e veta i kryen në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale, neni 17; Ligjin e Ndërtimit si dhe Ligjeve, Udhëzimeve dhe Rregulloreve të tjera në lëmitë përkatëse, sikurse edhe në bazë të Statutit të Komunës së Kaçanikut.

Sektori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Në sektorët e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit janë pranuar gjithsej 329 kërkesa, ankesa, vendime nga Kuvendi, Kryetari dhe Drejtoritë e Komunës, si edhe nga Ministrinë dhe organet tjera qeveritare, si dhe 26 Aktgjykime, kërkesa dhe shkresa të tjera nga Gjykatat.

Gjatë kësaj kohe këta sektorë kanë lëshuar :

- Leje ndërtimi (39)
- Në procedurë (3)
Nga Lejet e Ndërtimit të cilat janë lëshuar 5 prej tyre i takojnë kategorisë II
- Leje për vendosjen e paneleve solare (2)
- Kushte Ndërtimore të miratuara (48)
- Çertifikata të Legalizimit të objekteve pa leje (43)
- Në procedurë (26)
- Kërkesa të miratuara për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (33)
- Kërkesa të refuzuara për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore (2)
- Leje Mjedisore Komunale 3
- Njoftime me PZHK 31

Drejtoria ka lëshuar edhe 127 Vendime, Njoftime, Pëlqime, Raporte dhe shkresa të ndryshme për Ministrinë dhe organet tjera qeveritare, për Kryetarin e Komunës, për Drejtoritë, për Zyrën e Prokurimit dhe për qytetarët e komunës së Kaçanikut.

DUKMM-ja ka punuar edhe në përditësimin e sistemit të adresave dhe atë janë vendosur mbi 1500 numra në sistemin Aris. Poashtu është bërë edhe verifikimi i objekteve në komunën e Kaçanikut.

Sektori i Kadastrit

Gjatë vitit paraprak pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar dhe janë regjistruar 5855 lëndë duke i shtuar edhe lendet e bartura nga viti 2022 afërsisht 150 qe ne total jane 6005, ku nga ky numër janë zgjidhur 5855 ndërsa në pritje për ekzekutim janë edhe 250 lëndë kryesisht të RDPP-së që kanë të bëjnë me bartje të pronave si dhe legalizime të objekteve të pranuar nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së palujtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimit të tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor përkundër fluksit të madh të kërkesave nga palet përfshir kryesisht mërgimtarët që don të thot se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal.

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veq e veq të cilat gjatë ekzekutimit në total kan gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej 84,427 € (euro) dhe atë:

= Shërbimet e ofruara sipas kërkesave të palëve:

• Fleta poseduese	2609 lëndë
• Kopje të planit	690 lëndë
• Çertifikata të gjendjes së pasurisë	688 lëndë
• Koordinata gjeodezike	495 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.)	33 lëndë
• Regjistri i RDPP-së	1340 lëndë

= Regjistri i RDPP-së :

Lloji i Lendes ne RDPP	Totali
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	6
Bartja e posedimit - Blerje	298
Bartja e posedimit - Dhurim	417
Bartja e posedimit - Këmbim	7
Bartja e posedimit - Shpronësim	1
Bartja e posedimit - Trashëgimi	85
Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit	44
Bartja e pronësisë - Ndarje fizike	1
Bartja e pronësisë - Blerja	27
Bartja e pronësisë - Dhurata	2
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	3
Bartja e pronësisë Aktgjykim dhe fitime tjera të pronësisë	2
Bashkimi	117
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme	11
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	38
Fshirja e vërejtjes me vendim të gjyqates	1
Modifikimi attributeve të parceles	309
Modifikimi i attributeve të pjesës së ndërtesës	1
Modifikimi i hipotekës	3
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	8
Modifikimi i të drejtave	4
Ndarja	346
Regjistrimi i hipotekës	20
Regjistrimi i ndërtesës	63
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	2
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	7
Regjistrimi i qiramarrjes	7
Regjistrimi i servitutit I	2
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	1
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	1
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	2

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

RAPORTI VJETOR 2023

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkeshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të regjistrojn pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyreve kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar te implementohet nga Marsi i vitit 2016 deri më Mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatur edhe për një viti nga Prilli i viti 2017 deri ne vitit 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eleminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siq janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi professional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siq janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektorinë për qështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzrpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike, Shpronësimit, Mbajtjes së evidences së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të mardhënjeve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Në kuader të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimt te objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesen tekstuale te SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi mbi Legalizimet.

Duhet cekur gjithashtu se gjate viti 2021, 2022 dhe 2023 vazhdimisht kemi nje rritje te lendeve ne RDPP-së duke perfshire Legalizimet e objekteve si dhe Elaboratin e Shpronësimit te Autostrades Prishtine – Shkup, dhe ofrimin e asistimit profesional edhe ne drejtorit e tjera ku si pasoj e numrit te vogel te stafit dhe ne munges te plotesimit me staf kemi vonesa ne ezekutim te lendeve dha bartje te tyre ne vitin vijues.

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit i është përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe Institucioneve të ndryshme të republikës së Kosovës për çasje në dokumente publike, përkatësisht për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, në formë digjitale apo në formë fizike.

DUKMM-ja në muajin Janar të vitit 2023 ka dorëzuar për shqyrtim Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), për shqyrtim në MMPHI dhe marrjen e pëlqimit prej tyre për hapjen e dëgjim, it publik. Të dy planet na janë kthyer për përmirësimin e disa vërejtjeve.

VSM-ja me vërejtjet e plotësuar i është dorëzuar përsëri Ministrisë për shqyrtim, më 22.08.2023. Pa e marrë pëlqimin Nga Ministria nuk mund ta dorëzojme as Planin Zhvillimor Komunal, i cili është i gatshëm për dorëzim prej muajit Tetor 2023./ Jemi në pritjeve të përgjigjes që do të marrim nga Ministria.

DUKMM-ja ka punuar edhe në hartimin dhe zbatimin e projekteve kapitale sikurse janë:

I. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane Kaçanik:

1. Rruga “Emsale Frangu” L= 222.85 m’
2. Rregullimi dhe asfaltimi i krahut të Rrugës “Besnik Begunca” L= 103.50 m’
3. Rregullimi dhe asfaltimi i krahut të Rrugës “Selim Shehu” L= 260.00 m’
4. Rregullimi dhe asfaltimi i krahut të Rrugës “Emërlla Kuqi” L= 61.00 m’
5. Rregullimi i shkallëve në rrugën “Skenderbeu”

II. Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Rurale Kaçanik:

1. Asfaltimi I rrugëve në Fshatin Duraj:
 - Rrugica te Zaim Salijaj, degëzimi I Rrugës “A. Dura”, L=220.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Rruga “Izahir Salijaj”, L=170.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Milazim Salijaj (“A. Dura”), L=93.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Rexhep Salihu (“H.Asaj”), L=110.0m, B=3.0m
 - Rrugica te veteran (“A. Dura”), L=60.0m, B=3.0m
 - Rrugica, Degëzimi I rrugës “A. Dura”, L=50.0m, B=3.0m
 - Rrugica (Musë Zenuni), degëzim I Rrugës “A. Kaçiku”, L=220.0m, B=3.0m
 - Rruga “Ali Rama”, L=93.0, B=3.0m
 - Rruga “Hajredin Fazlia”, L=270m, B=5.0m, me tamponGjithsej rruge të asfaltuara në Duraj 1286m’
2. Asfaltimi I rrugëve në Fshatin Doganaj:
 - Rruga “Martirët e Lirisë”, L=565.0m, B=4.0m
 - Rruga te Lekt, degëzimi I Rrugës “Komandant Zefi”, L=420.0m, B=4.0mGjithsej rruge te asfaltuara ne Doganaj L=985.0m
3. Asfaltimi I rrugëve në Fshatin Doganaj-Soponicë:
 - Rruga “Flakadanët”, L=420.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Xh. Topojani, L=420.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Mynyr Topojani, L=85.0m, B=3.0mGjithsej rruge te asfaltuara ne Doganaj - Soponicë L=925.0m

4. Asfaltimi I rrugëve në Fshatin Gllloboçicë:
- Rruga te Fshati I Vjetër, L=610.0m, B=3.0m
 - Rrugica te A. Luma, L=90.0m, B=3.0m
 - Rrugica te I.Luma, L=70.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Lagjeja Dragomac, L=60.0m, B=3.0m
- Gjithsej rruge te asfaltuara ne Gllloboçicë L=830.0m
5. Punimi I Rrugëve vetëm me tampon ne Fshatin Kaçaniku I Vjetër, Elezaj dhe Kovaçec:
- Rrugica te Mendu Rexha, L=295.0m, B=3.0m
 - Rruga "Cen Loku", L=180.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Lagjeja Reç (te Shaqiri), L=165.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Lagjeja Reç (te Salihi), L=140.0m, B=3.0m
 - Degzimi I rrugës "Nazmi Osmani", L=70.0m, B=3.0m
 - Rrugica te Xhamia Kovaçec L=150.0m, L=3.0m
- Gjithsej rruge te punuara me tapon, në Kaçanik të Vjetër, Elezaj dhe Kovaçec L=1000.0m
6. Punimi I Rrugëve trotuareve me kubza në Fshatrat Biçec dhe Bob:
- Rruga "Fatmir Horuni", L=220.0m, B=3.0m
 - Trotuari përgjatë Magjistrales në Bob, L=150.0m, B=1.70m
- Gjithsej rrugë dhe trotuare të punuara me kubza L=370.0m

Gjithsej rrugë të asfaltuara L=4026.00,
Gjithsej rrugë të paasfaltuara, vetëm me tampon 1220.0m
Gjithsej rrugë dhe trotuare me kubza 370.0m

III. Ndërtimi I shtretërve të lumejve dhe prrockave:

1. Rregullimi i prronit në lagjen Dema, Bob L= 214.00 m'
2. Rregullimi i prronit në lagjen Zeneli, Bob L= 70.00 m'
3. Rregullimi i prronit në rrugën "Mejdi Dalloshi", Kaçanik L= 70.00 m'
4. Rregullimi i prronit në lagjen Rakoc, Kaçanik L= 160.00 m'
5. Rregullimi i prronit në lagjen Muça, fshatin Kovaçec L= 35.00 m'
6. Rregullimi i prronit në lagjet Bunjaku dhe Palloshi, fshatin Kovaçec L= 114.00 m'
7. Rregullimi i prronit në lagjet Burrnikëve, fshatin Runjevë L= 70.00 m'
8. Rregullimi i prronit në fshatin Stagovë L= 90.00 m'

IV. Rrenimi i objekteve dhe mbyllja e deponive ilegale

V. Ndërtimi i Urës mbi lumin Neredime

VI. Ndërtimi i Çarshisë së vjetër

Drejtoria ka bërë menaxhimin e projekteve edhe të drjetorive të tjera:

- Rregullimi dhe renovimi i objekteve shëndetsore dhe sociale
- Renovimi i kulmit dhe izolimi i jashtëm, shkollia fillore "Qamil Ilazi", paralelja e ndarë Çardak.
- Mirbajtja dhe renovimi i Objekteve shkollore
- Ndërtimi i parkingut nëntoksor në administratën Komunale , Komuna Kaçanik (Puna është ndërprerë)
- Realizimi i videos promovuese të Komunës të Kaçanikut

ZYRA E PROKURIMIT

Objektivat e Zyres së Prokurimit si njisi në kuader të zyres së Kryetarit kanë qenë në përmbushjen e kërkesave të njisisve kërkuese respektivisht realizimin e planit të prokurimit në përmbushjen e kërkesave të njisisve kërkuese dhe realizimin tyre.

Të gjitha aktivitetet e Prokurimit janë realizuar bazuar në harmoni të plotë me komtetencat e Zyres së Prokurimit respektivisht Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim publik, Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurim publik .

Në Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023, janë aktiviteti i zyres së prokurimit lidhur me Raportimet , Procedimi i kërkesave të Drejtorive për Tenderimin dhe implementimin e Kontratave për Furnizime, Shërbime dhe Punë të realizuara gjatë vitit fiskal 2023.

Janë përgatit Raportet vjetore dhe janë përcjellë Raportimi për Kontratave të nënshkuara bazuar në Formularin standat të KRPP-së B53 .

Gjatë vitit fiskal 2023 janë zhvilluar procedurat e prokurimit përmes sistemit e-prokurimi dhe janë publikuar respektivisht janë Kontraktuar 107 Kontrata për Furnizime : Shërbime dhe Punë në shumë prej 4,682,424.62€ ndersa vlera e planifikuar për keto Projekte ka qenë 5,189,873.58€.

Në bashkëpunim me Njisi të kërkuese respektivisht Drejtoritë janë publikuar procedurat e prokurimit bazuar në kërkesat dhe nevojave të njisisve kërkuese gjithsejtë prej të cilave janë Kontraktuar 107 projekte.

Bazuar në përgjegjësit dhe obligimet e Zyres së Prokurimit si dhe Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 respektivisht Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës janë dhënë qasje në kërkesat e Operatorëve ekonomik për qasje në dokumente publike ku kanë pasë qasje 15 Operatorë ekonomik dhe 5 qasje nga OJQ dhe institucione tjera.

Kerkesa për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues nga aktivitete të tenderimit kemi pasë 13 Kërkesa për Rishqyrtim prej të cilave janë Refuzuar prej të cilave vazhdu procedurat repektivisht Ankesa në OSHP janë 7 Ankesa nga Operatoret ekonomik.

OSHP ka vendosë për 5 Ankesa të OE prej të cilave një është kthynë Rivlersim dhe 4 janë Refuzu kerkesat e Operatoreve ekonomik respektivisht Vendimi i Autoritetit kontraktues ka mbetë në fuqi, dhe dy janë në proces të Vendimarrjes së OSHP-së.

Gjatë vitit 2023 stafi i Zyres së Prokurimit ka marrë pjesë në takime të Organizuara nga KRPP, Kolegjiumi i Prokurimit dhe IKP-i.

Bashkangjiteur Lista e Kontratave për vitin 2023.

RAPORTI VJETOR 2023

KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE PËR VITIN 2023

Nr. i Prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashkuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.
001	Vendosja e tabelave digjitale me mbishkrimin "Mirrësevini në Kaçanik"	€ 20,000.00	€ 17,799.55
002	Sherbime kontraktuale - Këshilltar Ligjor	€ 5,400.00	€ 5,400.00
003	Mbeshtetje e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifuga elektrike	€ 33,000.00	€ 23,904.75
004	Furnizim me fletore , kimika dhe kalendar	€ 990.00	€ 980.00
005	Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjat lumit Nerodime	€ 100,000.00	€ 77,787.83
006	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	€ 751.45	€ 751.45
007	Renovimi i objektit të Administratës Komunale	€ 16,720.00	€ 13,519.49
008	Furnizime mjeksore	€ 990.00	€ 820.50
009	Furnizim me lule dekorative dhe flamuj	€ 990.00	€ 990.00
010	Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi Gurin e Shpuar	€ 220,000.00	€ 217,999.35
011	Rregullimi i ndriqimit të fushës sportive - Kaçanik	€ 13,500.00	€ 9,871.25
012	Ndërtimi i rrugës që lidhë pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën Nacionale N2	€ 380,000.00	€ 360,629.94
013	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale- Kaçanik	€ 227,000.00	€ 191,098.31
014	Ndërtimi i trotuarit, shtegu për çiklizëm dhe ndriqim publik në rrugën Murat Lika Strazhë	€ 125,000.00	€ 122,852.50
015	Furnizim me paisje higjienike per stomatologji	€ 950.00	€ 950.00
016	Hartimi dhe modifikimi i projektit të sallës së edukatës fizike Biqec	€ 980.00	€ 950.00
017	Furnizim me material Higjienik (pastrimi)	€ 30,000.00	€ 18,774.75
018	Shërbimet e byfesë	€ 8,000.00	€ 8,000.00
019	Ndërtimi i Nënkalimit - Kaçanik	€ 235,000.00	€ 210,096.80
020	Riparimi i fshisave industriale	€ 870.00	€ 870.00
021	Rregullimi i ndriqimit publik në rrugën "Hetem Hasaj", "Liria " dhe "Abit Dullovi"-biqec	€ 50,000.00	€ 48,977.82
022	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU Jusuf Gervalla - Biqec	€ 300,000.00	€ 285,000.00
023	Furnizime mjeksore për nevojat shëndetsdore	€ 120,000.00	€ 79,740.00
024	Rregullimi i pusëtave per linjejn elektrike	€ 999.00	€ 987.50
025	Shërbime Konsulente - Këshilltar për Planifikim Hapsinor	€ 1,200.00	€ 1,000.00
026	Mirmbajtja dhe servisimi i automjeteve	€ 18,000.00	€ 18,000.00
027	Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellsëve në lokalitetet Ivajë, Bajnicë- Kaçanik	€ 150,000.00	€ 144,941.60
028	Shërbime DDD	€ 990.00	€ 975.00
029	Ndërtim i parkingut nëntoksor në Administratën Komunale	€ 498,000.00	€ 444,791.48
030	Mirmbajtja dhe renovimi i objekteve Shkollore	€ 115,000.00	€ 103,619.65
031	Sigurimi i veturave per administratë dhe QKMF	€ 900.00	€ 869.99
032	Ndërtimi i objektit për zjarfiksit - Kaçanik , faza e dytë	€ 150,000.00	€ 143,515.87
033	Renovimi i kulmit dhe izolimi i jashtëm i objektit Shkolla fillore "Qamil Ilazi", paralelja e ndarë Qardak	€ 30,000.00	€ 24,952.50
034	Ndërtimi i objektit të QMF-së Doganaj, Faza e III-të (Aneks Kontratë)	€ 2,407.20	€ 2,407.20
035	Vendosja e ashensorit në Gjimnazin Skënderbeu - Kaçanik	€ 30,000.00	€ 27,822.00
036	Furnizim me oksigjen Per QKMF	€ 960.00	€ 957.60
037	Furnizimi me lule per parqet e shkollave	€ 993.00	€ 993.00
038	Renovimi i objektit të Shtëpisë së Kulturës (Aneks Kontratë)	€ 2,820.00	€ 2,820.00
039	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Urbane- Kaçanik	€ 140,000.00	€ 123,492.80
040	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Begracë-(Aneks Kontrat)	27,137.69	€ 27,137.69
041	Dezinfektimi i objekteve shkollore	€ 990.00	€ 985.00
042	Rregullimi i Muzeut Kacanik	64,650.00	€ 61,999.00
043	Zgjerimi i hyrjes te gjimnazi Skënderbeu - Kaçanik-Ritender	105,000.00	96,533.00
044	Sherbimet e akomodimit dhe transportit per zyrtaret pjesmarres ne puntori.	€ 4,500.00	€ 4,095.00
045	Furnizimi me lule dekorative per festa	€ 992.00	€ 992.00
046	Furnizim me paisje ndryshme (Mjete Pune)	€ 11,500.00	€ 7,788.00
047	Ndërtimi i trotuarit në rrugën Murat lika ne fshatin Shtrazë (Aneks Kontrat)	€ 6,324.77	€ 6,324.77

048	Ndërtimi i parkut Rekreativ në zonën Turistike Shtrazë	€ 120,000.00	€ 107,317.78
049	Rregullimi i ndriqimit në rrjetet ekzistuese të ndriqimit publik	€ 9,900.00	€ 6,592.30
050	Ndërtimi i shtretërve të luimenjëve dhe Prroskave	€ 170,000.00	€ 159,683.33
051	Furnizim me kombi për shërbimet të pacientëve të hemodializës	€ 50,000.00	€ 49,500.00
052	Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së	€ 70,000.00	€ 68,836.21
053	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike	€ 20,000.00	€ 18,208.62
054	Furnizim me paisje për mbrojtje kundër Zjarrit	€ 4,700.00	€ 3,100.00
055	Rregullimi dhe renovimi i infrastrukturës shëndetsore dhe sociale	€ 120,000.00	€ 110,777.55
056	Rregullimi dhe montimi i rrjetave , kabinave dhe rrethojat të stadiumit të Qytetit (Ritender)	€ 8,500.00	€ 8,392.90
057	Shërbimet e sigurimit të automjeteve për regjistrime të rregullta	€ 1,640.00	€ 1,639.21
058	Asfaltimi i rruges Abit Dullovi, Shaban elezi dhe Rexhep Luzha (Aneks Kontrat)	€ 12,345.00	€ 12,345.00
059	Ndërtimi i kanaleve të hapura të ujitjes në fshatrat Biçec dhe Kovaçec (Ritender)	€ 55,000.00	€ 53,000.00
060	Furnizime mjeksore për emergjencë	€ 950.00	€ 944.00
061	Rehabilitimi i rrugës "avdullah Baftiu" - Lazha Zharku /Biçec	€ 40,000.00	€ 38,999.82
062	Realizimi i videos promovuese të Komunës së Kaçanikut	€ 1,200.00	€ 989.00
063	Furnizim me lëndë djegse Pelet	€ 28,500.00	€ 21,740.40
064	Furnizim me Kombi bus per DKRS (Ritender)	€ 70,000.00	€ 68,999.00
065	Ndërtimi i urës mbi Lumin Nerodime - Kaçanik (Ritender)	€ 85,000.00	€ 79,960.64
066	Rrënim i objekteve dhe largimi i deponive ilegale	€ 40,000.00	€ 40,000.00
067	Furnizim me paisje të IT	€ 16,000.00	€ 14,171.00
068	Sigurimi fizik i objekteve (Aneks Kontrat)	€ 7,866.57	€ 7,866.56
069	Zgjerimi i hyrjes te Gjmnazi Skenderbeu - Kaçanik, (Aneks Kontrat)	€ 9,620.50	€ 9,615.00
070	Shërbimet e Sigurimi fizik për objektet e Komunës (Ritender)	€ 110,000.00	€ 94,676.40
071	Shërbime kontraktuale-Specialist i Gjinekologjisë.	€ 15,600.00	€ 14,400.00
072	Mbeshetja e fermerëve me mekanizëm Bujqësor - Freza	€ 21,000.00	€ 13,860.00
073	Hartimi i Projekteve për Komunën e Kaçanikut	€ 120,000.00	€ 120,000.00
074	Mirmbajtja dhe Rregullimi i ndriqimit në rrjetet ekzistuese të ndriqimit publik	€ 9,900.00	€ 6,383.00
075	Furnizim me Pemë dhe Perime për QEAP "AGIMI"- Kaçanik	€ 4,700.00	€ 3,656.00
076	Furnizimi me tonera per administratën në Arsim	€ 995.00	€ 995.00
077	Furnizim me material për Kabinetet SHMP "Feriz Guri dhe Vllezërit Çaka"- Kaçanik	€ 22,500.00	€ 18,925.80
078	Furnizim me shtretër (Barela) dhe mjete mjeksore për nevojat e QKMF-së Kaçanik (Ritender)	€ 11,000.00	€ 8,980.00
079	Shërbime kontraktuale - Specialist i Radiologjisë	€ 6,600.00	€ 6,600.00
080	Vendosja e sistemit të GBS-ve në veturat e administratës komunale	€ 6,000.00	€ 5,988.50
081	Furnizim me shtretër , inventar dhe lodra për QEAP Agimi - Kaçanik	€ 29,500.00	€ 24,836.00
082	Furnizimi dhe montimi i pompës termike për QEAP "Agimi"	€ 30,000.00	€ 26,851.00
083	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve zyrtare	€ 9,950.00	€ 9,770.50
084	Furnizimi me tonera per administratën Komunale	€ 980.00	€ 974.00
085	Mirmbajtja verore dhe dimrore e rrugëve lokale	€ 475,000.00	€ 475,000.00
086	Furnizim me paisje të ndyshme të IT	€ 16,000.00	€ 15,240.00
087	Furnizim me mjete mjeksore për QKMF-në	€ 9,000.00	€ 7,229.00
088	Renovimi i kulmit të Shtëpisë së Kulturës, pjesa mbi muzeun	€ 9,950.00	€ 9,948.00
089	Furnizim me veshmbathje për stafin e QKMF-së Kaçanik	€ 4,264.00	€ 4,264.00
090	Furnizim me material për mirmbajtjen e objekteve shkollore	€ 990.00	€ 990.00
091	Renovimi i kulmit dhe izolimi i jashtëm i objektit Shkolla fillore "Qamil Ilazi", paralelja e ndarë Qardak (Aneks Kontrat)	€ 2,483.50	€ 2,483.50
092	Furnizim me Komputera	€ 9,995.00	€ 10,242.00
093	Mirmbajtja dhe renovimi i objekteve Shkollore (Aneks Kontrat)	€ 10,290.50	€ 10,290.32
094	€ 12,648.00	€ 12,648.00	
094	Ndërtimi i tereneve sportive (Aneks Kontrat)	€ 9,975.00	€ 9,500.00
095	Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit	€ 990.00	€ 980.00
096	Furnizimi me flamuj dhe mirenjohje	€ 950.00	€ 950.00
097	Mirmbajtja dhe riparimi i sistemi të nxemjes Qëndrore	€ 12,345.00	€ 12,345.00
098	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Urbane (Aneks Kontrat)	€ 6,093.00	€ 6,092.30
099	Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK-së, (Aneks Kontrat)	€ 980.00	€ 980.00
100	Furnizim me foltore dhe ceradë me foto të Dëshmorëve	€ 7,546.40	€ 7,546.00
101	Rehabilitimi i dy shefitoreve përgjat lumit Nerodime (Aneks Kontrat)- Ritender	€ 2,639.00	€ 2,639.00
102	Rregullimi i muzeut Kaçanik (Aneks Kontrat)	€ 993.00	€ 993.00
103	Furnizim me material per Zyre	€ 599.00	€ 598.04
104	Sigurimi i veturave të QKMF-së	€ 980.00	€ 950.00
105	Furnizimi me fletore dhe kalendar per festat e fundevitit	€ 990.00	€ 990.00
106	Shërbimet e internetit për Shkollat	€ 720.00	€ 720.00
107	Furnizim me kartona të lëndëve dhe mbështjellës të lëndëve		
		€ 5,189,873.58	€ 4,682,424.62

ZYRA E INSPEKTORATIT

Sektori i inspektoratit në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi të saj, ushtron aktivitetet e mbikëqyrjes inspektuese nga:

- Inspektori i Mjedisor,
- Inspektori i Tregut,
- Inspektori i Shërbimeve Publike,
- Inspektori i Komunikacionit,
- Inspektori i Ndërtimtarisë,
- Inspektori i Pylltarisë.

Gjatë këtij viti raportues, deri diku kemi pasur disa sfida dhe të cilat kemi arritur ti kalojmë në bashkëpunim të ndërsjellë me drejtoritë komunale, policinë e Kosovës por edhe me palët e ndryshme në terren.

Vlen të ceket se gjatë vitit 2023 kemi pasur inspektime të përbashkëta edhe me policinë e Kosovës, ku kemi bërë largimin e shitësve ambulant nëpër disa rrugë të qytetit, pastaj kemi bërë lirim të disa parkingjeve ilegale nëpër rrugë të qytetit, ku ne si inspektorat paraprakisht kemi bërë identifikimin e veturave të parkuara në kundërshtim me ligjin e trafikut, ku edhe shpesh kemi thirrur policinë e Kosovës për asistim dhe lirim të këtyre parkingjeve publike. Rast konkret kemi parkingun në bulevardin "Ismael Raka" afër QKMF-së, ku me vendim të institucioneve komunale, në këtë lokacion janë caktuar disa vende parkime për pacientë të QKMF-së.

Njëkohësisht kemi bërë lirim të parkingjeve të caktuara për taksitë, por që nuk respektohet nga ngasësit tjerë në komunikacion.

Inspektime kemi pasur ndaj operatorëve me autobusë, kombi taksitë, auto taksitë, inspektime në mosrespektimin e orarit të punës nga barnatorët farmaceutikë, inspektime të çmimoreve të artikujve të ndryshëm, inspektime për afat të skadimit - artikujve të ndryshme, inspektime në mbrojtjen e mjedisit - hedhja e mbeturinave, inspektime nga prerja e pyjeve dhe transporti ilegal i druve, nga ndërtime të objekteve pa leje komunale, nga ndërhyrje të ndryshme në infrastrukturë komunale pa leje paraprake nga organet komunale dhe probleme të ngjashme.

Sipas planit të paraparë të punës për vitin 2023, kemi arritur të kryejmë inspektime pas orarit të rregullt të punës (gjatë muajit të ramazanit) - inspektime pas iftarit.

Kemi pasur inspektime pothuajse të rregullta në orët e mbrëmjes në sezonin veror, pra në sezonin kur në pushime kemi mërgimtarët.

Në bazë të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, jemi detyruar që edhe ditëve të pushimit javor të dalim në inspektim.

Vlen të potencohet se policia e Kosovës na u kanë përgjigjur sa herë kemi kërkuar nga ta që të na asistojnë.

Njëherit ju njoftojmë se policia e Kosovës, përmes raporteve të oficerit na ka njoftuar për shkelje të ndryshme të rregulloreve komunale apo ligjeve tjera në fuqi, e ku pastaj inspektorë të lëmive përkatëse kanë marr veprime konkrete ndaj shkelësve të këtyre rregulloreve komunale apo ligjeve, duke u gjobitur palët varësisht prej veprës së kryer.

RAPORTI VJETOR 2023

Aktivite inspektuese:

Inspektori mjedisor

Përmes këtij raporti po ju njoftojmë, për punën dhe aktivitetet të cilat i kemi realizuar gjatë kësaj gjatë vitit 2023 në lëmin e mjedisit.

Me qëllim të përmirësimit dhe kontrollimit të gjendjes në fushën e mjedisit gjatë tërë vitit janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme si dhe ka vazhduar bashkëpunimi me institucionet tjera: Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Mjedisit në MMPHI, Inspektoratin e Minierave në KPMM dhe Organizatën për Mbrojtjen e Mjedisit "Gjethi".

Ujërat

Në bashkëpunim me inspektoratin e minierave dhe policinë e Kosovës, kemi pasur një rast për eksploatim të zhavorit në shtratin e lumit Lepenc më saktësisht në vendin e quajtur Verrishta, palës i konfiskohen eskavatori dhe kamioni njëkohësisht lënda procedohet për gjykatë.

Në bashkëpunim me Inspektoratin e Ndërtimtarisë kemi pasur një inspektim për kontrollim të dokumenteve në ndërtimin e hidrocentralit në lumin Lepenc.

Në përgjithësi gjendja e lumenjve është nën kontroll, nuk kemi eksploatues të tjerë ilegal. Problematika kryesore e lumenjve mbetet shkarkimi i ujërave të zeza pa asnjë trajtim adekuat në lumin Lepenc dhe lumin Nerodime nga vendbanimet e komunës sonë dhe komunat fqinje.

Mbeturinat

Komuna e Kaçanikut në vazhdimësi ka arrit të përmirësoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave, aktualisht shërbimi i grumbullimit të mbeturinave i afrohet 90% e qytetarëve të komunës sonë. Përkundër përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave një nga problematikat kryesore të menaxhimit të mbeturinave mbetet mos caktimi i një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte.

Pyjet

Pyjet përbëjnë 58% të territorit të komunës së Kaçanikut. Pyjet janë shumë të rëndësishme dhe kanë ndikim të drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Pjesa e malit Sharr e cila prekë edhe territorin e komunës sonë, është e mbrojtur me ligj dhe hynë në kategorinë e Parkut Nacional.

Pyjet janë pasuri e jashtëzakonshme e një vendi, shfrytëzimi racional dhe i kontrolluar i tyre ndikon në zhvillimin e turizmit, blegtorisë, industrisë. Mirëpo fatkeqësisht në komunën tonë prerja dhe degradimi i pyjeve është në gjendje shumë shqetësuese. Kjo vërejtje si pasojë e menaxhimit të dobët dhe mos llogaridhënies nga institucionet të cilat menaxhojnë me pjesën e pyjeve në Parkun Nacional Sharri. Përkundër se komuna ka kompetenca shumë të kufizuara në pjesën e Parkut Nacional Sharri, vazhdimisht e ka

ngritur si shqetësim duke drejtuar shkresa te të gjitha institucionet për prerjen e pyjeve, mirëpo këto kërkesa asnjëherë nuk janë trajtuar me prioritet. Nga viti i ardhshëm sfiduese do të jetë edhe menaxhimi i pjesës tjetër të pyjeve të cilat kanë qenë nën menaxhim të komunës dhe të cilat kalojnë në menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës.

Resurset natyrore

Komuna e Kaçanikut është mjaft e pasur me resurse natyrore e në veçanti me gur gëlqeror. Në komunë tonë operojnë 10 operatorë të licencuar të cilët merren me shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror. Licencat dhe kontrollin për shfrytëzimin e resurseve minerale e bën Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Inspektorati komunal në vazhdimësi kryen kontrole të përbashkëta me Inspektoratin e KPMM-së në këtë fushë. Gjatë këtij viti kemi pasur dy raste ku janë ndaluar punimet, janë konfiskuar makineritë si dhe lëndët janë proceduar në gjykatë. Një rast ka qenë shfrytëzim ilegal i resurseve natyrore dhe një rast tejkalim i hapësirës së shfrytëzueshme me licencë. Pra, edhe ky sektorë është nën kontroll dhe nuk kemi raste të shfrytëzimit ilegal të resurseve natyrore.

Zonat e mbrojtura

Komuna e Kaçanikut njihet për malet, lumenjtë, grykën e Kaçanikut dhe peizazhin e mrekullueshëm. Janë të evidentuara dhe të mbrojtura 14 monumente natyrore: 09 prej të cilave janë monumente me karakter botanik, 02 monumente me karakter spelologjik, 02 monumente me karakter gjeomorfologjik si dhe 01 kompleks i pishave si peizazh i mbrojtur.

Kompleksi i pishave gjendet në zonën turistike të fshatit Strazhë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 25 ha. Peizazhi ka vlera natyrore turistike, rekreative dhe estetike. Sipas rekomandimeve të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, komuna e Kaçanikut është e obliguar që të hartoj një plan menaxhues të peizazhit të mbrojtur si dhe të bëj rrethojën e saj. Aktualisht komuna e Kaçanikut është duke e zbatuar një projekt në këtë zonë, që përfshinë ndërtimin e terreneve sportive, këndit të lodrave, vendeve për rekreacion, stazat e ecjes. Mirëpo për zbatimin e këtij projekti në teren nuk është pajisur me leje adekuate konform legjislacionit në fuqi si dhe Vendimit për Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës Kompleksi i Pishave në fshatin Strazhë si peizazh i mbrojtur 01Nr. 16-9661/16 i datës 29.04.2016.

- Lëndët gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar 28 lëndë,
- Procesverbalet gjatë vitit 2023 janë hartuar 22 procesverbale,
- Gjjobat janë shqiptuar 9 gjjoba mandatore në vlerë prej 3100€.

Po ashtu, gjatë këtij viti kemi qenë të angazhuar dhe kemi dhënë kontribut si pjesë e grupit punues për hartimin e Planit Lokal për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe asistim të inspektorëve të lëmive të tjera gjatë kontrolleve në teren.

Rekomandimet

Duke u analizuar gjendjen e mjedisit në komunën e Kaçanikut është e nevojshme të ndërmerren këto hapa:

RAPORTI VJETOR 2023

- Komuna e Kaçanikut të pajiset me leje mjedisore për çdo projekt i cili ka ndikim në mjedis. Komuna të pajiset me leje për çdo projekt që sipas legjislacionit në fuqi duhet ti nënshtrohet lejeve mjedisore, lejeve komunale mjedisore, lejeve ujore apo vlerësimet të ndikimit në mjedis, ngase realizmi i projekteve të caktuara ka ndikuar në ndotjen dhe degradimin e mjedisit.
- Të trajtohet me prioritet caktimi i lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte, ngase si pasojë e mos caktimit të këtij lokacioni po krijohen deponi ilegale. Shpeshherë krijimit të këtyre deponive ilegale i kontribuon edhe vet komuna si institucion gjatë realizmit të projekteve të ndryshme.
- Të dërgohen shkresa të vazhdueshme dhe të rritet presioni të institucionet përgjegjëse për menaxhimin e Parkut Nacional Sharri për prerjen dhe degradimin e pyjeve me ritme shumë shqetësuese.
- Drejtoritë komunale të hartojnë planet komunale të cilat dalin si obligim nga legjislacioni mjedisor.

Inspektori i Tregut

Përmes kësaj shkrese ua dërgojmë raportin e punës së Inspektorit të Tregut për vitin 2023

-
- | | |
|--|---------|
| ➤ Gjoba mandatore 12 në shumë | (6200€) |
| ➤ Inspektime për parandalimin e ekonomisë jo formale | 162 |
| ➤ Pranime teknike | 06 |
| ➤ Aktvendime | 12 |
| ➤ Urdhëresa | 82 |
| ➤ Njoftim dhe shkresa zyrtare..... | 05 |
| ➤ Intervenime rreth vendosjes së orarit të punës dhe mbishkrimit të firmës | 49 |
-
- Plani Operativ lidhur me transportin e mallrave pa dokumente
 - Inspektimet janë kryer së bashku edhe me Policinë e Kosovës;
 - Dalja dhe kontrollimi rreth respektimit të orarit të punës, me theks të veçant ndaj barnatoreve farmaceutike – Inspektimet janë kryer në orët e vona të mbrëmjes dhe natën, e që vërehet se në vitin 2023 është bërë një përmirësim i dukshëm në respektimin e orarit të punës së kujdestarive nga barnatoret farmaceutike;
 - Inspektim i subjekteve të cilat veprojnë me karburante lidhur me licencat për gaz dhe karburant si dhe dokumentacionet tjera.
 - Inspektim rreth zbatimit të ligjit për duhan.
 - Largimi i duhanit nga shitja në vende të ekspozuara
 - Largimi i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo ushqimore të ngjajshme me duhanin.
 - Inspektimi i vendosjes së deklaronit të artikujve ushqimorë,
 - Largimi i shitësve ambulant.
 - Kontrollimi i të gjitha furrave të bukës në komunën e Kaçanikut si dhe matja e peshës së bukës.
 - Kontrollimi i vendosjes së çmimeve për artikujt ushqimorë,
 - Kontrollimi i cilsisë së mallit me Inspektorin sanitar dhe konfiskimi i mallit.

Inspektori i Shërbimeve Publike

- Ka kryer inspektime në lëmi të ndryshme, ku ka bërë inspektime në lirim e trotuareve nga shitës ambulant të cilët pa leje komunale shfrytëzojnë trotuaret për ekspozimin e mallit për shitje,
- Ka bërë lirim e hapësirës publike - nga vendosja e disa gypave metalik në fshatin Soponicë të dedikuara për ndërtimin e një hidrocentrali në lumin Lepenc.
- Ka intervenuar më kohë gjatë ekzekutimit të punimeve në shtrirjen e rrjetit elektrik dhe vendosjen e shtyllave të betonit nga punë kryesi i Keds - it, duke dhënë vërejtje dhe duke bërë rekomandime bazuar edhe në kërkesa dhe ankesave të banorëve të lokaliteteve ku zhvillohen punimet, me qëllim që sa më shumë të ruhen pronat private, njëkohësisht edhe prona komunale të shfrytëzohet sa më mirë që të jetë e mundur, mos të pengohen trotuaret, rrugët publike, hyrjet nëpër prona private etj.
- Ka bërë 10 procesverbale,
- Ka shqiptuar 04 gjoba;
- Vlera e gjobave të shqiptuara është 1100€.
- Ka ngrit një kallëzim penal ndaj një pale e cila ka bërë mbushjen e tokës me dhe, nën tensionin e lartë të rrymës 3500KV, ku pas shqyrtimit të lëndës nga ana e prokurorisë së shtetit, pala ka ndërmarrë veprime konkrete duke larguar dheun nga lokacioni i deponuar.
- Ka shqiptuar gjoba për ndërhyrje në infrastrukturë publike pa leje komunale.
- Ka bërë largimin e barrierave - pengesave nëpër rrugë - pa leje komunale.
- Ka bërë largimin e reklamave të vendosura nëpër hapësira publike nga qytetarët, pa pëlqim paraprak nga organet komunale.
- Në bashkëpunim me inspektorë tjerë dhe në asistim të policisë së Kosovës - Stacioni Policor në Kaçanik, ka bërë zbatimin e planit për inspektime, i hartuar nga sektori i inspektoratit.

Inspektori i Komunikacionit

Gjatë këtij vitit janë kryer 91 inspektime të vazhdueshme në transportin Publik të Udhëtarëve, në lëmin e komunikacionit rrugorë dhe 46 inspektime të përbashkëta me inspektorët komunal të lëmvive të ndryshme si dhe kemi kryer punë tjera shtesë të angazhuara me vendime.

Në lëmin e transportit Publik të udhëtarëve kemi 16 procesverbale të ndryshme, prej tyre:

- 02 - procesverbale me vërejtje për ndërprerjen e veprimtarisë pa Leje Pune - e kryer,
- 06 - procesverbale - urdhëresë për vazhdimin e Lejes së Punës - e kryer,
- 04 - procesverbale - urdhëresë për kryerjen e kontrollës teknike periodike, certifikatë të mjekut - e kryer,
- 04 - procesverbale - urdhëresë për plotësim dokumenteve, çmimoret dhe fletë urdhëresën e rrugës - të kryera,
- 05 - vërejtje verbale për kryerjen e kontrollimit teknik periodik, certifikatë të mjekut - të kryera,
- 03 - gjoba mandatore me aktvendim - të kryera,

Vlera e gjobave të shqiptuara me aktvendim është 1900€, të paguara 1300€ (për shkak se nëse pagesa kryhet brenda afatit të përcaktuar, atëherë gjoba paguhet 50% më lirë).

RAPORTI VJETOR 2023

Një (01) kërkesë e bërë në MMPHI për interpretim ligjor për Ligjin Nr. 04/L-179, për Transport Rrugor, për të cilën kanë dhënë sqarim ligjor.

Dy (02) inspektive të kryera te Stacioni i Autobusëve dhe te Parkingu i Auto Taksive, në kuadër të punës praktike të kryer nga nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale të drejtimit Trafik Rrugor.

Në lëmin e komunikacionit rrugor - Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal - kemi 04 procesverbale:

02 - procesverbale për dëmtim të rrugës publike - e kryer

01 - procesverbal për shenjat e komunikacionit të dëmtuara - e kryer,

01 - procesverbal për largimin e pengesës (policë të shtrirë) në rrugë - e kryer,

02 - urdhëresa për shenjat e komunikacionit të dëmtuara - e kryer,

03 - gjoba mandatore me aktvendim, për shenjat e komunikacionit të dëmtuara - të kryera,

01 - gjobë mandatore me aktvendim, për dëmtim të rrugës - e kryer,

01 - propozim për përmbarim për gjobën mandatore - e kryer,

Futja në data bazë, e shenjave të komunikacionit horizontale dhe vertikale të dëmtuara në teren,

Ka pranuar katër (04) raporte nga Policia e Kosovës për shenja të komunikacionit të dëmtuara, prej të cilave ju ka përgjigjur Raportit të Policisë së Kosovës,

Ka bërë një (01) kërkesë në Policinë e Kosovës, për lirim të parkingjeve - parkingje jo të rregullta.

Ka bërë katër (04) kërkesa DESHP-së, për rregullimin e shenjave të komunikacionit, ku prej tyre janë identifikuar 68 shenja të dëmtuara,

Komision Komunal për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të palëve nga lëmia e komunikacionit, ku prej tyre janë shqyrtuar 08 kërkesa dhe janë dhënë rekomandimet.

Ka pranuar dy (02) ankesa, prej të cilave njëra i ka dhënë përgjigje si dhe njëra është në procedurë.

Punë tjera:

Komision në grupin Punues për Planin Zhvillimor Komunal,

Komision në angazhimin e punës për Performancë Komunale - fusha e Transportit publik të Udhëtarëve dhe fusha e Parkingjeve Publike,

Komision i përkohshëm për analizim dhe vlerësim të gjendjes ekzistuese të qarkullimit të automjeteve në një kahje dhe krijimin e vend parkingjeve në rr."Qamil Ilazi" dhe një segment të rr."Sali Bajra" në Kaçanik.

Ka asistuar edhe te inspektorët e lëmimeve tjera: te inspektori i Shërbimeve Publike - 12 asistime prej tyre 05 me procesverbal, te inspektori i Ndërtimit - 27 asistime prej tyre 19 me procesverbal, te inspektori i Tregut - 02 asistime, te inspektori i Mjedisit - 02 asistime dhe te inspektori i Pylltarisë - 03 asistime si dhe 02 asistime i ka bërë tek punëtorët e pastërtisë.

Takim në teren me zyrtarët të Ministrisë së Infrastrukturës, në rr."Komandant Bardhi", lidhur me kërkesën për ndryshimin e kategorisë së rrugës dhe marrjen e kompetencave në ministri.

Inspektori i Ndërtimit

Përmes këtij raporti vjetor, paraqitet puna e inspektorit të ndërtimit, ku gjatë këtij viti kemi pasur sfida të ndryshme e që kemi arritur t'i përfundojmë me sukses.

Bazuar në autorizimet ligjore, ka marrë të gjitha masat e duhura për pengimin e ndërtimeve pa leje në teritorin e Kaçanikut, kontrollimin e të gjitha objekteve të pajisura me leje ndërtimore, materialit ndërtimorë, kushteve ndërtimore, dokumentacionit teknik të objekteve si dhe mbrojtja e shëndetit publik me rastin e kryerjes së punëve ndërtimore. Të gjitha kërkesat e parashtruara pranë zyrës së inspektorit të ndërtimitarisë, janë kryer në afatin ligjorë dhe sipas detyrës zyrtare.

Janë kryer kontrollime të objekteve ndërtimore, në bazë të kërkesave të investitorëve, me qëllim të kontrollimit të armaturës dhe betonit si dhe produkteve ndërtimore ku iu është urdhëruar edhe marrja e mostrave të betonit, respektimi në përgjithësi i projektit dhe mbajtja me rregull e librit dhe ditarit ndërtimorë si dhe rrethimi i vendpunishtes.

Kemi pasur raste të ndërprerjeve të punimeve pa leje paraprake nga organet komunale. Njëkohësisht nëpër këto objekteve kemi bërë vendosjen e shiritave dhe shenjave me të cilat i kemi ndaluar punimet pa leje paraprake.

Kemi pasur vizita dhe konsultime të vazhdueshme me inspektorë të ndërtimit nga niveli qendror, ku shpesh kemi marr edhe rekomandime dhe ndihmesën e tyre se si të veprohet në raste të ndryshme.

Kemi pasur edhe kërcënime nga palët në terren, por që me asistim të policisë së Kosovës kemi arritur të ndërpresim punimet dhe të kryejmë punën tonë, e që në këto raste kemi pasur punë ekipore të përbërë prej disa inspektorëve komunal.

Vlen të theksohet se për shkak të inspektimeve sistematike në terren, ka ardhur deri te shtimi i kërkesave në organet komunale për t'u pajisur me leje ndërtimi.

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar – Dhjetor 2023,

- Gjatë kësaj periudhe janë bërë 68 inspektime dhe 30 inspektime tjera në bashkëpunim me inspektorë të lëmive tjera.
- Janë bërë 36 procesverbale me urdhëresa për ndërprerje të punimeve dhe kontroleve sistematike të punëve.
- 05 ankesa, të cilat janë shqyrtuar menjëherë dhe kemi marr masat e nevojshme.
- Një rast të ndërprerjes së punës me asistim të policisë për shkak të kërcënimeve dhe pengimit të detyrës zyrtare, ku është njoftuar prokurori i shtetit.
- Një kallëzim penal për arsye se ka filluar punimet edhe pas ndërprerjes së punëve me shirit për punët e zhvilluara pa leje ndërtimi, ku të njëjtit paraprakisht i është shqiptuar gjobë dhe i janë dhënë afate për tu pajisur me leje ndërtimi.
- Janë shqiptuar gjoba për mos informim dhe punim pa leje ndërtimi, të cilat janë paguar në afatin prej 7 ditësh dhe janë konfirmuar me fletëpagesë prej palëve, të cilat janë paguar brenda afatit ligjor, e që për pagesë kryhen 50% të pagesave e që vlera e gjobave është 350€.

Inspektori i Pylltarisë

Gjatë vitit 2023 ka kryer inspektime në rrugë dhe teren.

Ka ngrit 15 fletëparaqitje, 03 vlerësime dëmi në pyje private.

Në këtë vit në krahasim me vitet tjera pyjet kanë qenë më pak të atakuara.

RAPORTI VJETOR 2023

Ka kryer inspektime te të gjitha furrat e bukës të cilat përdorin drurin si lëndë djegëse për ngrohje të furrave.

Ka vizituar edhe sharrat të cilat merren me përpunim të drurit.

Me inspektorin mjedisor, kanë bërë një inspektim në parkun kombëtar Sharri ku dhe kanë përgatit një shkresë zyrtare dhe kanë dërguar organeve përgjegjëse, lidhur me gjendjen në parkun kombëtar Sharri në pjesën e Kaçanikut.

Në bashkëpunim me inspektorët tjerë kemi kryer inspektime të ndryshme.

Gjatë gjithë vitit ishim në bashkëpunim me inspektorët e ambientit, komunikacionit, tregut dhe ndërtimtarisë, me të cilët jemi munduar të parandalojmë veprimet e ndryshme që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Vendimet dhe vlera e gjobave për vitin 2023, të pranuar nga gjykata komunale për periudhën Janar - Dhjetor 2023, të inicuar nga inspektori i pylltarisë.

Numri i lëndës	vlera e gjobës
2021:227096	150 Euro
2022:045137	400 Euro
2021:227023	200 Euro
2021:227082	200 Euro
2021:235375	200 Euro
2021:197851	400 Euro
2021:197867	400 Euro
2022:173197	400 Euro
2021:194849	400 Euro
2021:257813	400 Euro
2021:281655	400 Euro
2021:241794	100 Euro
2021:248163	150 Euro
2021:226898	150 Euro
2022:200103	100 Euro
2023:149416	100 Euro
2022:200103	100 Euro
2022:047905	150 Euro

RAPORTI VJETOR 2023

2023:159464	100 Euro
2022:060996	400 Euro
2023:159464	100 Euro
2023:177993	300 Euro
2023:187216	200 Euro
2023:197302	200 Euro
2022:089964	200 Euro
2022:122781	100 Euro
2023:215140	500 Euro
Totali	6500 Euro

08 lëndë janë parashkruar,

07 lëndë janë vetëm Qortim

Ka dhe dy (02) lëndë të këtij viti të përfunduara por vendimet ende si kemi pranuar nga gjykata.

Gjobat mandatore të lëshuara

Nr	Inspektori	Gjoba mandatore/€	Vendimet e gjykatës/€	Gjithsejt/€
1	Mjedisor	3100	00	3100
2	i Tregut	6200	00	6200
3	i Komunikacionit	1900	00	1900
4	Shërbimeve Publike	1100	00	1100
5	i Ndërtimit	350	00	350
6	i Pylltarisë	00	6500	6500
7				19.150 €

RAPORTI VJETOR 2023

